



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 08  
Dhjetor | 2015



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 8



**BOTUES** © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike  
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Arben MUSTAFA

**REDAKTOR** Albulena XHELILI

**AUTORË**  
Taulant SYLA  
Arta NUSHI  
Hana GAFURRI  
Krenare MALOKU  
Zana GJOCAJ  
Bejtush KIÇMARI

**REDAKTOR TEKNIK** Butrint BOJAJ



**SHKURTESAT:**

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ASK	Agjencia e Statististikave të Kosovës
ATM	Bankomatë ( <i>anglisht: Automated Teller Machines</i> )
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( <i>angl.: Capital Adequacy Ratio</i> )
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ( <i>angl.: European Bank for Reconstruction and Development</i> )
ECB	Banka Qendrore Evropiane ( <i>anglisht: European Central Bank</i> )
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit ( <i>angl.: Net Interest Margin</i> )
NPL	Kreditë joperformuese ( <i>angl.: Non-Performing Loans</i> )
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes ( <i>anglisht: Point of Sales</i> )
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim ( <i>anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development</i> )
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit ( <i>angl.: Rule of Law Index</i> )
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete ( <i>angl.: Return on Average Assets</i> )
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl.: Return on Average Equity</i> )
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl.: Return on Average Equity</i> )
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut ( <i>angl.: Risk Weighted Assets</i> )
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit ( <i>angl.: Special Drawing Rights</i> )
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

**Vërejtje:**

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2015),  
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 8, Prishtinë: BQK.  
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

## PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	11
2. Përmbledhje -----	13
3. Mjedisi i jashtëm ekonomik dhe financiar -----	16
4. Ekonomia e Kosovës -----	25
5. Sistemi Financiar i Kosovës-----	28
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	28
5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm -----	30
6. Sektori Bankar i Kosovës-----	32
6.1 Struktura e Sektorit Bankar -----	32
6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	33
6.3. Performanca e Sektorit Bankar -----	47
6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar -----	51
6.5. Analiza Stres-Test-----	65
6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	70
7. Sektori Pensional-----	74
7.1 Struktura e Sektorit Pensional -----	74
7.2. Performanca e Sektorit Pensional-----	75
8. Sektori i Sigurimeve-----	76
8.1 Struktura e Sektorit të Sigurimeve -----	76
8.2. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve -----	76
8.3. Performanca e Sektorit të Sigurimeve-----	78
9. Sektori Mikrofinanciar dhe Ndihmësit Financiar-----	80
9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar -----	80
9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar -----	82
9.3 Ndihmësit Financiar-----	83
10. Shtojca statistikore -----	85
11. Referencat-----	103



<b>LISTA E FIGURAVE</b>	<b>16</b>
Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rfinansimit e ECB-së	16
Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude'	17
Figura 3. Struktura e aseteve të PCH-së	20
Figura 4. Treguesit e efikasitetit të PCH-së	20
Figura 5. Struktura e aseteve të RBI-së	21
Figura 6. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së	21
Figura 7. Treguesit e efikasitetit të RBI-së	22
Figura 8. Struktura e aseteve të NLB Group	23
Figura 9. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB group	23
Figura 10. Treguesit e efikasitetit të NLB Group	24
Figura 11. Rritja reale e PBB-së,	25
Figura 12. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij	25
Figura 13. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar	27
Figura 14. Asetet e sistemit financiar dhe sektorëve përbërës	28
Figura 15. Struktura e aseteve të sistemit financiar	28
Figura 16. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve në Kosovë	28
Figura 17. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në rajon	29
Figura 18. Struktura e kërkesave të jashtme	30
Figura 19. Struktura e detyrimeve të jashtme	30
Figura 20. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar	21
Figura 21. Struktura e aseteve të sektorit bankar	32
Figura 22. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar	32
Figura 23. Struktura e aseteve të sektorit bankar	33
Figura 24. Asetet e sektorit bankar	34
Figura 25. Struktura e letrave me vlerë	34
Figura 26. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive	35
Figura 27. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja	36
Figura 28. Kreditë e reja	36
Figura 29. Kreditë e reja sipas sektorëve	36
Figura 30. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit	36
Figura 31. Gjithsej kreditë, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyera	37
Figura 32. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike	39
Figura 33. Kreditë për sektorin e industrisë	39
Figura 34. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike	40
Figura 35. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	40
Figura 36. Kreditë sipas afatit të maturimit	41
Figura 37. Depozitat e sektorit bankar	42
Figura 38. Depozitat e ndërmarrjeve	42
Figura 39. Depozitat e jo-rezidentëve	43

Figura 40. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit-----	43
Figura 41. Depozitat e afatizuara -----	44
Figura 42. Norma mesatare e interesit -----	44
Figura 43. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	45
Figura 44. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve -----	45
Figura 45. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike-----	45
Figura 46. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare -----	46
Figura 47. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -	46
Figura 48. Performanca financiare e sektorit bankar -----	47
Figura 49. Të hyrat e sektorit bankar, -----	47
Figura 50. Të hyrat e interesit të sektorit bankar-----	47
Figura 51. Të hyrat e sektorit bankar -----	48
Figura 52. Shpenzimet e sektorit bankar -----	48
Figura 53. Shpenzimet e sektorit bankar -----	49
Figura 54. Shpenzimet e interesit dhe jointeredit sipas kategorive-----	49
Figura 55. Kreditë joperformuese dhe provizionet për humbjet e kredive -----	49
Figura 56. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	50
Figura 57. Raporti shpenzime/të hyra në sektorin bankar-----	50
Figura 58. Harta e rreziqeve të sektorit bankar -----	51
Figura 59. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar-----	52
Figura 60. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra-----	52
Figura 61. Rezervat e sektorit bankar -----	53
Figura 62. Hendeku i likuiditetit -----	53
Figura 63. Raporti NPL/gjithsej kreditë -----	54
Figura 64. Gjithsej kreditë dhe NPL-të -----	55
Figura 65. NPL-të sipas sektorëve -----	55
Figura 66. Struktura e kredive sipas klasifikimit-----	56
Figura 67. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore-----	56
Figura 68. NPL-të dhe provizionet-----	56
Figura 69. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	57
Figura 70. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	57
Figura 71. Kapitali rregullativ dhe RWA-të -----	58
Figura 72. Struktura e kapitalit rregullator -----	58
Figura 73. Struktura e kapitalit të klasit të parë -----	59
Figura 74. Struktura e kapitalit të klasit të dytë-----	59
Figura 75. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut-----	59
Figura 76. Raporti i RWA-ve ndaj gjithsej mjeteve të sektorit -----	60
Figura 77. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë -----	60
Figura 78. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj-----	61

Figura 79. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	62
Figura 80. Hendekui mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	62
Figura 81. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	74
Figura 82. Asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-----	75
Figura 83. Asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	75
Figura 84. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve sipas pronësisë -----	76
Figura 85. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve-----	77
Figura 86. Detyrimet dhe kapitali i sektori të sigurimeve-----	77
Figura87. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	78
Figura 88. Asetet e sektorit mikrofinanciare-----	80
Figura 89. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciar-----	80
Figura 90. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciarë, sipas veprimtarisë ekonomike -----	80
Figura 91. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciar-----	81
Figura 92. Norma mesatare e interesit në kredi-----	81
Figura 93. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve -----	81
Figura 94. Struktura e lizingut -----	82

**LISTA E TABELAVE ----- 29**

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare -----	29
Tabela 2. Struktura e asetëve të sektorit bankar-----	33
Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	42
Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar-----	50
Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar-----	51
Tabela 6. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -	63
Tabela 7. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë-----	65
Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres- testit: rreziku kreditor -----	68
Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku i likuiditetit -----	70
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ----	71
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar -----	72
Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	72
Tabela 13. Struktura e fondeve pensionale sipas pronësisë -----	74
Tabela 14. Bruto primet e arkëtuara -----	77
Tabela 15. Dëmet e paguara -----	78
Tabela 16. Treguesit shtesë të efikasitetit të sektorit -----	83

**LISTA E KUTIVE ----- 20**

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë-----	20
Kutia 2. Kreditë e reja -----	36
Kutia 3. Anketa mbi Kreditimin Bankar -----	37
Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë -----	63

## 1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2015 po karakterizohet me ritëm të përshpejtuar të rritjes, të gjeneruar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme. Zhvillimet e çmimeve në tregjet globale vazhdojnë të kenë ndikim të madh në nivelin e çmimeve në Kosovë, duke bërë që ekonomia e vendit të ballafaqohet me zhvillime deflacioniste. Sektori fiskal vazhdon të jetë i qëndrueshëm, me nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Shkëmbimet tregtare me sektorin e jashtëm, përfshirë importin dhe eksportin, kanë vazhduar të rriten. Rritje e konsiderueshme është shënuar edhe në remitencat dhe investimet e huaja direkte të pranuar në Kosovë, kategori këto që paraqesin burime të rëndësishme financimi për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend.

Sektori bankar ka zgjeruar aktivitetin dhe ka shënuar përmirësim të mëtejshëm të treguesve të shëndetit financiar, duke vazhduar kështu të jetë një kontribuues shumë i rëndësishëm i zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit. Lehtësimi i standardeve të kreditimit nga ana e bankave dhe, në anën tjetër, rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet kanë rezultuar në përshpejtim të rritjes së kreditimit bankar, gjë që ka nxitur rritjen e kërkesës së brendshme. Rritjes së kërkesës për kredi në masë të konsiderueshme i ka kontribuar zvogëlimi i theksuar i normave të interesit, të cilat tani më janë në nivel të përafërt me normat e interesit që aplikohen në vendet tjera të rajonit. Përshpejtimi i rritjes së kreditimit, së bashku me zvogëlimin e normës së interesit dhe përmirësimin e kushteve tjera të kreditimit, paraqesin zhvillime shumë të rëndësishme në favor të lehtësimit të qasjes në financa në Kosovë. Ky lehtësim është pasqyruar edhe në rritjen e kreditimit për sektorët më pak të kredituar të ekonomisë, siç janë bujqësia, prodhimtaria dhe energjetika, të cilët gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 ishin sektorët me normën më të lartë të rritjes së kredive të pranuar.

Përveç rritjes së përshpejtuar të aktivitetit kredihënës, gjysma e parë e vitit 2015 u karakterizua edhe me përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së portofolit kreditor si rezultat i zvogëlimit të vlerës së kredive joperformuese në sektorin bankar. Sektori bankar po ashtu vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Niveli i lartë i qëndrueshmërisë së sektorit bankar tregohet edhe nga rezultatet e stres-testit ku të gjitha bankat shfaqen në gjendje për të përballuar tronditjet e konsideruara në skenarët hipotetik.

Për sa i përket sektorëve të tjerë të sistemit financiar, sektori pensional vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare, duke shënuar rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe kthim pozitiv nga investimet. Sektori i sigurimeve regjistroi rritje të aseteve, mirëpo vazhdon të ballafaqohet me vështirësi për sa i përket profitabilitetit. Sektori i institucioneve mikrofinanciare ka vazhduar zgjerimin e kreditimit, duke mundësuar kështu rritjen e qasjes në financa sidomos për individët dhe ndërmarrjet e vogla. Megjithatë, financimi nga institucionet mikrofinanciare vazhdon të karakterizohet me kosto të lartë, çka parashtron nevojën për rritje të mëtejme të efikasitetit të këtij sektori.

Bazuar në gjendjen aktuale të sistemit financiar dhe duke pasur parasysh parashikimet për zhvillimet e përgjithshme makroekonomike në vend, vlerësojmë se sistemi financiar i vendit do të vazhdojë të zgjerojë aktivitetin dhe të ruajë qëndrueshmërinë edhe gjatë periudhës së ardhshme. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të monitorojë dhe të vlerësojë për së afërmi zhvillimet e lidhura me stabilitetin financiar në vend dhe, në vazhden e kësaj, informimi i rregullt i publikut mbi zhvillimet në sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi mbetet prioritet i rëndësishëm.

Bedri HAMZA  
Guvernator



## 2. Përmbledhje

Mjedisi i jashtëm ekonomik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 u karakterizua me ritëm të shpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik është përkthyer edhe në përmirësim të ciklit kreditor në eurozonë, ku deri në qershor 2015 aktiviteti kreditues në u rimëkëmb nga rënia e vitit të kaluar. Rënia e vazhdueshme e çmimeve në tregjet ndërkombëtare u reflektua edhe në eurozonë e cila, në qershor 2015, u karakterizua me normë të ulët të inflacionit prej 0.2 përqind. Në rajonin e eurozonës pritet përforsim i mëtejme i aktivitetit ekonomik, mbështetur kryesisht në rënien e mëtejme të çmimeve të naftës, rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve dhe zhvillimet pozitive në tregjet e punës. Gjithashtu, rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës si rezultat i zhvlerësimit të euros si dhe programi i lehtësimit sasior nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) pritet të kenë ndikim pozitiv në aktivitetin ekonomik. Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në gjysmën e parë të vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Ngjashëm me vendet e eurozonës, presionet deflacioniste ishin të pranishme edhe në vendet rajonit gjatë vitit 2015. Ballkani Perëndimor gjatë vitit 2015 gjithashtu shënoi rritje të ndërmjetësimit financiar, ku të gjitha vendet u karakterizuan me përshpejtim të rritjes së kredive. Sektorët bankar të vendeve të rajonit gjithashtu përmirësuan nivelin e kapitalizimit dhe kualitetin e portfolios kreditore gjatë vitit 2015. FMN dhe Banka Botërore parashikojnë një përshpejtim të rritjes ekonomike në rajonin e Ballkanin Perëndimor për vitin 2015.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me stabilitet të përgjithshëm makroekonomik, të manifestuar me normë pozitive të rritjes ekonomike, si dhe qëndrueshmëri në rrafshin fiskal dhe atë të çmimeve, edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Sipas vlerësimeve të ASK-së, tremujori i parë u karakterizua me rritje vjetore prej 0.2 përqind, ndërsa në tremujorin e dytë ekonomia e vendit përshpejtoi ritmin e rritjes duke regjistruar rritje vjetore prej 3.4 përqind. Rritja ekonomike në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto vazhduan të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me rënie të çmimeve, ku shkalla e inflacionit ishte -0.4 përqind. Kosova vazhdon të ketë pozicion të qëndrueshëm fiskal. Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë përshpejtim të rritjes ekonomike për tërë vitin 2015 krahasuar me vitin e kaluar. Norma e rritjes së PBB-së reale për vitin 2015 vlerësohet të jetë 3.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind sa ishte në vitin 2014. Përshpejtimi i ritmit të rritjes mbështetet në pritjet për rritjen e konsumit dhe investimeve, ku kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe përshpejtimi i rritjes së kreditimit bankar.

Sistemi financiar i Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sektori bankar shënoi përshpejtim të aktivitetit kredidhënës duke përforsuar kështu rolin e tij në financimin e aktivitetit ekonomik në vend. Vlora e gjithsej kredive deri në qershor 2015 arriti në 2.01 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind. Rritja e kreditimit ndodhi si rezultat i lehtësimit të ofertës kreditore, përderisa edhe kërkesa për kredi shënoi rritje. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve mbetet e ngjashme me vitet paraprake, ku kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 54.0 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Megjithatë, ishin sektorët me qasjen më të ulët në financimin bankar si ai i bujqësisë, energjetikës dhe prodhimitarisë ata të cilët shënuan rritjen më të lartë vjetore të kredive. Rritja e aktivitetit kreditues në vend është financuar kryesisht nga rritja e depozitave të mbledhura brenda vendit. Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 6.3 përqind, duke arritur vlerën prej 2.57 miliardë euro në qershor 2015. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara në dy

vitet e fundit. Përderisa më parë depozitat e afatizuara dominonin strukturën e depozitave, në qershor 2015 kategoria kryesore e depozitave përfaqësohej nga depozitat e transferueshme. Ky zhvillim në strukturën e depozitave kryesisht është pasojë e rënies së theksuar e normës së interesit në depozita në dy vitet e fundit, gjë që mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozitorët.

Spektori bankar gjatë gjysmës së parë vitit 2015 u karakterizua me zvogëlim të konsiderueshëm të normës së interesit në kredi, dhe rritje të lehtë të normës së interesit në depozita. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 7.6 përqind në qershor 2015 nga 10.5 përqind sa ishte në qershor 2014. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita në qershor 2015 shënoi rritje në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në qershor 2015 u zvogëluar në 6.8 pikë përqind, nga 9.9 pikë përqind sa ishte në qershor 2014.

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhdojnë të reflektojnë shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. Spektori bankar ka shënuar një përmirësim të theksuar të performancës financiare duke regjistruar profit neto në vlerë prej 44.9 milionë euro në qershor 2015, kryesisht si rezultat i reduktimit të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione dhe shpenzimeve të interesit në depozita. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm, ku në qershor 2015 raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra qëndroi në 41.9 përqind, që është dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Niveli i kapitalit të sektorit bankar është përforcuar kryesisht si rrjedhojë e përmirësimit të theksuar të performancës financiare, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Në qershor 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti në 19.0 përqind krahasuar me 17.4 përqind një vit më parë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor ka treguar tendencë rënëse, ku pjesëmarrja e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor 2015 ka zbritur në 7.2 përqind nga 8.2 përqind në qershor 2014. Gjithashtu sektori bankar ka rritur shkallën e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, ku raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur në 119.3 përqind nga 116.4 përqind sa ishte në qershor 2014. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut vazhdon të mbetet në nivel të ulët duke marrë parasysh rënien e konsiderueshme të pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, pjesëmarrjen e ulët të kredive në valutë jo-euro në gjithsej portofolin kreditor, si dhe ndjeshmërinë e ulët të aseteve dhe detyrimeve ndaj lëvizjeve në norma të interesit duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave bartin norma fikse të interesit. Për më tepër, rezultatet e analizës stres-test vazhdojnë të sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar për të përballuar tronditjet e konsideruara në kuadër të skenarëve hipotetik.

Infrastruktura bankare gjatë vitit 2015 vazhdoi të zgjerohet. Rritja e numrit të bankomatëve dhe pajisjeve POS rezultoi me rritje të numrit dhe vlerës së tërheqjeve përmes bankomatëve dhe shitjeve përmes POS-ve. Gjatë kësaj periudhe, është rritur edhe numri dhe vlera e transaksioneve të kryera përmes sistemit ndërbankar të pagesave në Kosovë (SEKN). Po ashtu, është shënuar rritje e numrit të gjithsej llogarive bankare, llogarive bankare E-banking, si dhe numrit të kartelave debiti dhe krediti. Të gjitha këto zhvillime ndikuan në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar: sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori i institucioneve mikrofinanciar. Spektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës, ku vlera e aseteve të sektorit deri në qershor 2015 arriti në 1.18 miliard euro duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind. Spektori pensional gjithashtu vazhdoi të



shënojë performancë të mirë financiare, duke shënuar rritje të çmimit të aksionit në mjetet e investuara dhe, rrjedhimisht, kthim pozitiv nga investimet. Sektori i sigurimeve ka shënuar rritje të aktivitetit ku në qershor 2015 vlera e aseteve të sektorit arriti në 151.2 milionë euro që përkon me rritje vjetore prej 11.5 përqind. Mirëpo, performanca financiare e këtij sektori vazhdon të jetë më e pafavorshme duke thëlluar humbjen në krahasim me vitin e kaluar. Sektori mikrofinanciar gjatë vitit 2015 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit duke arritur vlerën e gjithsej aseteve në 116.3 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 2.8 përqind. Sektori mikrofinanciar deri në qershor 2015 shënoi rritje të konsiderueshme të profitit që u financiare u pasqyrua edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit.

### 3. Mjedisi i jashtëm ekonomik dhe financiar


#### Ambienti makroekonomik në Eurozonë

Mjedisi i jashtëm ekonomik gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 u karakterizua me ritëm të shpejtuar të rritjes së aktivitetit ekonomik. Ekonomia e eurozonës, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shënoi rritje prej 1.2 përqind (0.8 përqind në TM2 2014), ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënoi normë reale të rritjes prej 0.3 përqind (0.1 përqind në TM2 2014). Rritja e aktivitetit ekonomik, e mbështetur kryesisht nga sektori i prodhimit dhe shërbimeve, mbeti e koncentruar në Gjermani, Spanjë, Itali dhe Greqi, përderisa Franca u karakterizua me ngadalësim të rritjes ekonomike. Përkundër pritjeve për një rënie ekonomike prej 0.5 përqind, si pasojë e dështimit në pagesën e borxheve në afatin e paraparë, Greqia shënoi një rritje vjetore prej 1.4 përqind në tremujorin e dytë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak, norma reale e rritjes ekonomike ishte 0.8 përqind. Aktiviteti ekonomik në Greqi vlerësohet të jetë mbështetur nga rritja e shpenzimeve të konsumatorëve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, nxitur nga pritjet për rritjen e kontrollit të kapitalit, si dhe nga rritja e të ardhurave nga turizmi.

Sipas BQE-së, eurozona u karakterizua me normë inflacioni prej 0.2 përqind në qershor 2015, duke tejkaluar periudhën deflacioniste të fund vitit 2014. Shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të mbetet tejet e ulët në muajt në vijim, përderisa në fund të vitit 2015 pritet një ngritje graduale e shkallës së inflacionit. Për vitin 2015 në tërësi, FMN ka parashikuar një normë të inflacionit prej 0.1 përqind. Rritja graduale e shkallës së inflacionit pritet të nxitet kryesisht nga ndikimi i politikave lehtësuese monetare në kërkesën e përgjithshme në eurozonë, ndikimi i normës së ulët të këmbimit të euros, si dhe pritjet për rritje graduale të çmimeve të naftës.

Pas lansimit të programit të lehtësimit sasior nga BQE, zyrtarët e lartë të BQE-së kanë deklaruar se politikave lehtësuese monetare do të plotësohen edhe me politika të planifikuara makroprudenciale për të siguruar mirëmbajtjen e stabilitetit financiar. BQE vazhdoi të mbaj të pandryshuar normën bazë të rifinancimit edhe në qershor 2015. Megjithatë, lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i këtij viti ka ndikuar në rënien e normave 1 mujore dhe 12 mujore të interesit të kreditimit ndër bankar Euribor. Në qershor 2015, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht -0.06 përqind nga -0.01 përqind në mars 2015. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.16 përqind në qershor 2015, nga mesatarja prej 0.21 përqind në mars 2014 (figura 1).

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2015) dhe ECB (2015)

## Çmimi ndërkombëtar i naftës

**Çmimi i naftës** (brent crude)<sup>1</sup> në tremujorin e dytë të vitit 2015 shënoj rënie prej rreth 43.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia më e madhe e çmimit të naftës është shënuar në janar 2015, ndërkohë që pritjet për vitin 2015 tregojnë për një rënie mesatare të çmimit të naftës prej 17 përqind kundrejt vitit 2014 (figura 2).

Me rënie të çmimit gjatë tremujorit të dytë u karakterizuan edhe metalet e arit (figura 3). Çmimi i arit ishte për mesatarisht 7.4 përqind më i ulët krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014. Rënia më e madhe e çmimit të arit është shënuar në muajin mars 2015, ku 1 njësi ari (njësia matëse ekuivalente me 31.1 gram ari quhet “troy oz”) kanë kushtuar rreth 11.8 përqind më lirë se sa në muajin mars 2014.


Trendi i rënies së çmimeve të ushqimit ka vazhduar edhe në tremujorin e dytë të vitit 2015. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, indeksi i çmimeve të ushqimit shënoi rënie prej mesatarisht 20.4 përqind, përderisa indeksi i çmimeve të drithërave shënoi rënie për mesatarisht 19.8 përqind (figura 4).

**Norma e këmbimit** të euros kundrejt valutave kryesore gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 është zhvlerësuar kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014. Zhvlerësimin më të madh euro e ka shënuar ndaj dollarit amerikan me 19.9 përqind, pasuar nga frangu zviceran me 14.9 përqind dhe sterlina britanike me 12.0 përqind. Ndaj denarit maqedonas, euro ka mbetur pothuajse e pandryshuar në tremujorin e dytë kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014, përderisa ndaj dinarit serb dhe lekut shqiptar ka shënuar vlerësim prej 4.1 përkatësisht 0.3 përqind. Euro u zhvlerësua edhe kundrejt kunës kroate gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 për 0.2 përqind.

## Sektori bankar në Eurozonë

Sektori bankar në vendet kryesore të eurozonës, me përjashtim të Greqisë, u karakterizua me përmirësim të indikatorëve kryesor të shëndetit financiar (*ang. Financial Soundness Indicators*). Niveli kapitalizimit të sektorit bankar, shprehur përmes raportit të kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, u përmirësua në 18.1 përqind në Gjermani (17.1 përqind në qershor 2014) dhe në 14.4 përqind në Spanjë (13.5 përqind në qershor 2014). Megjithatë, vendet si Greqia dhe Italia u karakterizuan me përkeqësim të nivelit të kapitalizimit të sektorit ku në qershor 2015 niveli i kapitalizimit në Greqi ishte 10.3 përqind (16.2 përqind në qershor 2014) ndërsa në Itali ishte 14.5 përqind (15.0 përqind në qershor 2014). Vendet kryesore të eurozonës gjithashtu u karakterizuan me përmirësim të nivelit të likuiditetit në sektorin bankar, ku në qershor 2015 Gjermania regjistroi nivel të likuiditetit prej 45.4 përqind (45.2 përqind në qershor 2014), përderisa në Itali ky tregues ishte 16.8 përqind (16.4 përqind në Qershor 2014). Në anën tjetër, Greqia u karakterizua me rënie të nivelit të likuiditetit në 28.9 përqind nga 29.5 përqind sa ishte në qershor 2014. Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore, vendet si Italia dhe Greqia shënuan rritje të nivelit të kredive joperformuese (NPL). Në qershor 2015, niveli i NPL-ve arriti

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Banka Botërore (2015)

<sup>1</sup> 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

në 18.0 përqind në Itali (17.3 përqind në qershor 2014), dhe 34.7 përqind në Greqi (34.2 përqind në qershor 2014). Në anën tjetër, Spanja u karakterizua me rënie të nivelit të NPL-ve në 7.0 përqind nga 9.0 përqind sa ishte në qershor 2014. Indikatorët tjerë të performancës, siç janë ROA (Kthimi në Asete) dhe ROE (Kthimi në Kapital), shënuan gjithashtu përmirësim në shumicën e vendeve të Eurozonës, me përjashtim të Greqisë ku kemi përkeqësim të ROA në -3.3 përqind (-0.4 përqind në qershor 2014) dhe të ROE-s në -39.1 përqind (-4.7 përqind në qershor 2014).

Eurozona u karakterizua me rritje të aktivitetit kreditor gjatë vitit të fundit, ku sipas të dhënave të ECB-së, në qershor 2015 gjithsej kreditë shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind që paraqet një përmirësim të theksuar nga rënia prej 3.6 përqind në qershor 2014. Në kuadër të vendeve të eurozonës, Sllovenia regjistroi rënien më të thellë vjetore të kreditimit prej 12.1 përqind, ndërsa Holanda u karakterizua me rritjen më të lartë prej 12.1 përqind. Me zhvillime pozitive u karakterizuan edhe depozitat, të cilat në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 1.5 përqind që paraqet një përmirësim të rëndësishëm krahasuar me rënien prej 2.0 përqind në qershor 2014. Në kuadër të vendeve të eurozonës, Holanda regjistroi rritjen më të lartë vjetore të depozitave prej 12.1 përqind, ndërsa Sllovenia shënoi rënien më të thellë vjetore prej 6.3 përqind. Rjedhimisht, mesatarja e raportit të kredive ndaj depozitave në eurozonë ishte 100.7 përqind në qershor 2015. Niveli më i lartë i këtij treguesi prej 143.2 përqind u regjistrua në Qipro, ndërsa më i ulëti prej 60.2 përqind ishte në Maltë.

Sa i përket normës së interesit, eurozona u karakterizua me rënie të normës mesatare të interesit në kredi në 2.8 përqind në qershor 2015 nga 3.3 përqind sa ishte në qershor 2014. Norma më e ulët mesatare e interesit prej 1.7 përqind u regjistrua në Finlandë në qershor 2015, ndërsa më e larta prej 5.5 përqind u regjistrua në Qipro. Vendet kryesore të eurozonës shënuan rënie të normës mesatare të interesit në depozita prej 0.4 pikë përqindje dhe, si rrjedhojë, norma mesatare në depozita zbriti në 1.1 përqind në qershor 2015. Belgjika ishte vendi me normën më të lartë mesatare të interesit në depozita prej 1.9 përqind në qershor 2015. Ndërsa, Lituania u karakterizua me normën më të ulët mesatare të interesit në depozita prej 0.4 përqind në qershor 2015. Ndërsa, Greqia ishte vendi i cili shënoi rënien më të theksuar prej 0.9 pikë përqindje në normën mesatare të interesit në depozita. Dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në eurozonë zbriti në 1.7 pikë përqindje në qershor 2015 nga 1.8 pikë përqindje sa ishte në qershor 2014. Dallimi më i lartë në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita prej 3.2 pikë përqindje u regjistrua në Qipro, ndërsa ai më i ulëti prej 0.6 pikë përqindje u regjistrua në Belgjikë.

### Ambienti makroekonomik në Ballkanin Perëndimor

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në gjysmën e parë të vitit 2015 vlerësohet të ketë shënuar përmirësim. Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2015 pritet të mbështetet kryesisht nga përforcimi i kërkesës së jashtme, që pritet të reflektohet në rritjen e eksporteve të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor presin të shënojnë një rritje mesatare të PBB-së prej 2.8 përqind në vitin 2015. Mali i Zi pritet të karakterizohet me normën më të lartë të rritjes ekonomike prej 4.7 përqind, përderisa Serbia pritet të jetë vendi i vetëm që pritet të shënojë rënie ekonomike prej 0.5 përqind.

Vendet e Ballkanit Perëndimor në muajt e parë të vitit 2015 u karakterizuan me presione të dobëta inflacioniste, ndikuar kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe energjisë në nivel global. Megjithatë, FMN-ja parashikon një normë mesatare të inflacionit prej 0.9 përqind në vendet e regionit për vitin 2015. Shqipëria pritet të karakterizohet me shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind, pasuar nga Mali i Zi me 1.7 përqind, përderisa Maqedonia dhe Kosova pritet të jenë vendet me shkallën më të ulët të inflacionit prej 0.1 përqind përkatësisht -0.5 përqind.

## Sektori bankar në Ballkanin Perëndimor

Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor po ashtu u karakterizua me ecuri pozitive, e cila u reflektua në përmirësimin e indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Vendet e Ballkanit Perëndimor vijojnë të karakterizohen me nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të sektorit bankar. Gjatë vitit të fundit shumica e vendeve në regjion përforcuan nivelin e kapitalizimit, ku mesatarja e kapitalit rregullator ndaj asetëve të peshura me rrezik deri në qershor 2015 ishte 18.4 përqind (17.9 përqind në qershor 2014). Shqipëria ishte vendi i cili u karakterizua me rënie më të theksuar të nivelit të kapitalizimit i cili në qershor arriti në 15.9 përqind nga 17.5 përqind sa ishte në qershor 2014, kryesisht si rezultat i rritjes më të theksuar të asetëve të peshuara me rrezik kundrejt lëvizjeve në kapitalin rregullator. Niveli i likuiditetit në sektorin bankar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor shënoi rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak, duke zvogëluar mesataren e regjionit në 47.2 përqind në qershor 2015 (48.9 përqind në qershor 2014). Ballkani Perëndimor shënoi përmirësim edhe të kualitetit të portfolios kreditorë, ku niveli i kredive jo performuese arriti në 14.9 përqind në qershor 2015 krahasuar me nivelin prej 16.0 përqind në qershor 2014. Niveli më i ulët i NPL-ve prej 7.2 përqind në qershor 2015 u regjistrua në Kosovë, ndërsa niveli më i lartë prej 22.8 përqind ishte në Serbi. Po ashtu edhe treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim krahasuar me periudhën paraprake, ku ROA e rajonit u përmirësua në 1.2 përqind në qershor 2015 (0.7 përqind në qershor 2014), kurse ROE u përmirësua në 10.4 përqind në qershor 2015 (7.1 përqind në qershor 2014).

Aktiviteti kreditor në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rritje në krahasim me gjysmën e parë të vitit paraprak. Norma mesatare e rritjes së gjithsej kredive në regjion ishte 4.3 përqind. Rritja më e madhe e aktivitetit kreditor prej 8.5 përqind është shënuar në Maqedoni, ndërsa rritja më e vogël prej 0.2 përqindje ishte në Mal të Zi. Depozitat gjithashtu kanë shënuar rritje në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në krahasim me vitin e kaluar. Norma mesatare e rritjes së gjithsej depozitave në regjion ishte 7.3 përqind. Rritja më e madhe prej 12.0 përqind është regjistruar në Malin e Zi, ndërsa ajo më e ulët prej 4.4 përqind është shënuar në Shqipëri. Rrjedhimisht, mesatarja e raportit të kredive ndaj depozitave në regjion ishte 97.2 përqind, ku raporti më i lartë prej 127.3 përqind u regjistrua në Serbi, ndërsa më i ulëti prej 55.4 përqind ishte në Shqipëri.

Sa i përket normave të interesit në kredi në regjionin e Ballkanit Perëndimor, në përgjithësi kemi rënie në krahasim me vitin paraprak. Deri në qershor 2015, norma mesatare e interesit në kredi në regjion shënoi rënie prej 0.52 pikë përqindje duke arritur në 8.64 përqind (9.15 përqind në qershor 2014). Bosnja dhe Hercegovina, përveç që vazhdon të karakterizohet më normën më të ulët të interesit në kredi prej 5.6 përqind, gjithashtu shënoi rënie më të theksuar vjetore të normës mesatare të interesit në kredi prej 0.94 pikë përqindje. Serbia mbetet vendi me normën më të lartë mesatare të interesit në kredi, ku deri në qershor regjistroi normën 13.5 përqind. Për më tepër, Serbia ishte i vetmi vend në regjion i cili u karakterizua me rritje të normës mesatare të interesit prej 1.33 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Regjioni i Ballkanit Perëndimor gjithashtu shënoi rënie të normës mesatare të interesit në depozita prej mesatarisht 0.61 pikë përqindje dhe, si rrjedhojë, norma mesatare e interesit në depozita arriti në 2.24 përqind në qershor 2015. Kosova ishte vendi që regjistroi normën më të ulët të interesit në depozita prej 0.81 përqind në qershor 2015. Në anën tjetër Serbia, përkundër faktit që ishte vendi që u karakterizua me rënie më të theksuar vjetore prej 1.74 pikë përqindje, vazhdoi të mbetet vendi me normën më të lartë të interesit në depozita prej 5.0 përqind në qershor 2015. Pavarësisht rënies së normave të interesit në depozita, rënia më e theksuar e normave në kredi bëri që dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në rajonin e Ballkanit Perëndimor të qëndrojë në 6.4 pikë përqindje në qershor 2015 (6.3 pikë përqindje në qershor 2014). Dallimi më i lartë në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita prej 8.5 pikë


përqindje u regjistrua në Serbi, ndërsa ai me i ulëti prej 3.5 pikë përqindje u regjistrua në Bosnje dhe Hercegovinë.

### Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë

#### ProCredit Holding – PCH (Gjermani)

Vlera e gjithsej asetëve të grupit bankar ProCredit Holding (PCH) arriti në 6.1 miliardë euro në qershor 2015, duke shënuar rritje vjetore prej 5.6 përqind. Sipas shtrirjes regjionale, struktura e asetëve të grupit është e përqendruar në Evropën Juglindore e cila përfshinë 48.7 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Segmenti i dytë më i rëndësishëm është Gjermania me 21.2 përqind të gjithsej asetëve të grupit, pasuar nga Amerika Jugore dhe Evropa Lindore me pjesëmarrje prej 17.2 përqind përkatësisht 12.9 përqind. PCH gjatë vitit 2014 ka shitur segmentet e tyre në regjionin e Afrikës si dhe planifikon që të shesë edhe segmentet në Amerikën Jugore (figura 3). Gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, vendet e Evropës Juglindore dhe Gjermania u karakterizuan me rritje ekonomike duke ndikuar pozitivisht në performancën e grupit, përkundër recesionit të vendeve në Evropën Lindore dhe ngadalsimit ekonomik në vendet e Amerikës Jugore si rrjedhojë e devalvimit të valutës peso kundrejt dollarit amerikan dhe rënies së çmimeve të mallrave në Kolumbi.


Figura 3. Struktura e asetëve të PCH-së, në përqindje



Burimi: ProCredit Holding (2015)

Modeli i biznesit të grupit PCH vazhdon të jetë tradicional, ku aktiviteti kreditues financohet kryesisht nga depozitat e rezidentëve. Gjatë vitit të fundit, aktiviteti kreditues i grupit u rimëkëmb, ku në qershor 2015 gjithsej kreditë e grupit arritën vlerën prej 4.5 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.3 përqind krahasuar me rënie prej 0.4 përqind në qershor të vitit paraprak. Rimëkëmbja përkon me ecurinë e depozitave të cilat gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me përsheptim të rritjes, ku deri në qershor 2015 arritën vlerën 4.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.8 përqind (1.3 përqind në qershor 2014). Rrjedhimisht, raporti i kredive ndaj depozitave në qershor 2015 u zvogëlua në 110.5 përqind nga 114.3 përqind sa ishte në qershor 2014.

Figura 4. Treguesit e efikasitetit të PCH-së, në përqindje



\*ROE - 2015 e aktualizuar  
Burimi: ProCredit Holding (2015)

Grupi PCH gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2015 shënoi përmirësim të indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, i cili në qershor 2015 ishte 70.2 përqind, që paraqet një rënie prej 3.6 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak (figura 4). Përmirësimi i atribuohet kryesisht rënies më të shpejtë prej 7.6 përqind të shpenzimeve operacionale dhe rritjes së lehtë prej 0.4 përqind të të hyrave operacionale. Rënia më e shpejtë e shpenzimeve operacionale ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin, që shënuan rënie vjetore prej 13.0 përqind, si dhe reduktimit të shpenzimeve administrative që shënuan rënie vjetore prej 2.3 përqind.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 7.5 përqind pavarësisht që aktiviteti kreditues i grupit shënoi rritje gjatë kësaj periudhe. Kurse, të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind deri në qershor 2015. Përkundër rënies së të hyrave, menaxhimi më i mirë i shpenzimeve siguroi që profiti i grupit deri në qershor 2015 të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Deri në qershor 2015, profiti i realizuar arriti në 33.1 milionë euro (22.9

milionë euro deri në qershor 2014). Rritja e fitimeve ndikoi në përmirësimin e ndjeshëm të normës së kthimit në kapital (ROE) (e analizuar), e cila arriti në 11.6 përqind krahasuar me 9.4 përqind sa ishte në vitin 2014. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*) shënoi vlerën prej 11.7 përqind në qershor 2015 (12.4 përqind në qershor 2014), duke vazhduar t'i përmbushë kërkesat rregullatore të adekuatshmërisë së kapitalit (figura 4).

Performanca e grupit pritet të vazhdojë të përmirësohet edhe gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015, e ndikuar ndër tjerash edhe nga zhvillimet makroekonomike në vendet ku operon. Kjo sepse fillimisht Gjermania, vendi i origjinës së PCH-së, pritet që edhe deri në fund të vitit 2015 të ketë rritje ekonomike të përshpejtuar e mbështetur nga rënia e çmimit të naftës, tregut të fortë të punës si dhe rritjes së shpenzimeve publike për akomodimin e fluksit të refugjatëve që po përballet e gjithë Evropa gjatë këtij viti. Ngjashëm, ekonomitë e Evropës Juglindore gjatë vitit 2015 pritet të kenë rritje më të lartë ekonomike krahasuar me vitin e kaluar. Performanca e grupit varet mjaft shumë nga performanca në Serbi, Kosovë dhe Bullgari ku operojnë tri filialat më të mëdha të grupit. Edhe pse Bullgaria parashikohet që gjatë vitit 2015 të shënojë ngadalësim të rritjes, efekti negativ i saj mund të neutralizohet nga Serbia e cila pritet që të shënojë rimëkëmbje ekonomike nga rënia e vitit të kaluar që kishte ardhur si rezultat i përmbytjeve duke dëmtuar sektorin e bujqësisë. Duke pasur parasysh që pjesëmarrja e aseteve të Procredit në Kosovë në gjithsej asetet e grupit në qershor 2015 ishte 12.8 përqind performanca e grupit mund të ndikohet pozitivisht nga ekonomia e Kosovës e cila pritet që të shënojë rritje të përshpejtuar si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme për konsum, rritjes së investimeve private dhe atyre publike.

#### Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Vlera e gjithsej aseteve të grupit bankar Raiffeisen Bank International (RBI) arriti në 119.7 miliard euro në qershor 2015, duke shënuar rënie vjetore prej 5.9 përqind. Sipas shtrirjes regjionale, Austria mbanë pozitën udhëheqëse në strukturën e aseteve e cila përfaqëson 29.9 përqind të gjithsej aseteve të grupit, pasuar nga Evropa Qendrore si segment tjetër i rëndësishëm që përfaqëson rreth 20.9 përqind të gjithsej aseteve të grupit. Evropa Juglindore me 17.8 përqind është e treta dhe pasohet nga Evropa Lindore me përfaqësim prej 14.6 përqind të gjithsej aseteve të grupit. Pjesa tjetër përfshinë asetet e njësive në Azi dhe Amerikë të cilat janë planifikuar të reduktohen apo të shiten deri në fund të vitit 2017 (figura 5). Vendet në të cilat operon grupi gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 u karakterizuan me rimëkëmbje ekonomike (vendet në Evropën Qendrore) si dhe rritje të moderuar ekonomike (Evropa Juglindore), ndërsa vendet e Evropës Lindore në të cilat operon grupi, u përballën me recesion duke ndikuar negativisht në performancën e grupit. Zvogëlimi i aseteve të RBI-së u ndikua kryesisht nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në Austri, nga vënia e sanksioneve ekonomike ndaj Rusisë, gjë që thelloi recesionin në këtë vend, nga zhvlerësimi i valutave të Ukrainës dhe Rusisë ndaj dollarit dhe euros, si dhe nga ndryshimet në legjislacionin bankar në Hungari (Settlement Act).

Modeli i biznesit të grupit bankar RBI vazhdon të jetë tradicional me aktivitet kryesisht kreditor të financuar nga depozitat (figura 6). Gjatë vitit të fundit, aktiviteti kreditor i grupit u karakterizua me rënie vjetore prej 5.6 përqind ku gjithsej kreditë e RBI-së, deri në qershor 2015, arritën vlerën 76.3 miliard euro.

Figura 5. Struktura e aseteve të RBI-së, në përqindje





Figura 6. Ecuria e kredive dhe depozitave të RBI-së, në përqindje



Burimi: Raiffeisen Bank International (2015)

Kjo rënie u ndikua kryesisht nga rënia e kredive në Rusi dhe në Ukrainë, si dhe nga rënia e kredive në valutë të huaj në Hungari si rezultat i ndryshimeve në legjislacionin bankar.

Vlera e depozitave deri në qershor 2015 arriti në 67.0 miliard euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 4.1 përqind, që rrjedhë kryesisht nga rritja e depozitave në Republikën Çeke si rezultat i rimëkëmbjes ekonomike në këtë vend. Si rrjedhojë e rënies së kredive krahas rritjes së nivelit të depozitave, raporti kredi/depozita rezultoi në 113.8 përqind në qershor 2015, që paraqet rënie për 11.7 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Sa i përket indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, të shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, grupi RBI shënoi përqesim ku indikatorin arriti në 56.8 përqind në qershor 2015, nga 55.3 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 7). Kjo rritje prej 1.5 pikë përqindje i atribuohet rënies më të shpejtë prej 11.0 përqind të të hyrave operacionale, krahas rënies së shpenzimeve operacionale prej 8.6 përqind në qershor 2015. Rënia më e shpejtë e gjithsej të hyrave operacionale u ndikua kryesisht nga të hyrat nga interesi që shënuan rënie vjetore prej 12.0 përqind, ndikuar kryesisht nga luhatjet e mëdha valutore (zhvlerësimi i valutës ruse dhe ukrainase), rritja e kredive jo-performuese në Azi, si dhe normat e ulëta të interesit në Poloni.

Në kuadër të shpenzimeve operacionale, shpenzimet e personelit u karakterizuan me rënie vjetore prej 15.5 përqind, ndërsa shpenzimet tjera administrative shënuan rënie prej 0.7 përqind deri në qershor 2015. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, RBI ka ndarë 24 milionë euro shtesë si shpenzimeve për provizione ndaj humbjeve nga kreditë për segmentin e zyrës qendrore të grupit si dhe për filialën në Rusi si rezultat i gjendjes së pafavorshme ekonomike në këtë vend. Në filialën e RBI në Ukrainë, provizionet ndaj humbjeve të mundshme rezultuan më të ulëta kryesisht si efekt i zhvlerësimit të valutës. Deri në qershor 2015 grupi RBI regjistroj fitim neto prej 288 milion euro që shënon rënie vjetore prej 16.4 përqind, gjë që mund të jetë ndikuar negativisht nga performanca ekonomike në Rusi dhe Ukrainë. Me gjithë zvogëlimin e profitit, treguesi i raportit të kthimit në kapital (ROE) shënoi përmirësim të dukshëm i cili në qershor 2015 qëndroi në 11.0 përqind (e anualizuar), që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me normën prej 0.2 përqind sa ishte për vitin 2014. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në qershor 2015 qëndroi në 16.6 përqind, krahasuar me normën prej 16.8 përqind sa ishte në qershor 2014, që mbetet mjaft mbi nivelin minimal prej 8 përqind të përcaktuar me kërkesat rregulatore të Basel III (figura 7). Kurse, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor 2015 u rrit në 11.9 përqind krahasuar me 10.7 përqind sa ishte në qershor 2014. Në qershor 2015, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione qëndroi në 66.6 përqind (65.3 përqind në qershor 2014).

RBI vazhdon të jetë e vetmja nga tri grupet bankare kryesore që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion të RBI-së në bursën e Vjenës në qershor 2015 u zvogëlua në 13.05 euro, krahasuar me 23.32 euro sa ishte në qershor 2014. Kjo rënie e çmimit të aksionit, ndër tjerash, erdhi si rezultat i paqëndrueshmërisë ekonomike në Ukrainë dhe Rusi.

Zhvillimet ekonomike në vendet ku vepron grupi RBI pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën e grupit RBI. Austria, përkundër rritjes më të ngadalësuar ekonomike gjatë kësaj periudhe, pritet që deri në fund të vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016 të ketë ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike që janë destinuar për emigracionin. Ngjashëm, ekonomitë e Evropës Juglindore gjatë vitit 2015 pritet të kenë rritje më të lartë ekonomike. Trend pozitiv i rritjes ekonomike pritet të vazhdojë edhe në vendet e Evropës Qendrore si rezultat i rritjes ekonomike në Gjermani që është partneri më i madh tregtar i këtyre vendeve. Ndërsa, rënia ekonomike e Rusisë pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2016 si rrjedhojë e vazhimit të sanksioneve dhe rënies së çmimit të naftës. Pjesëmarrja e ulët prej 0.68 përqind e aseteve të Raiffeisen Bank të Kosovës në gjithsej asetet grupit sugjeron që ndikimi i performancës së

Figura 7. Treguesit e efikasitetit të RBI-së, në përqindje



\*ROE - 2015 e anualizuar  
Burimi: Raiffeisen Bank International (2015)




Raiffesien Bank të Kosovës dhe ambientit makroekonomik të Kosovës në performancën e grupin mbetet i kufizuar.

### Nova Ljubljanska Banka- NLB (Slloveni)

Grupi bankar NLB gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015 u karakterizua me rënie të aktivitetit, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përderisa treguesit e performancës financiare dhe të qëndrueshmërisë shënuan përmirësim. Në qershor 2015, vlera e gjithsej asetëve të grupit arriti në 11.6 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 5.3 përqind. Sa i përket shtrirjes regjionale të asetëve të grupit, Sllovenia përfaqëson tregun kryesor me 69.7 përqind të gjithsej asetëve të grupit. Evropa Juglindore gjithashtu është një treg mjaft i rëndësishëm për grupin NLB, duke pasur parasysh që 29.4 përqind e gjithsej asetëve të grupit janë të investuara në këtë regjion. Pjesa e mbetur e asetëve të grupit janë të investuara në Evropën Perëndimore dhe atë Qendrore me një përfaqësim prej 0.9 përqind (figura 8). Me rritje të moderuar ekonomike u karakterizuan disa vende të Evropës Juglindore në të cilat operon grupi, përderisa ekonomia e Sllovenisë u karakterizua me rritje më të lartë ekonomike si rezultat i rritjes së eksporteve dhe forcimit të kërkesës së brendshme për konsum. Sidoqoftë, përkundër zhvillimeve pozitive në ambientin makroekonomik aktiviteti i sektorit bankar në Slloveni shënoi rënie, përfshirë këtu edhe grupin NLB, i cili duke qenë në fazën e ristrukturimit u karakterizua me rënie të aktivitetit.


Figura 8. Struktura e asetëve të NLB Group, në përqindje,



Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2015)

Edhe grupi NLB ndjekë një model tradicional të biznesit duke marrë parasysh që aktiviteti i grupit është kryesisht kreditues dhe financohet nga depozitat. Ngjashëm me grupin RBI, edhe grupi NLB gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rënie të aktivitetit të kreditimit, ku në qershor 2015, vlera e gjithsej kredive ishte 9.0 miliard euro, që paraqet rënie vjetore prej 4.5 përqind. Rënia ishte kryesisht si rezultat i procesit të ristrukturimit të sektorit bankar në Slloveni si rrjedhojë e mbingarkesës me borxh si dhe nivelit ende të lartë të kredive joperformuese në bilancet e bankave. Me rënie u karakterizuan edhe depozitat, vlera e të cilave në qershor 2015 arriti në 8.7 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 0.5 përqind (figura 9). Rënia më e theksuar e kredive, krahas rënies së lehtë të depozitave, ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 103.0 përqind në qershor 2015 nga 107.3 sa ishte në qershor 2014.

Figura 9. Ecuria e kredive dhe depozitave të NLB Group, në përqindje




Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2015)

Grupi NLB në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015 përmirësoi treguesit kyç të efikasitetit dhe performancës financiare. Indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, shënoi rënie vjetore për 0.4 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 59.5 përqind në qershor 2015 (figura 9). Ky përmirësim i atribuohet zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve të provizioneve për humbjet në kredi për 37.8 përqind, përderisa të hyrat operationale u zvogëluan për 2.9 përqind. Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 9.7 përqind, kurse të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind deri në qershor 2015. Mirëpo, neto të hyrat nga interesi dhe neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje, si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për interesa dhe tarifa. Në kuadër të shpenzimeve operationale, shpenzimet për personelin shënuan rënie vjetore prej 2.1

përqind deri në qershor 2015, përderisa shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rënie vjetore prej 2.9 përqind.

Grupi arriti që të mbyllë gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015 me profit prej 53.4 milionë euro (34.0 milionë në gjashtëmuajorin e parë 2014), gjë që u reflektua edhe në normën e kthimit në kapital (ROE) (e anualizuar) e cila u përmirësua në 7.8 përqind nga 4.8 përqind sa ishte në vitin 2014. Po ashtu, grupi ka përforcuar nivelin e kapitalizimit shprehur përmes treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), që arriti në 15.9 përqind në qershor 2015 krahasuar me 15.7 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 10). Lëvizje pozitive u shënuan edhe në cilësinë e portofolit kreditor, ku raporti ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive u zvogëlua në 24.6 përqind në qershor 2015 krahasuar me 25.8 përqind sa ishte në qershor 2014. Ndërsa, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione në qershor 2015 ishte 69.4 përqind krahasuar me 70.7 përqind në qershor 2014.

Figura 10. Treguesit e efikasitetit të NLB Group, në përqindje



\*ROE - 2015 e anualizuar

Burimi: Nova Ljubljanska Banka (2015)


## 4. Ekonomia e Kosovës

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit ekonomik gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Sipas vlerësimeve të ASK-së, tremujori i parë u karakterizua me rritje vjetore prej 0.2 përqind, ndërsa në tremujorin e dytë ekonomia e vendit përshpejtoi ritmin e rritjes duke regjistruar rritje vjetore prej 3.4 përqind. Rritja ekonomike në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto vazhduan të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike.

Parashikimet e BQK-së për vitin 2015 sugjerojnë përshpejtim të rritjes ekonomike krahasuar me vitin e kaluar. Norma e rritjes së PBB-së reale për vitin 2015 vlerësohet të jetë 3.5 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.2 përqind që është regjistruar në vitin 2014 (figura 11). Parashikimi për rritjen ekonomike në vitin 2015 kryesisht bazohet në rritjen e investimeve private dhe të konsumit privat. Megjithatë, për dallim nga viti paraprak, kur investimet dhe konsumi publik kishin shënuar rënie, këto dy kategori pritet të karakterizohen me rritje deri në fund të vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Norma më e lartë e rritjes reale të importit të mallrave dhe shërbimeve krahasuar me eksportin vlerësohet të ketë ndikuar që kontributi i neto eksporteve në rritjen reale të PBB-së të jetë negativ.


Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me rënie të çmimeve. Shkalla e inflacionit, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 ishte -0.4 përqind (figura 12). Kontributin kryesor në rënie e çmimeve e kishin kategoritë e çmimeve të transportit e cila ndikoi negativisht me 1.7 pp, pastaj kategoritë e orendive dhe veshmbathjes të cilat ndikuan negativisht me nga 1.2 pp, si dhe shëndetësia dhe arsimit të cilat kontribuan negativisht me nga 0.4 përkatësisht 0.2 pp.<sup>2</sup> Në anën tjetër, ushqimi dhe pijet joalkoolike kanë kontribuar pozitivisht me 3.4 pikë përqindje, si dhe energjia me 1.8 pikë përqindje.

Figura 11. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



Burimi: ASK (2014) dhe vlerësimet e BQK-së për vitin 2015

Figura 12. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2015)

<sup>2</sup> Kalkulimi i kontributit të komponentëve të IÇK-së në nivelin e inflacionit, përveç lëvizjes së çmimeve, bazohet edhe në peshën që kanë komponentët e caktuar në IÇK. Mund të ndodhë që ndonjë kategori e caktuar të ketë shënuar rritje të çmimeve por në të njëjtën kohë zvogëlim të peshës në gjithsej IÇK-në. Në këtë rast, nëse zvogëlimi i peshës është më i lartë se sa rritja e çmimit atëherë kontributi është negativ në gjithsej IÇK-në.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, komponentët e CPI-së si rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse shënuan rritje të çmimit për mesatarisht 4.9 përqind, pijet alkoolike dhe duhani 3.4 përqind dhe veshmbathja 1.9 përqind. Zhvillim të ngjashëm kishte edhe te çmimet dhe pijeve joalkoolike, të cilat shënuan rritje prej 1.1 përqind. Ushqimi dhe pijet joalkoolike përfaqësojnë rreth 40.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar. Në anën tjetër, rënie më e theksuar e çmimeve u evidentua te shërbimet e transportit për mesatarisht 7.9 përqind, rënie kjo që kishte kontributin kryesor në rënien e treguesit të përgjithshëm të inflacionit. Shërbimet e transportit<sup>3</sup> përfaqësojnë rreth 13.1 përqind të shportës së konsumatorit, ndërkohë që rënia e shënuar në çmimet e këtyre shërbimeve kryesisht i atribuohet rënies së çmimeve të derivateve të naftës.

Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, si dhe pjesëmarrjes relativisht të lartë të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme në shportën e konsumatorit, lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare vazhdojnë të jenë përcaktuesi kryesor i lëvizjes së çmimeve në vend. Indeksi i çmimeve të importit shënoi rënie vjetore prej mesatarisht 0.4 përqind në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, ndërsa çmimet e prodhimit shënuan rritje prej 3.9 përqind.

Deri në qershor 2015, sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve kundrejt vitit paraprak. Të hyrat primare buxhetore deri në qershor 2015 arritën vlerën bruto prej 661.2 milionë euro. Nëse zbriten 15.0 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat primare buxhetore shënojnë vlerën neto prej 646.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.2 përqind. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 667.2 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 5.8 përqind. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, shpenzimet rrjedhëse të qeverisë arritën vlerën prej 544.4 milion euro, një rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak prej 11.6 përqind. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, me rritje më të lartë u karakterizuan kategoria e pagave dhe mëditjeve (11.1 përqind) dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve (19.5 përqind). Në anën tjetër, shpenzimet kapitale shënuan vlerën prej 115.6 milion euro në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, që përkon me një rënie vjetore prej 15.4 përqind. Buxheti i Kosovës regjistroi deficit prej 21.1 milionë euro deri në qershor 2015 (28.2 milion euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Deri në qershor të vitit 2015, borxhi publik arriti vlerën prej 649.1 milionë euro apo 11.2 përqind e PBB-së, krahasuar me 554.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar apo 10.2 përqind e PBB-së.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, si dhe përmirësim të llogarisë financiare. Deficiti në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 213.9 milionë euro në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, krahasuar me vlerën prej 192.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave, si dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe llogarive të të ardhurave parësore dhe dytësore.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit tregtar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, gjegjësisht me rritje të vlerës së gjithsej eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve. Megjithatë, përkundër rritjes së eksportit të mallrave në periudhën raportuese për 14.5 përqind, rritja e vlerës së mallrave të importuara prej 5.1 përqind ka ndikuar në rritjen e deficitit tregtar të mallrave për 3.7 përqind (figura 13). Kjo si rezultat i peshës shumë më të madhe të importeve në krahasim me eksportet në tregtinë e jashtme të Kosovës. Ngjashëm me eksportin e mallrave, edhe eksporti i shërbimeve u karakterizua me rritje prej 10.8 përqind në

<sup>3</sup> Shërbimet e transportit përfshijnë nënkategoritë: Blerja e automjeteve; Përdorimi i pajisjeve për transportin personal; dhe Shërbimet për transport.

gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015, mirëpo rritja më e shpejtë e vlerës shërbimeve të importuara prej 24.2 përqind ndikoi në zvogëlimin e bilancit pozitiv të shërbimeve për 3.9 përqind.

Kategoria e të ardhurave dytësore vazhdon të ndikojë në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale të bilancit të pagesave të Kosovës. Remitencat si njëra ndër komponentët kryesorë të llogarisë rrjedhëse shënuan rritje prej 15.8 përqind në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 dhe arritën vlerën prej 337.2 milionë euro.


Në kuadër të bilancit të pagesave, llogaria financiare regjistroi bilanc prej -154.5 milionë euro në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 krahasuar me bilancin prej -82.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e IHD-ve, ndërsa tek asetet kategoria kryesore ishin investimet tjera (kryesisht depozita dhe kredi tregtare) jashtë ekonomisë së Kosovës. Bilanci i IHD-ve u karakterizua me përmirësim në vitin 2015, kryesisht si rezultat i rritjes së IHD-ve në vend në 153.1 milionë euro deri në qershor 2015, nga 39.1 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Sistemi financiar është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Roli i sektorit bankar në financimin e aktivitetit ekonomik në vend u përforcua gjatë vitit 2015. Përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kreditues gjatë kësaj periudhe, nxitur si nga oferta ashtu edhe nga ana e kërkesës, ka mbështetur rritjen e mëtejme të konsumit dhe investimeve private në vend.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015 u regjistruan gjithsej 5,069 ndërmarrje të reja apo 241 ndërmarrje më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa u mbyllën 936 ndërmarrje apo 55 ndërmarrje më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar, ku dominojnë ndërmarrjet në sektorët si tregtia, hoteleria, prodhimi, ndërtimtaria dhe bujqësia. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2015, me zvogëlim të numrit të bizneseve të regjistruara u karakterizua sektori i tregtisë (56 ndërmarrje më pak), prodhimi (29), ndërtimtaria (61), hotelieria (59) dhe aktivitetet profesionale (43 ndërmarrje më pak). Ndërkaq, sektorët që janë karakterizuar me rritje të numrit të ndërmarrjeve të regjistruara ishin bujqësia (76 ndërmarrje më shumë), shëndetësia (14), aktivitete financiare (7), furnizimi me energji (6) dhe transporti (5 ndërmarrje më shumë).

Parashikimet e BQK-së për vitin 2016 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të ketë rritje më të lartë krahasuar me vitin 2015. Kjo rritje sikurse në vitin 2015 pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e PBB-së. Konsumi, si komponenti kryesor e kërkesës së brendshme, pritet që edhe gjatë vitit 2016 të ketë kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Investimet, për dallim nga viti 2015, pritet të karakterizohen me rritje të konsiderueshme të investimeve publike. Po ashtu, zvogëlimi i normave të interesit në kredi si dhe lehtësimi i standardeve për aprovimin e kredive nga ana e bankave pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në nxitjen e investimeve të sektorit privat. Edhe IHD-të, të cilat u karakterizuan me rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2015, pritet të kontribuojnë në rritjen e gjithsej investimeve. Eksportet neto pritet të vazhdojnë të ketë ndikim negativ në rritjen e PBB-së.

Figura 13. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2015)

## 5. Sistemi Financiar i Kosovës

### 5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Sistemi financiar i Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 u karakterizua me zgjerim të mëtutjeshëm të veprimtarisë, edhe pse me ritëm më të ngadalshëm. Vlera e gjithsej asetëve të sistemit në qershor 2015 arriti në 4.73 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.5 përqind (figura 14). Kjo rritje i atribuohet në masë të konsiderueshme zgjerimit të aktivitetit të bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Kontribut më të vogël kishte sektori i sigurimeve, përderisa efekti i sektorit mikrofinanciar dhe i ndihmësve financiar, pavarësisht rritjes të aktivitetit të tyre, ishte mjaftë i ulët.

Struktura e sistemit financiar vazhdon të dominohet nga sektori bankar dhe ai pensional, të cilët në qershor 2015 përfaqësuan 69.1 përqind përkatësisht 25.0 përqind të gjithsej asetëve të sistemit (figura 15). Rrjedhimisht, ngadalësimi i rritjes së asetëve të gjithsej sistemit financiar kryesisht reflekton ngadalësimin e rritjes së këtyre dy sektorëve. Gjatë kësaj periudhe, sektori pensional shënoi normën më të lartë të rritjes vjetore të asetëve prej 18.1 përqind, pasuar nga sektori bankar i cili u karakterizua me rritje vjetore prej 6.9 përqind. Komponenti i tretë me radhë për nga madhësia e asetëve është sektori i sigurimeve i cili në qershor 2015 rriti pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sistemit financiar në 3.2 përqind. Sektori i sigurimeve në qershor 2015 regjistroi rritje vjetore prej 11.5 përqind duke u bërë një nga dy sektorët përbërës të sistemit financiar të cilët gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me rritje të përshpejtuar të aktivitetit.

Sektori mikrofinanciar, i cili pason sektorin e sigurimeve me pjesëmarrje prej 2.5 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, gjatë kësaj periudhe gjithashtu shënoi rritje të përshpejtuar të aktivitetit. Asetet e sektorit mikrofinanciar në qershor 2015 regjistruan rritje vjetore prej 2.8 përqind. Pësha e ndihmësve financiar në gjithë sistemin vazhdon të jetë e ulët me një përfaqësim prej vetëm 0.2 përqind në

Figura 14. Asetet e sistemit financiar dhe sektorëve përbërës, ndryshimi vjetor




Figura 15. Struktura e asetëve të sistemit financiar





Figura 16. Ndërmjetësimi financiar sipas sektorëve në Kosovë




gjithsej asetet e sistemit financiar, përkundër rritjes vjetore prej 12.6 përqind të shënuar në qershor 2015.

Ndërmjetësimi financiar në vend, i llogaritur si raport i aseteve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është zgjeruar gjatë kësaj periudhe, edhe pse me ritëm më të ngadalshëm. Në qershor 2015, norma e ndërmjetësimit financiar në vend është rritur në 82.7 përqind krahasuar me 78.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zgjerimi reflekton zhvillimet pozitive të pjesës dërmuese të sektorëve përbërës, përjashtuar sektorin mikrofinanciar i cili u karakterizua me rënie të lehtë të pjesëmarrjes në ndërmjetësimin financiar. Sektori pensional dhe sektori bankar shënuan rritje më të madhe të peshës së tyre në ndërmjetësimin financiar në vend, përderisa sektori i sigurimeve shënoi rritje më të lehtë të pjesëmarrjes (figura 16).

Përkundër rritjes, shkalla e ndërmjetësimit financiar e sektorit bankar në Kosovë vazhdon të jetë relativisht e ulët krahasuar me vendet e rajonit (figura 17). Bazuar në këtë, mund të kuptohet se, në raport me madhësinë e ekonomisë, sektori financiar i Kosovës ka ende hapësirë për rritje të shkallës së ndërmjetësimit financiar për të konvergjuar drejtë mesatares së vendeve tjera të rajonit.

Struktura e sistemit financiar është zgjeruar edhe për sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në vend. Deri në qershor 2015, në tregun vendor janë shtuar dy kompani të sigurimit të themeluara me kapital vendor. Gjithashtu, numri i ndihmësve financiar arriti në 43 nga 41 sa ishin në qershor të vitit 2014. Ndërsa, numri i bankave komerciale, fondeve pensionale dhe institucioneve mikrofinanciare mbeti i pandryshuar. Nga gjithsej 88 institucione financiare të licencuara për të operuar në vend, pjesa më e madhe e tyre përbëhet nga institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar, numri i të cilave së bashku arriti në 61 në qershor 2015 (tabela 1).

Figura 17. Ndërmjetësimi financiar i sektorit bankar në rajon



Burimi: Bankat Qendrore të rajonit (2015)

Tabela 1. Numri i institucioneve financiare<sup>4</sup>

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Bankat komerciale	8	9	10	10
Kompanitë e sigurimeve	13	13	13	15
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	39	40	41	43
Institucionet mikrofinanciare	19	18	18	18

Burimi: BQK (2015)

<sup>4</sup> Numri i institucioneve financiare paraqet numrin e institucioneve që janë të licencuara të operojnë në tregun e Kosovës.

## 5.2 Ekspozimi ndaj sektorit të jashtëm<sup>5</sup>


Në qershor 2015, vlera e investimeve në sektorin e jashtëm arriti në 1.63 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 22.0 përqind.<sup>6</sup> Rritja e përsheptuar kryesisht ishte si rrjedhojë e rritjes së investimeve të fondeve pensionale në sektorin e jashtëm.

Struktura e aseteve të jashtme përbëhet kryesisht nga asetet dhe ekuitetet tjera me pjesëmarrje prej 64.8 përqind, pasuar nga depozitat me pjesëmarrje prej 16.0 përqind dhe letrat me vlerë me pjesëmarrje prej 14.1 përqind. Pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë me 5.0 përqind dhe asetet tjera me 0.2 përqind (figura 18).

Në kuadër të gjithsej aseteve të jashtme, normën më të lartë të rritjes vjetore prej 40.3 përqind e shënuan asetet dhe ekuitetet, pasuar nga depozitat e bankave të mbajtura në sektorin e jashtëm të cilat shënuan rritje prej 20.2 përqind. Rritja e aseteve dhe ekuiteteve tjera të investuara në sektorin e jashtëm ishte si rrjedhojë e tërheqjes së pjesës më të madhe të mjeteve që Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës i mbante në BQK dhe investimi i tyre në sektorin e jashtëm. Ndërsa, rritja e investimeve në depozita në sektorin e jashtëm ishte si rezultat i plasimit të mjeteve nga ana bankave komerciale në alternativa të tjera siq janë depozitat në sektorin e jashtëm në kushtet e nivelit të lartë të likuiditetit në vend. Në anën tjetër, investimet në kategoritë tjera në sektorin e jashtëm u karakterizuan me rënie, nga të cilat normën më të theksuar të rënies prej 31.8 përqind e shënuan kreditë, pasuar nga investimet në letra me vlerë të cilat shënuan rënie dukshëm më të ulët prej 5.2 përqind. Rënia e këtyra kategorive ndër tjerash mund të reflektojë përsheptimin e rritjes së kreditimit bankar në vend si dhe normat më të favorshme të interesit në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës krahasuar me kthimin në letrat me vlerë në tregjet e jashtme.


Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në qershor 2015 arriti në 266.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.3 përqind. Struktura e detyrimeve të jashtme vazhdon të dominohet nga kreditë me pjesëmarrje prej 62.9 përqind, pasuar nga depozitat me 35.3 përqind dhe detyrimet tjera me pjesëmarrje prej 1.8 përqind (figura 19). Rrjedhimisht, ngadalësimin e rritjes së gjithsej detyrimeve të jashtme është reflektuar nga ngadalësimi i rritjes së depozitave dhe kredive nga sektori i jashtëm. Në qershor 2015, kreditë e pranuar nga sektori i jashtëm shënuan rritje vjetore prej 4.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 23.2 përqind në qershor

Figura 18. Struktura e kërkesave të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 19. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

<sup>5</sup> Në këtë kontekst, sistemi financiar nuk përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

<sup>6</sup> Në kuadër të kërkesave të sistemit financiar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm nuk është përfshirë kategoria "paraja e gatshme". Në statistikat monetare dhe financiare, kategoria "paraja e gatshme" trajtohet si aset i jashtëm (kërkesa ndaj jorezidentëve) për faktin se valuta euro nuk është valutë kombëtare e Kosovës, mirëpo në këtë analizë këto mjete nuk janë trajtuar si të tilla për shkak se ato janë mjete që mbahen në bankat në Kosovë.



2014. Ngadalësimi i theksuar mund të jetë rezultat i prezencës së mjaftueshme të likuiditetit në sektorin bankar. Kategoria e depozitave në qershor 2015 shënoi rritje vjetore prej 1.3 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 20.2 përqind në qershor 2014. Ngadalësimi i rritjes së depozitave të jo-rezidentëve kryesisht mund të jetë ndikuar nga niveli i ulët i normave të interesit në depozita në sektorin bankar të Kosovës gjatë dy viteve të fundit.


Rrjedhimisht, vlera e aseteve të jashtme neto (AJN) të sistemit financiar të Kosovës në qershor 2015 arriti në 1.36 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 26.5 përqind. Fondet pensionale vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të AJN-ve (77.7 përqind), rrjedhimisht edhe kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej AJN-ve. Bilancit pozitiv të gjithsej AJN-ve i kontribuojnë edhe AJN-të e sektorit bankar me pjesëmarrje prej 26.8 përqind, përderisa AJN-të e sektorit mikrofinanciar ishin i vetmi segment që shënoi bilanc negativ të AJN-ve prej -4.6 përqind të gjithsej AJN-ve të sistemit financiar, gjë që është rezultat i mbështetjes së lartë të këtyre institucioneve në financimin e jashtëm përmes linjave kreditore (figura 19).

Ekspozimi i gjithsej sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit më të ulët në kuadër të detyrimeve. Më konkretisht, raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sistemit financiar në qershor 2015 arriti në 34.5 përqind (25.0 përqind në qershor 2014), ndërsa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sistemit qëndroi në 5.6 përqind (6.0 përqind në qershor 2014) (figura 20).

Për sa i përket sektorëve, sektori bankar vazhdon të ketë neto ekspozimin më të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Raporti i aseteve të jashtme ndaj gjithsej aseteve të sektorit bankar është 17.4 përqind, përderisa raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithsej detyrimeve të sektorit është 6.2 përqind. Në kuadër të sektorit bankar, bankat e mëdha vërehet të jenë më të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm në krahasim me bankat e vogla, si në kuadër të aseteve ashtu edhe në kuadër të detyrimeve. Kjo reflekton faktin se bankat më të mëdha, të cilat kryesisht janë banka të huaja, kanë një shkallë më të lartë të ndërveprimit me sektorin e jashtëm dhe veçanërisht me bankat e tyre amë.

Sektori i fondeve pensionale vazhdon të jetë i ekspozuar ndaj sektorit të jashtëm në kuadër të aseteve. Në qershor 2015, asetet e investuara jashtë vendit përbënin 89.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit pensional. Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar është i ekspozuar vetëm në kuadër të detyrimeve dhe deri në qershor 2015 niveli i ekspozimit ishte 53.6 përqind e gjithsej detyrimeve. Sektori mikrofinanciar ka ekspozim të lartë në kuadër të detyrimeve për arsye së shfrytëzon linjat kreditore të jashtme për të financuar aktivitetin kreditues, duke pasur parasysh se IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të pranojnë depozita.

Figura 20. Ekspozimi i jashtëm sipas sektorëve financiar



\*Sistemi financiar nuk përfshinë BQK-në  
Burimi: BQK (2015)

## 6. Sektori Bankar i Kosovës


### 6.1 Struktura e Sektorit Bankar

Bankat me pronësi vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar të Kosovës, ku nga gjithsej dhjetë banka të licencuara të operojnë në vend, tetë janë me pronësi të huaj dhe menaxhojnë 90.4 përqind të gjithsej aseteve dhe zotërojnë 93.0 përqind të gjithsej kapitalit të sektorit bankar. Shikuar sipas vendit të origjinës së bankave, Austria, Gjermania, Sllovenia, Shqipëria dhe Serbia përfaqësohen me nga një bankë të vetme, përderisa Turqia përfaqësohet nga tri banka<sup>7</sup> (figura 21). Në sektorin bankar të Kosovës operojnë edhe dy banka me pronësi vendore.

Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me rënie të shkallës së koncentrimit në treg edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015. Pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit, në qershor 2015, ka zbritur në 65.3 përqind krahasuar me 67.2 përqind në vitin paraprak. Rënia e shkallës së koncentrimit vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit për sa i përket aseteve, kredive dhe depozitave gjatë katër viteve të fundit (figura 22). Rënia e


koncentrimit ishte më e theksuar në kredi dhe asete si rezultat i rritjes më të shpejtë të aktivitetit nga bankat e vogla krahasuar me rritjen më të ngadalshme nga tri bankat më të mëdha. Tri bankat më të mëdha, në qershor 2015 shënuan rritje vjetore të kredive prej 0.8 përqind dhe rritje të aseteve prej 3.9 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 17.4 përqind në kredi dhe 13.0 përqind në asete të bankave tjera. Rënia e koncentrimit është e evidente edhe në depozita, por me ritëm më të ngadalshëm. Në qershor 2015, depozitat në tri bankat më të mëdha shënuan rritje vjetore prej 4.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 9.9 përqind në bankat tjera.

Figura 21. Struktura e aseteve të sektorit bankar, sipas pronësisë



Burimi: BQK (2015)

Figura 22. Shkalla e koncentrimit në sektorin bankar



Burimi: BQK (2015)


<sup>7</sup> Me banka nënkuptojmë filialet dhe degët e bankave të huaja që janë të licencuara të operojnë në Kosovë.

## 6.2. Aktiviteti i Sektorit Bankar

### 6.2.1. Asetet

Vlera e asetëve të sektorit bankar të Kosovës në qershor 2015 arriti në 3.27 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.9 përqind (9.8 përqind në qershor 2014) (figura 23). Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve të sektorit dha zgjerimi i portfolios së kredive i cili vazhdon të jetë kategoria dominuese e aktivitetit bankar. Sidoqoftë rritja e asetëve bankare ishte më e ngadalësuar në krahasim me vitin e kaluar që mund të jetë kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave të cilat edhe paraqesin burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar.

Figura 23. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)

Struktura e asetëve të sektorit bankar nuk shënoi ndryshime të theksuara në krahasim me periudhat paraprake, duke marrë parasysh që pjesa dërrmuese e asetëve të sektorit bankar (prej 85.4 përqind) mbeten të investuara në instrumente që sjellin fitim siç janë kreditë, letrat me vlerë dhe bilanci me bankat komerciale. Pjesëmarrja e kategorisë së bilancit me bankat komerciale në gjithsej asetet mbeti e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përderisa kategoritë e parasë së gatshme dhe e letrave me vlerë u karakterizuan me rritje të lehtë së pjesëmarrjes. Në anën tjetër, kategoria kryesore e asetëve, që përfaqësohet nga kreditë, shënoi rënie të lehtë të pjesëmarrjes në gjithsej asetet e sektorit bankar (tabela 2). Përkundër lëvizjeve të lehta, rritja e peshës së letrave me vlerë kundrejt rënies së peshës së kredive në gjithsej asetet e sektorit sugjeron një orientim më të theksuar të bankave drejt diversifikimit të portfoliove të tyre.

Tabela 2. Struktura e asetëve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2012		Qershor 2013		Qershor 2014		Qershor 2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	298.4	11.3%	355.4	12.8%	358.2	11.7%	397.4	12.2%
Bilanci me bankat komerciale	265.3	10.0%	261.4	9.4%	318.7	10.4%	341.9	10.5%
Letrat me vlerë	215.6	8.1%	246.3	8.8%	405.3	13.2%	443.8	13.6%
Kreditë bruto	1,776.3	67.0%	1,825.7	65.5%	1,889.9	61.8%	2,005.2	61.3%
Asetet Fikse	49.9	1.9%	57.6	2.1%	55.2	1.8%	52.7	1.6%
Asetet Tjera	46.9	1.8%	40.5	1.5%	32.2	1.1%	28.6	0.9%
<b>Gjithsej</b>	<b>2,652.3</b>	<b>100%</b>	<b>2,787.0</b>	<b>100%</b>	<b>3,059.5</b>	<b>100%</b>	<b>3,269.6</b>	<b>100%</b>

Burimi: BQK(2015)


Në kuadër të strukturës së asetëve të sektorit bankar, përveç kategorisë së kredive që shënuan rritje të përshpejtuar prej 6.1 përqind (3.5 përqind në qershor 2014) edhe kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në u karakterizua me rritje vjetore të përshpejtuar prej 11.0 përqind në qershor 2015 (0.8 përqind në qershor 2014) (figura 24). Rritja e kësaj të fundit ishte kryesisht rezultat i rritjes vjetore prej 12.6 përqind të rezervave të bankave komerciale në BQK. Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që përfshinë depozitat dhe linjat kreditore në bankat jashtë vendit, shënoi rritje të ngadalësuar prej 7.3 përqind (22.0 përqind në qershor 2014). Ky

ngadalësim ishte si rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar të depozitave të afatizuara në valutën jo euro që mund të jetë efekt i zhvlerësimit të euros në raport me valutat tjera (dollarin amerikan, frangun zviceran etj.) në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015.

Kategoria e investimeve në letra me vlerë, në qershor 2015, arriti në 443.8 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.5 përqind, mirëpo më të ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak (64.5 përqind e shënuar në qershor 2014). Në kuadër të strukturës së investimeve të bankave komerciale në letra me vlerë, vazhdon të ketë rritje të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në qershor 2015, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës regjistruan rritje vjetore prej 31.1 përqind, duke rritur pjesëmarrjen në gjithsej portfolion e investimeve në letra me vlerë në 49.2 përqind (figura 25). Rritja e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte kryesisht rezultat i normave më të larta të interesit që ofrojnë këto investime krahasuar me normat e interesit në letrat me vlerë të qeverive të huaja. Vlen të theksohet që mesatarja e thjeshtë e normës së interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rrit në 1.8 përqind në gjysmën e parë të vitit 2015, krahasuar me normën prej 1.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Ndërsa, mesatarja e thjeshtë e normës së interesit të letrave me vlerë të qeverive të huaja<sup>8</sup> deri në qershor 2015 ishte 0.05 përqind krahasuar me normën prej 1.1 përqind sa ishte deri në qershor 2014.

Në anën tjetër, investimet në letra me vlerë në sektorin e jashtëm, që kryesisht përbëhen nga fletë obligacionet e qeverive të huaja, shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind, duke ulur pjesëmarrjen në 50.7 përqind të gjithsej portfolios së investimeve në letra me vlerë. Kjo rënie është ndikuar nga zvogëlimi i theksuar i normave të interesit krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, që konsiderohen instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, kanë pjesëmarrjen më të ulët në portfolin e investimeve në letra me vlerë (0.1 përqind në qershor 2015), duke treguar se bankat shmangin investimet me rrezik më të lartë.


Figura 24. Asetet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

në gjithsej portfolion e investimeve në letra me vlerë në 49.2 përqind (figura 25). Rritja e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte kryesisht rezultat i normave më të

Figura 25. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

<sup>8</sup> Në llogaritje të normës mesatare të interesit për qeveritë e huaja janë përfshirë shtetet: Gjermania, Franca, Belgjika Italia dhe Spanja.

## Kreditë

Kreditë mbeten kategoria më e rëndësishme e asetëve të sektorit bankar, me pjesëmarrje prej 61.3 përqind në gjithsej asetet e sektorit. Aktiviteti kredi dhënës i sektorit bankar është rritur me ritëm të përshpejtuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Në qershor 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.01 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 6.1 përqind (3.5 përqind në qershor 2014) (figura 26). Zgjerimi i aktivitetit kreditues ndër tjerash u ndikua nga rritja e kërkesave të ndërmarrjeve për zgjerim të kapaciteteve të tyre operuese, si dhe rritja e nivelit të konsumit nga ekonomitë familjare (Kutia 3).

Figura 26. Kontributi i sektorëve në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK (2015)


Struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për ndërmarrje të cilat në qershor 2015 përfaqësuan 66.7 përqind të gjithsej kredive. Kreditë për ndërmarrje që gjatë tri viteve të kaluara u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ku në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 5.2 përqind (2.9 përqind në qershor 2014). Megjithatë, kontributin kryesor në rritjen e përshpejtuar të gjithsej kredive e kishin kreditë e destinuar për ekonomitë familjare, të cilat përbëjnë 33.0 përqind të gjithsej kredive dhe shënuan rritje vjetore prej 11.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 5.6 përqind në qershor 2014. Kreditë tjera, që përfshijnë kreditë ndaj organizatave joqeveritare dhe kreditë në valutë jo euro të cilat përfaqësojnë 0.3 përqind të gjithsej kredive, shënuan rënie vjetore prej 4.9 përqind në qershor 2015. Kreditë ndaj jorezidentëve në qershor 2015 zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë në 0.02 (1.0 përqind në qershor 2014) si rezultat e rënies së theksuar vjetore prej 98.1 përqind që kryesisht ishte rrjedhojë e maturimit të pjesës më të madhe të kredive.

Përkundër përshpejtimit të rritjes së gjithsej kredive, kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar në gjysmën e parë të vitit 2015 u karakterizuan me rritje vjetore prej 8.5 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 39.4 përqind të shënuar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014 (kutia 2). Rritja rekorde e shënuar në vitin e kaluar ishte si rezultat i rritjes së kërkesës nga rritja e pagave në sektorin publik në njërën anë dhe rritjes së ofertës përmes lehtësimit të standardeve dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave në anën tjetër, mirëpo kishte të bënte edhe me efektin e bazës, sepse përshpejtimi i rritjes së kredive të reja në 2014 ka ardhur pas disa viteve të zvogëlimit të kredive të reja.

**Kutia 2. Kreditë e reja**


Vlera e gjithsej kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar deri në qershor të vitit 2015 arriti në 555.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.5 përqind (figura 27). Kreditë e reja dominohen nga kreditë ndaj ndërmarrjeve, të cilat deri në qershor 2015 përfaqësuan 62.7 përqind të gjithsej kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 4.7 përqind (figura 28).

Figura 27. Gjithsej kreditë dhe kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

Figura 28. Kreditë e reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Ndërsa, kreditë e reja të destinuara për ekonomitë familjare përbënë 37.3 përqind të gjithsej kredive të reja dhe shënuan rritje vjetore prej 15.6 përqind (figura 29).


Struktura e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve përbëhet nga kreditë investuese, kreditë jo-investuese dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë investuese vazhdojnë të dominojnë me pjesëmarrje prej 64.0 përqind në gjithsej kreditë e reja të ndërmarrjeve (figura 30). Kreditë jo-investuese dhe ato me kushte favorizuese deri në qershor 2015 përfaqësuan 30.0 përqind përkatësisht 6.0 përqind të gjithsej kredive të reja të lëshuara për ndërmarrjet.

Figura 29. Kreditë e reja sipas sektorëve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

Figura 30. Kreditë e reja sipas sektorëve dhe qëllimit të përdorimit




Burimi: BQK (2015)

Struktura e kredive të reja të lëshuara për ekonomitë familjare përbëhet kryesisht nga kreditë konsumuese, kreditë hipotekare dhe kreditë me kushte favorizuese. Kreditë konsumuese deri në qershor 2015 kishin një pjesëmarrje prej 72.4 përqind në gjithsej kreditë e reja ndaj ekonomive familjare (76.3 përqind deri në qershor 2014). Kreditë hipotekare dhe ato me kushte favorizuese gjatë kësaj periudhe rritën pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e reja ndaj ekonomive familjare. Kreditë hipotekare kishin një pjesëmarrje prej 15.8 përqind në gjithsej kreditë e reja për ekonomitë familjare (12.9 përqind në qershor 2014), përderisa ato me kushte favorizuese kishin pjesëmarrje prej 8.3 përqind (7.6 përqind në qershor 2014).

Me qëllim që të identifikohen dhe krahasohen efektet e kredive të reja, kredive të kthyera, si dhe kredive të shlyera (angl. write-offs) në rritjen e stokut të gjithsej kredive aktive, në figurën 31 janë paraqitur trendet e zhvillimit të këtyre tri kategorive. Të tri kategoritë kanë ndikim të ndryshëm në vlerën e gjithsej kredive aktive, ku kreditë e reja ndikojnë pozitivisht në rritjen e kësaj vlere, ndërsa kthimi i kredive si dhe kreditë e shlyera kanë efekt negativ apo zvogëlues në vlerën e gjithsej kredive aktive.

Vlera e kredive të reja të akumuluar gjatë gjashtëmujorit të parë 2015 shënoi rritje vjetore të ngadalësuar krahasuar me rritjen e theksuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në anën tjetër, kreditë e kthyer dhe ato të shlyera gjatë kësaj periudhe shënuan rënie vjetore prej 1.6 përqind përkatësisht 2.8 përqind. Rënia vjetore e kredive të kthyer reflekton lëvizjet në maturimin e gjithsej kredive aktive. Kreditë me afat më të gjatë maturimi zgjeruan pjesëmarrjen e tyre përderisa ato me afat më të shkurtër maturimi zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë aktive. Në qershor 2015, raporti i shumës së kredive të kthyer dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja është zvogëluar në 79.3 përqind krahasuar me 87.5 deri në qershor 2014. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së kredive të kthyer dhe atyre të shlyera në raport me gjithsej kreditë e reja ka efekt pozitiv në rritjen e gjithsej stokut të kredive aktive.

Figura 31. Gjithsej kreditë, kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyer, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Raporti i kredive të shlyera ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në 1.4 përqind nga 1.5 përqind sa ishte në qershor 2014, që nënkupton se ndikimi i kredive të shlyera në 'mënjanimin' e efektit të kredive të reja në rritjen e gjithsej kredive aktive është zvogëluar. Po ashtu, raporti i kredive të kthyer ndaj gjithsej kredive të reja u zvogëluar në 77.9 përqind nga 85.9 përqind sa ishte deri në qershor 2014, duke ndikuar kështu pozitivisht në rritjen e gjithsej stokut të kredive gjatë kësaj periudhe.

Raporti i shumës së kredive të kthyer dhe atyre të shlyera ndaj kredive të reja të lëshuara deri në qershor 2015 u zvogëluar si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare, por që zvogëlimi ishte dukshëm më i theksuar tek ekonomitë familjare.

### Kutia 3. Anketa mbi Kreditimin Bankar<sup>9</sup>

Rezultatet e fundit të Anketës mbi Kreditimin Bankar pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës mars - shtator 2015, si dhe pritjet mbi ndryshimet në aktivitetin kreditues në periudhën tetor – mars 2016.

Aktiviteti kreditues në vend, në periudhën mars – shtator 2015, është karakterizuar me një rritëm të përshpejtuar të rritjes. Për dallim nga vendet tjera në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore, në të cilat kushtet e kreditimit vazhdojnë të mbeten të shtrënguara dhe kërkesa për kredi ende e ulët, dinamika e aktivitetit kreditues në Kosovë gjatë vitit 2015 vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tre vitet e fundit. Trendi i përshpejtuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi vitin 2015 i atribuohet ofertës më të lehtësuar kredituese të bankave për ndërmarrjet dhe për ekonomitë familjare, si dhe kërkesës më të lartë për kredi nga të dy sektorët.

Oferta e lehtësuar kredituese në përgjithësi i atribuohet lehtësimit të standardeve të kredidhënies nga bankat komerciale në vend, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe për kreditë konsumuese gjatë kësaj periudhe. Bankat deklaruan standarde më të lehtësuara kreditore veçanërisht për kreditë afatgjata. Rritja e mbështetjes për NVM-të përmes lehtësimit të standardeve kreditore, sidomos për sektorët më pak të kredituar më parë, si bujqësia dhe industria, si dhe rritja e kreditimit afatgjatë tregon për një lëvizje graduale të bankave nga një qasje më konzervatore drejtë alternativave që mundësojnë zgjerim më të madh të afarizmit të tyre.

Standardet për kreditë që janë dhënë ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë gjatë muajve mars - shtator 2015. Nëse analizojmë standardet e kredidhënies sipas qëllimit të përdorimit, vërehet se bankat kanë deklaruar standarde më të lehtësuara kredituese për kreditë konsumuese. Standarde më të

<sup>9</sup> Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – shtator dhe periudhën tetor – shkurt.

lehtësuara kredituese u aplikuan edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Faktorët kryesorë që përgjithësisht shpjegojnë politikat më të lehtësuara bankare të kreditimit gjatë periudhës mars – gusht 2015 ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale, konkurrenca në sistemin financiar dhe përmirësimi i cilësisë së portofolit kreditor. Rritja e vazhdueshme e depozitave dhe përmirësimi i mëtejme i cilësisë së kredive në periudhat në vijim pritet të jenë katalizatorë të rëndësishëm në dinamikën e kreditimit në vend.

Politika më e lehtësuar e bankave për kreditim të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare gjatë periudhës mars – gusht 2015 është realizuar kryesisht përmes uljes së normave mesatare të interesit për kreditë, ofrimit të kredive me afat më të gjatë maturimi dhe rritjes së shumës së kredisë së lejuar.

Në linjë me pritjet e deklaruara në anketën paraprake, bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare gjatë periudhës mars – gusht 2015. Për sa i përket kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, bankat raportuan rritje të kërkesës veçanërisht nga NVM-të. Sipas qëllimit të përdorimit, bankat raportuan rritje më të theksuar të kërkesës për kredi konsumuese nga ekonomitë familjare, përderisa një rritje më e lehtë e kërkesës u regjistrua edhe për kreditë për blerje të shtëpive. Si te kreditë për ekonomitë familjare, ashtu edhe te kreditë për ndërmarrjet, rritja e kërkesës ishte më e madhe për kreditë me afat më të gjatë maturimi. Rritja e kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare ishte në linjë me rritjen e konsumit të brendshëm gjatë kësaj periudhe, përderisa në rritjen e kërkesës për kredi nga NVM-të në periudhën raportuese mund të ketë ndikuar edhe rënia e normave të interesit për kreditë bankare.

Rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet raportohet të ketë ndodhur kryesisht me qëllim të financimit të investimeve fikse të ndërmarrjeve, financimit të kapitalit punues dhe ristrukturimit të borxhit. Ndërkaq, kërkesa e rritur nga ekonomitë familjare kryesisht i është atribuar rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve, rritjes së shpenzimeve tjera për konsum dhe zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme.

Sa i përket cilësisë së aplikacioneve për kredi të pranuar në periudhën mars – shtator 2015, bankat deklaruan përmirësim deri në një masë të cilësisë së aplikacioneve të NVM-ve. Gjithashtu, cilësi më e mirë u raportua nga aplikacionet e pranuar për kredi konsumuese si dhe për kredi afatgjata, që deri në një masë mund të shpjegojë dhe gatishmërinë më të lartë të bankave për rritjen e kredive të këtyre kategorive.

Sa i përket pritjeve të bankave për zhvillimet në aktivitetin kreditues në gjashtë muajt e ardhshëm (shtator 2015 - shkurt 2016), oferta kredituese, shprehur përmes standardeve të aplikuara kreditore, pritet të mbetet përgjithësisht e pandryshuar. Sa i përket shkallës së aprovimit të kredive, bankat presin që shkalla e aprovimit të kredive në gjashtë muajt e ardhshëm të mbetet përgjithësisht e pandryshuar, megjithëse një qasje më e lehtë në financim bankar pritet të vazhdojë të kenë NVM-të. Në periudhën shtator 2015 - shkurt 2016, bankat kanë deklaruar se presin rritje të kërkesës për kredi. Kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë nga NVM-të në kuadër të ndërmarrjeve, kreditë për blerje të shtëpive në kuadër të ekonomive familjare, dhe kreditë afatgjata në kuadër të maturitetit.

### Struktura e kredive sipas aktivitetit ekonomik

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarisë ekonomike mbetet e ngjashme me vitet paraprake (figura 32). Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë paraqesin kategorinë më të madhe me pjesëmarrje prej 54.0 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet, pasuar nga kreditë e destinuar për sektorin e industrisë (miniera, prodhimtari, energjetikë, dhe ndërtimtari) me pjesëmarrje prej 23.2 përqind në qershor 2015. Sektori i shërbimeve tjera (hoteleri dhe restorante, shërbimeve tjera financiare etj.) kishte një pjesëmarrje prej 19.0 përqind, përderisa sektori i bujqësisë vijon të ketë qasje më të ulët në kreditimin bankar me pjesëmarrje prej 3.8 përqind në gjithsej kreditë e ndërmarrjeve.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, sektorët ekonomik që shënuan rritje të nivelit të kredive ishin sektori i tregtisë, prodhimtarisë, bujqësisë dhe i energjetikës. Përveç faktorëve të




lidhur me ofertën e kredive (kutia 3), rritja e kreditimit për këta sektorë mund t'i atribuohet edhe kërkesës për kredi nga këta sektorë ekonomik duke marrë për bazë që nga gjithsej bizneset e reja të regjistruara, 30.3 përqind e tyre i përkisnin sektorit të tregtisë, 10.6 prodhimitarisë dhe 9.2 sektorit të bujqësisë.

Përkundër se mbetet sektori me qasjen më të ulët në financimin bankar, sektori i bujqësisë përfaqësoi sektorin me rritjen më të lartë vjetore të kredive, gjë që tregon për rritje të vëmendjes së sektorit bankar ndaj këtij sektori. Kreditë për bujqësi regjistruan rritje vjetore prej 12.2 përqind në qershor 2015, për dallim nga rënia vjetore prej 5.6 përqind që kishin shënuar në qershor të vitit paraprak. Përsheptimi mund të reflektojë kryesisht efektin e kërkesës duke marrë parasysh që gjatë këtij gashtëmujori ka pasur rritje për 19.4 përqind të ndërmarrjeve të reja të regjistruara në sektorin e bujqësisë. Po ashtu, kemi rënie të konsiderueshme të normave të interesit për këtë sektor ekonomik që mund të ketë nxitur investimet në sektor gjatë kësaj periudhe. Vlen të ceket që efektet e ofertës vihen re më shumë në kreditimin afatgjatë të sektorit të bujqësisë i cili përkon me norma një shifrorë të interesit si dhe me deklarin e bankave që kanë lehtësuar standardet për kreditimin afatgjatë të sektorit.

Kreditë e lëshuara për sektorin e energjetikës, që përfaqësojnë 6.6 përqind të kredive për sektorin e industrisë (figura 33), paraqet sektorin ekonomik i cili vazhdimisht karakterizohet me rritjen më të shpejtë të kreditimit gjatë viteve të fundit. Në qershor 2015, kreditimi i energjetikës shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind (12.7 përqind në qershor 2014). Rritja mund të jetë kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës duke marrë parasysh interesimin e lartë për investime në këtë sektor.


Kreditë e destinuar për sektorin e prodhimitarisë në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 10.6 përqind (16.9 përqind në qershor 2014) që paraqet një ndër sektorët me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë kësaj periudhe, duke marrë parasysh edhe peshën mjaftë të madhe në gjithsej kreditë sipas veprimtarisë ekonomike (figura 34). Norma dyshifrore e rritjes së kreditimit gjatë dy viteve të fundit reflekton ecurinë pozitive të sektorit të prodhimitarisë të shprehur edhe përmes indeksit të qarkullimit industrial (industria përpunuese) që ka shënuar rritje gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e parë. Po ashtu, pjesëmarrja relativisht e madhe e sektorit në gjithsej bizneset e reja të regjistruara (10.6 përqind në gjashtëmujorin e parë 2015) mund të shërbejë si tregues i rritjes së investimeve në këtë sektor, gjë që mund të përkthehet në rritje të kërkesës për qasje në financim bankar.

Figura 32. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burmi: BQK (2015)

Figura 33. Kreditë për sektorin e industrisë, në përqindje



Burmi: BQK (2015)

Kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë, pas tri viteve të ngadalësimit të rritjes, në qershor 2015 shënuan rritje prej 8.8 përqind (rritje prej 1.0 në qershor 2014). Përshpejtimi, mes tjerash, reflekton edhe rritjen e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera. Faktor tjetër ndikues ishte edhe numri i madh i bizneseve të reja të regjistruara në sektorin e tregtisë.

Në anën tjetër, kreditë për sektorët e ndërtimitarisë, minierave dhe shërbimeve tjera shënuan rënie në qershor 2015 përkundër rënies së normës së interesit në kredi për këta sektorë ekonomik si dhe standardeve të lehtësuara të kreditimit për ndërmarrje prej bankave. Kreditimi i sektorit të ndërtimitarisë vazhdon të shënojë rënie për të tretin vit me radhë, ku në qershor 2015, kreditë për sektorin e ndërtimitarisë shënuan rënie vjetore prej 9.0 përqind krahasuar me rënien prej 10.3 përqind në qershor 2014. Rënia mund të jetë rezultat i rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimitarisë gjatë tri viteve të fundit. Por, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 kemi rritje të aktivitetit në sektorin e ndërtimitarisë që mund të ketë ndikuar edhe në rënien më të ngadalësuar të kreditimit krahasuar me vitin e kaluar. Këto zhvillime në aktivitetin e sektorit të ndërtimitarisë mund të sugjerojnë për rritje të mundshme të kreditimit në periudhat vijuese.

Kreditë për sektorin e minierave shënuan rënie prej 8.5 përqind qershor 2015 (rënie prej 4.8 përqind në qershor 2014). Rënia e aktivitetit në sektorin e minierave reflekton edhe rënien e zhvillimit të sektorit të paraqitur përmes indeksit të qarkullimit industrial.

### Struktura e kredive sipas afatit të maturimit

Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përgjithësi, mbetet e ngjashme me vitet e kaluara. Në qershor 2015, kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite' përfaqësuan pjesën më të madhe të gjithsej kredive me pjesëmarrje prej 70.0 përqind (figura 35). Për dallim nga dy vitet e kaluara, kur pjesëmarrja e kredive afatgjata në gjithsej kreditë kishte shënuar rënie, në qershor 2015 u regjistrua rritje e pjesëmarrjes së kësaj kategorie në gjithsej kreditë. Zgjerimi është në përputhje me deklaratimet e bankave të cilat kanë lehtësuar qasjen në kredi me afat më të gjatë maturimi, si masë lehtësuese për financimin bankar të bizneseve dhe të ekonomive familjare. Në të njëjtën kohë, kreditë afatgjata u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit krahasuar me normat në kreditë afatshkurtra.

Figura 34. Kreditë sipas veprimtarisë ekonomike, ndryshimi vjetor






Figura 35. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Kreditë me afat të mesëm maturimi, '1 deri në 2 vite' zgjeruan pjesëmarrjen në 8.6 përqind në qershor 2015 si rezultat i rritjes vjetore prej 24.7 përqind krahasuar me rënien prej 3.0 përqind në qershor 2014 (figura 36). Ndërsa, kreditë me afat të shkurtër maturimi, 'deri në 1 vit', vazhduan të jenë kategoria e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 21.4 përqind në gjithsej kreditë. Këto kredi shënuan rënie vjetore prej 9.4 përqind në qershor 2015 që mund të jetë si rezultat i rënies së kërkesës për këto kredi krahas ofertës më të favorshme për kreditë afatgjata.

Rritja e kreditimit afatgjatë është shprehur si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe te kreditë ndaj ekonomive familjare. Në kuadër të kreditimit të ndërmarrjeve, rritja është më e theksuar për sektorët e bujqësisë, prodhimtarisë dhe tregtisë. Këto zhvillime mund të reflektojnë orientimin e bankave në ofrimin e kushteve më lehtësuese dhe normat më të favorshme të interesit në kreditë afatgjata që mund të ketë nxitur rritjen e kërkesës për këto kredi. Për më tepër, zhvillimi më i hovshëm i kredive hipotekare gjatë kësaj periudhe mund të ketë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së kredive me maturim afatgjatë, duke marr parasysh që 97.0 përqind e kredive të reja hipotekare kanë afat maturimi 'mbi 2 vite'.

Figura 36. Kreditë sipas afatit të maturimit, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

## 6.2.2. Detyrimet

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës vazhdon të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale. Në qershor 2015, depozitat përfaqësuan 78.7 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar (tabela 3). Mbështetja e lartë në depozita si burim i qëndrueshëm i financimit eviton ekspozimin ndaj lëvizjeve në tregjet e jashtme.

Kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në gjithsej detyrimet e sektorit janë mjetet vetanake që në qershor 2015 përfaqësuan 10.7 përqind të gjithsej detyrimeve. Kjo kategori ka shënuar rritje vjetore prej 20.6 përqind, që kryesisht paraqet rritjen rekorde të profitit të realizuar nga sektori bankar.

Në kuadër të detyrimeve, rritjen vjetore më të lartë prej 86.0 përqind e ka shënuar kategoria e bilancit nga bankat komerciale. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i financimit të disa bankave me mjete me kohëzgjatje të shkurtër maturimi, 'deri në 30 ditë', kryesisht të huazuara nga bankat dhe institucionet tjera financiare jashtë vendit. Në anën tjetër, kategoria e huazimeve tjera (përfshirë certifikatat e depozitave) shënoi rënie vjetore prej 27.2 përqind krahasuar me rritjen prej 21.4 përqind në qershor 2014. Po ashtu, kategoria e borxhit të ndërvarur në qershor 2015 shënoi rënie prej 17.4 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 57.8 përqind që u shënuar në periudhën e njëjtët të vitit të kaluar. Zvogëlimi i financimit të aktivitetit të sektorit bankar përmes formave të ndryshme të huazimeve (certifikatave të depozitave dhe borxhit të ndërvarur) reflekton nivelin e kënaqshëm të kapitalizimit të sektorit bankar. Zvogëlimi i huazimeve nga burime të tilla të financimit që bartin norma më të larta të interesit i kontribuon zvogëlimit të shpenzimeve të sektorit bankar.

Tabela 3. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	Qershor 2012		Qershor 2013		Qershor 2014		Qershor 2015	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	21.3	0.8%	20.2	0.7%	29.9	1.0%	55.6	1.7%
Depozitat	2,108.5	79.5%	2,201.3	79.0%	2,421.0	79.1%	2,574.6	78.7%
Huatë tjera	26.8	1.0%	14.8	0.5%	17.9	0.6%	13.1	0.4%
Detyrimet tjera	208.9	7.9%	241.3	8.7%	243.4	8.0%	229.3	7.0%
Borxhi i ndërruarur	31.0	1.2%	36.3	1.3%	57.3	1.9%	47.3	1.4%
Mjetet vetanake	255.8	9.6%	272.9	9.8%	289.9	9.5%	349.7	10.7%
Gjithsej detyrimet	2,652.3	100%	2,787.0	100%	3,059.5	100%	3,269.6	100%

Burimi: BQK (2015)


### Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar të Kosovës në qershor 2015 arritën vlerën prej 2.57 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.3 përqind. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi ngadalësim të rritjes së depozitave (veçanërisht të depozitave të ekonomive familjare) që u reflektua edhe në ngadalësimin e gjithsej aktivitetit të sektorit bankar. Normat e ulëta të interesit në depozita (veçanërisht atyre të ekonomive familjare) që po karakterizojnë sektorin bankar që nga tremujori i dytë i vitit 2014 kanë kontributin më të lartë në ngadalësimin e rritjes së depozitave.

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat konsiderohen si burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 74.0 përqind të gjithsej depozitave (figura 37). Vlera e depozitave të ekonomive familjare, në qershor 2015, shënoi rritje vjetore prej 6.0 përqind (rritje prej 9.1 përqind në qershor 2014). Me rritje u karakterizuan edhe depozitat e ndërruarjeve të cilat përbëjnë 20.9 përqind të gjithsej depozitave dhe shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind (rritje prej 11.9 përqind në qershor 2014).


Në strukturën e depozitave të ndërruarjeve vërehet një rritje e peshës së depozitave të korporatave jo-financiare (ndërruarjet private) në 75.6 përqind nga 64.4 përqind në qershor 2014 (figura 38). Zgjerimi ishte kryesisht rrjedhojë e rritjes së theksuar vjetore prej 25.9 përqind të kësaj kategorie, që gjithashtu paraqet rritjen më të lartë në shtatë vitet e fundit. Ndërsa, kategoria e dytë për nga pesha, ajo e depozitave të korporatave tjera financiare, në qershor 2015 shënoi rënie të theksuar prej 23.5 përqind (rritje prej 41.6 përqind në qershor 2014). Rënia

Figura 37. Depozitat e sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)

Figura 38. Depozitat e ndërruarjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

ishite kryesisht rezultat i zvogëlimit të depozitave të afatizuara të kompanive të sigurimit, institucioneve mikrofinanciare dhe fondeve pensionale. Kategoria e depozitave të ndërmarrjeve publike gjithashtu u karakterizua me rënie të theksuar prej 31.2 përqind, duke u bërë kështu edhe kontribuesi kryesor në ngadalësimin e rritjes së depozitave të ndërmarrjeve.

Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 3.6 përqind dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.5 përqind. Depozitat e jorezidentëve vlera e të cilave arriti në 92.8 milionë në qershor 2015 shënoi rritje vjetore prej 1.6 përqind (figura 39). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 27.2 përqind kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të qeverisë qendrore dhe organizatave jo-qeveritare në bankat komerciale.

Figura 39. Depozitat e jo-rezidentëve




Burimi: BQK (2015)

### Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit

Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit ka pësuar ndryshime të theksuara në dy vitet e fundit. Përderisa më parë depozitat e afatizuara dominonin strukturën e depozitave, në qershor 2015 kategoria kryesore e depozitave përfaqësohej nga depozitat e transferueshme me pjesëmarrje prej 50.1 përqind në gjithsej depozitat. Ndërsa, depozitat e afatizuara kishin një pjesëmarrje prej 28.4 përqind në gjithsej depozitat, që përkon me një rënie vjetore prej 13.2 pikë përqindje. Depozitat e kursimit mbeten të tretat me pjesëmarrje prej 21.5 përqind (18.9 përqind në qershor 2014). Këto ndryshime ishin si rezultat i rënies së theksuar të normave të interesit në depozita që kanë karakterizuar sektorin bankar që nga tremujori i dytë i vitit 2014 (figura 40).

Depozitat e transferueshme në qershor 2015 shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 34.8 përqind. Në kuadër të depozitave të transferueshme, depozitat e ekonomive familjare regjistruan rritjen më të theksuar vjetore prej 39.7 përqind, duke shënuar kontributin kryesor në rritjen e gjithsej depozitave të transferueshme. Depozitat e transferueshme të ndërmarrjeve janë karakterizuar me rritje vjetore prej 26.8 përqind dhe kishin kontribut më të vogël në rritjen e gjithsej depozitave të transferueshme.

Figura 40. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK (2015)

Depozitat e afatizuara, si kontribuesi kryesor në ngadalësimin e rritjes së gjithsej depozitave, në qershor 2015 shënuan rënie vjetore prej 27.4 përqind. Kjo ishte kryesisht rezultat i rënies së theksuar prej 28.7 përqind të depozitave të afatizuara të ekonomive familjare (rënie prej 12.0 në qershor 2014). Depozitat e afatizuara të ndërmarrjeve shënuan rënie vjetore prej 19.6 përqind kundrejt rritjes prej 14.4 përqind që kishin shënuar në qershor 2014. Ngjashëm, edhe depozitat

tjera të afatizuara (depozitat e qeverisë dhe organizatave tjera jo-qeveritare) dhe depozitat ndaj jo-rezidentëve shënuan rënie vjetore prej 32.4 përqind përkatësisht 47.0 përqind në qershor 2015.


Përkundër zvogëlimit të vlerës së përgjithshme të depozitave të afatizuara, përbrenda strukturës së kësaj kategorie të depozitave vërehet rritje e depozitave të afatizuara me afat më të gjatë maturimi. Në qershor 2015, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje të depozitave me afat të mesëm dhe me afat të gjatë maturimi, kurse zvogëlim të depozitave me afat të shkurtër maturimi (figura 41). Në qershor 2015, depozitat me afat maturimi 'deri në 1 vit' kishin pjesëmarrje prej 38.1 përqind në gjithsej depozitat e afatizuara, që paraqet një rënie prej 21.2 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Kjo zhvendosje e depozitave drejt atyre me afat më të gjatë maturimi mund të jetë ndikuar nga normat më të favorshme të interesit në depozitat afatgjata kundrejt normave tejet të ulëta në depozitat e afatizuara me maturim afatshkurtër. Depozitat me afat maturimi 'nga 1 deri në 2 vite' zgjeruan pjesëmarrjen në 28.4 përqind nga 20.0 në qershor 2014, përderisa depozitat me afat maturimi 'mbi 2 vite' rritën pjesëmarrjen në 33.4 përqind nga 20.7 përqind në qershor 2014.

Depozitat në formë të kursimeve kanë vazhduar trendin pozitiv të rritjes, ku në qershor 2015 shënuan normë vjetore të rritjes prej 21.0 përqind (23.7 përqind në qershor 2014). Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë 92.6 përqind të gjithsej depozitave të kursimit, shënuan rritje vjetore prej 21.4 përqind (23.1 përqind në qershor 2014). Depozitat e jorezidentëve kanë shënuar rritje prej 36.8 përqind në qershor 2015. Në kuadër të depozitave të jorezidentëve, për dallim nga trendi rritës i depozitave të kursimeve, depozitat e afatizuara kanë shënuar rënie si rezultat i normave të ulëta të interesit. Këto norma të ulëta në depozita mund të kenë ndikuar që jorezidentët që të tërheqin depozitat e tyre nga bankat vendore duke i deponuar në bankat e huaja që mund të kenë norma më të favorshme të interesit apo ti investojnë në produkte të tjera financiare që sjellin fitime më të larta.

### 6.2.3. Normat e Interesit


Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, ndërsa ato në depozita shënuan ngritje të lehtë. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 7.6 përqind në qershor 2015 nga 10.5 përqind sa ishte në qershor 2014. Krahasuar me vendet e rajonit, normat e interesit në kredi në vend kanë shënuar rënie më të theksuar duke arritur një mesatare të përafërt me vendet e rajonit. Në anën tjetër norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Krahasuar me vendet e rajonit, normat e interesit në depozita janë dukshëm më të ulëta në Kosovë. Pavarësisht rritjes së lehtë të

Figura 41. Depozitat e afatizuara



Burimi: BQK (2015)

Figura 42. Norma mesatare e interesit



Burimi: BQK (2015)

normave të interesit në depozita, rënia më e theksuar e normave në kredi ndikoi që dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në qershor 2015 të zvogëlohet në 6.8 pp nga 9.9 pp sa ishte në qershor 2014 (figura 42).

#### Normat e interesit në kredi


Trendi rënës i normave të interesit në kredi vërehet si te kreditë ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe te kreditë ndaj ekonomive familjare (figura 43). Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 7.4 përqind në qershor 2015 nga 10.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese u karakterizuan me normë mesatare të interesit prej 7.1 përqind (10.1 përqind në qershor 2014), përderisa kreditë jo investuese kishin normë mesatare të interesit prej 8.0 përqind (12.6 përqind në qershor 2014) (figura 44).

Sa i përket kredive ndaj ndërmarrjeve sipas afatit të maturimit, norma më e ulët e interesit në qershor 2015 u shënuar te kreditë investuese me maturim 'mbi 5 deri në 10 vite' (7.1 përqind), ndërsa norma më e lartë e interesit u regjistrua te kreditë jo-investuese me maturim poashtu 'mbi 5 deri në 10 vite' (11.5 përqind).

Zvogëlimi i normës së interesit ishte evident për kreditë e destinuar për të gjitha veprimtaritë ekonomike. Rënia më e theksuar është shënuar te kreditë e sektorit të bujqësisë. Në qershor 2015, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë zbriti në 7.7 përqind nga 13.1 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 45). Megjithatë, sektori i bujqësisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi përkundër trendit rënës të ndjekur gjatë viteve të fundit.


Norma mesatare e interesit për kreditë e sektorit të industrisë ka zbritur në 7.7 përqind në qershor 2015 nga 11.3 përqind sa ishte në qershor 2014, ndërsa për sektorin e shërbimeve (përfshirë edhe tregtinë) zbriti në 7.2 përqind nga 9.8 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe, norma më e lartë e interesit prej 9.2 përqind është regjistruar në sektorin e industrisë, specifikisht te

Figura 43. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2015)

Figura 44. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2015)

Figura 45. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK (2015)

kreditë me afat maturimi 'deri në 1 vit', ndërsa norma më e ulët prej 6.9 përqind u regjistrua në sektorin e shërbimeve të kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite'.


Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar në 8.2 përqind në qershor 2015 nga 10.7 përqind sa ishte në qershor 2014. Në kuadër të kredive ndaj ekonomive familjare, norma e interesit në kreditë konsumuese zbriti në 8.4 përqind në qershor 2015 (10.9 përqind në qershor 2014), ndërsa norma mesatare e kredive hipotekare zbriti në 7.2 përqind (9.3 përqind në qershor 2014) (figura 46). Tek kreditë hipotekare, ulja më e theksuar e normave të interesit në 6.9 përqind në qershor 2015 nga 9.2 përqind në qershor 2014 u shënuar te kreditë me maturim 'mbi 5 deri në 10 vite'.

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2015 nuk pësoi ndryshime të mëdha krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në qershor 2015, norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare arriti në 0.8 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në qershor 2014. Normat më të larta të interesit në depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të bartin ato me afat maturimi 'mbi 2 vite' (1.7 përqind) përderisa normat më të ulëta u hasën në depozitat me afat maturimi 'mbi 3 deri

në 6 muaj' (0.3 përqind). Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve në qershor 2015 ishte 1.0 përqind, ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 47). Në kuadër të ndërmarrjeve, normat më të larta të interesit u hasën në depozitat me afat maturimi 'mbi 1 deri në 3 muaj' (1.4 përqind) përderisa normat më të ulëta në depozitat kishin ato me afat maturimi 'mbi 2 vite' (0.02 përqind). Për më tepër, normat e interesit në depozitat e transferueshme dhe ato të kursimeve për të dy kategoritë (ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet) shënuan rënie krahasuar me qershor të vitit 2014, por që kjo rënie ishte më e theksuar tek ndërmarrjet.


Figura 46. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2015)

qershor 2014 u shënuar te kreditë me maturim 'mbi 5

Figura 47. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2015)



### 6.3. Performanca e Sektorit Bankar

Sektorit bankar u karakterizua me performancë të mirë financiare edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 ku neto profiti i realizuar deri në qershor 2015 arriti vlerën prej 44.9 milionë euro, (në qershor të vitit 2014 ishte 26.9 milionë euro) (figura 48). Gjatë kësaj periudhe, të hyrat e sektorit shënuan rënie të lehtë, kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi. Ndërsa, shpenzimet e sektorit vazhduan trendin rënës edhe gjatë gjashtëmujorit të parë 2015 si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të interesit dhe jointeresit. Rrjedhimisht, rritja e profitit të sektorit bankar ishte rezultat i reduktimit të shpenzimeve, veçanërisht atyre të interesit në depozita, dhe shpenzimeve për provizione.

Rritja e profitit vetëm në saje të reduktimit të shpenzimeve e bënë profitabilitetin e sektorit bankar shumë të ndjeshëm ndaj rritjes së mundshme të shpenzimeve në të ardhmen. Më konkretisht, një rritje e mundshme e normës së interesit në depozita apo përkeqësim i cilësisë së portofolit kreditor do të mund të rezultonte drejtëpërsëdrejti në përkeqësim e performancës financiare të sektorit. Prandaj, sektori bankar duhet të fokusohet në rritjen e qëndrueshmërisë së profitit përmes përmirësimit të performancës së të hyrave dhe përmirësimit të efikasitetit operacional duke zvogëluar shpenzimet operative.


#### Të hyrat

Të hyrat e sektorit bankar deri në qershor 2015 arritën vlerën prej 119.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.5 përqind. Struktura e të hyrave të sektorit mbetet e ngjashme me periudhat paraprake duke u përbërë kryesisht prej të hyrave nga interesi (78.8 përqind), të pasuara nga të hyrat nga jointeresi (20.6 përqind), dhe të hyrat nga rivlerësimi (0.6 përqind) (figura 49).

Të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 2.9 përqind, duke dhënë kontributin kryesor në rënien e gjithsej të hyrave të sektorit bankar.


Rënia e gjithsej të hyrave nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi në kredi, nga interesi në letra me vlerë, nga interesi në plasmanet me bankat tjera dhe të hyrat tjera, ishte kryesisht rezultat i rënies prej 2.1 përqind të të hyrave nga interesi në kredi, të cilat

Figura 48. Performanca financiare e sektorit bankar




Burimi: BQK (2015)

Figura 49. Të hyrat e sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Figura 50. Të hyrat e interesit të sektorit bankar, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

edhe janë përcaktues kryesor i trendit të hyrave nga interesi duke marrë parasysh që përbëjnë 97.2 përqind të gjithsej të hyrave nga interesi (figura 50). Rënia e kësaj kategorie përkon me rënien e normave të interesit në kredi të regjistruar gjatë kësaj periudhe (figura 51).

Kategoria e të hyrave nga interesi në letra me vlerë ishte kategoria e vetme e të hyrave e cila u karakterizua me rritje të theksuar prej 70.6 përqind deri në qershor 2015. Rritja reflekton orientimin e bankave komerciale në vend drejt investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës të cilat gjatë vitit kishin norma më të larta të interesit krahasuar me vitin paraprak dhe krahasuar me letrat me vlerë të qeverive të huaja. Ndikim të rëndësishëm në rritjen e të hyrave nga interesi në letra me vlerë ka pasur edhe plasimi në tregun e brendshëm i fletë obligacioneve qeveritare me afat maturimi tre vjeçar, të cilat bartin norma më të larta të interesit.

Figura 51. Të hyrat e sektorit bankar, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)


Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithsej hyrave janë të hyrat nga jointerеси që deri në qershor 2015 shënuan rritje vjetore prej 1.8 përqind. Rritja ishte kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave tjera operative, edhe pse kjo kategori përbënte vetëm 9.0 përqind të gjithsej të hyrave nga jo interesi përderisa të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rënie vjetore prej 0.1 përqind. Të hyrat tjera operative, që përfshijnë fitimet neto nga këmbimet valutore si dhe të hyrat nga qiraja dhe nga mjetet e riposeduara, deri në qershor 2015 shënuan rritje vjetore të theksuar prej 25.1 përqind.

Kategoria e të hyrave nga rivlerësimi u karakterizua me rritje deri në 0.7 milionë euro nga 0.2 milionë euro sa ishte në qershor të vitit 2014 e cila edhe rezultoi me rritjen e pjesëmarrjes së kategorisë në gjithsej të hyrat e sektorit. Rritja në përgjithësi ishte si rezultat i realizimit të të hyrave nga shitja e mjeteve të tregtueshme (instrumenteve financiare) me çmim më të volitshëm/rivlerësuar, megjithatë norma shumë e lartë e rritjes kryesisht reflekton efektin e bazës së ulët duke marrë parasysh pjesëmarrjen e ultë të të hyrave nga rivlerësimi në sektor.

**Shpenzimet**

Gjithsej shpenzimet e sektorit bankar, deri në qershor 2015, arritën vlerën prej 74.8 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 21.0 përqind. Struktura e shpenzimeve dominohet nga kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative e cila deri në qershor 2015 arriti të zgjerojë pjesëmarrjen në 66.1 përqind (51.3 përqind në qershor 2014). Rritja e pjesëmarrjes së shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve kryesisht ishte rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të interesit dhe shpenzimeve të jo interesit. Shpenzimet e interesit përfaqësojnë kategorinë e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 16.2 përqind në gjithsej shpenzimet, pasuar nga kategoria e shpenzimeve të jo

Figura 52. Shpenzimet e sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


interesit me pjesëmarrje prej 11.5 përqind. Të dy këto kategori u karakterizuan me ngushtim të theksuar të pjesëmarrjes në strukturën e gjithsej shpenzimeve gjatë vitit të fundit (figura 52).

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rritje vjetore prej 1.9 përqind deri në qershor 2015, krahasuar me rënie prej 1.0 përqind që kishin shënuar në qershor 2014 (figura 53). Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shpenzimet e përgjithshme u karakterizuan me rënie prej 5.5 përqind, që nënkupton se rritja e kategorisë së shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit prej 0.5 përqind dhe rritjen e shpenzimeve tjera nga jo interesi prej 16.2 përqind.

Shpenzimet e interesit, deri në qershor 2015, shënuan rënie vjetore prej 53.0 përqind (rënie prej 19.2 përqind deri në qershor 2014), duke u bërë kështu kontribuesi kryesor në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve të sektorit. Thellimi i rënies i atribuohet kryesisht zvogëlimit të shpenzimeve të interesit në depozita si komponent kryesor i kësaj kategorie (me pjesëmarrje prej 75.3 përqind). Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rënie vjetore prej 58.8 përqind, kryesisht si rezultat i normave të ulëta të interesit në depozita që po karakterizojnë sektorin bankar që nga tremujori i dytë i vitit 2014 (figura 54).


Kategoria e shpenzimeve të jo interesit u karakterizua me rënie vjetore prej 50.6 përqind në qershor 2015. Zvogëlimi kryesisht i atribuohet rënies vjetore prej 73.7 përqind të shpenzimeve të provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë. Zvogëlimi i shpenzimeve të provizioneve gjatë kësaj periudhe ishte si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor, përkatësisht zvogëlimit të vlerës së kredive jo performuese krahasuar me vitin paraprak (figura 55). Me gjithë zvogëlimet e shpenzimeve për provizione, shkalla e mbulueshmërisë së kredive jo performuese me provizione vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm duke qëndruar në 119.3 përqind në qershor 2015 (116.4 përqind në qershor 2014).

Figura 53. Shpenzimet e sektorit bankar, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK (2015)

Figura 54. Shpenzimet e interesit dhe jointerisit sipas kategorieve, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

Figura 55. Kreditë joperformuese dhe provizionet për humbjet e kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

### Profitabiliteti dhe efikasiteti

Rritja e theksuar e profitit deri në qershor 2015 ndikoi në përmirësimin e dukshëm të treguesve të profitabilitetit të sektorit bankar krahasuar me vitin paraprak. Kthimi në Mesataren e Aseteve (angl. Return on Average Assets: ROAA) arriti në 2.8 përqind nga 2.0 përqind sa ishte në vitin 2014. Kthimi në Mesataren e Kapitalit (angl. Return on Average Equity: ROAE) gjithashtu shënoi rritje duke arritur në 25.9 përqind nga 20.3 përqind sa ishte në vitin 2014 (figura 56).

Zvogëlimi i theksuar i shpenzimeve, përkundër rënies së lehtë të të hyrave, ka ndikuar në përmirësimin e indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme. Në qershor 2015, ky indikator u zvogëluar në 62.5 përqind nga 77.9 përqind sa ishte në vitin paraprak (figura 57).

Përmirësim më i lehtë i efikasitetit të sektorit bankar vërehet në raportin e shpenzimeve operacionale ndaj gjithsej asetëve, që në qershor 2015 u zvogëluar për 0.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (tabela 4). Në anën tjetër, margjina neto e interesit<sup>10</sup> shënoi rritje për 0.2 pikë përqindje, duke arritur në 3.0 përqind në qershor 2015. Rritja e këtij indikator reflektonte rritjen më të shpejtë të hyrave neto nga interesi (si rezultat i rënies së shpenzimeve të interesit në depozita) krahasuar me rritjen e asetëve që sjellin interes.


**Tabela 4. Tregues kyç të efikasitetit të sektorit bankar, në përqindje**

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Shpenzimet operacionale/gjithsej Asetet	1.9%	1.8%	1.6%	1.5%
Margjina neto e interesit	3.2%	2.9%	2.8%	3.0%

Burimi: BQK (2015)

Në tabelën 5 janë paraqitur disa tregues të kapacitetit të sektorit bankar, zhvillimi i të cilëve gjatë viteve të fundit tregojnë rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve të sektorit. Kjo shprehet përmes indikatorëve që paraqesin raportin e vlerës mesatare të asetëve të menaxhuara nga një punëtor si dhe raportin të numrit mesatar të kredive të lëshuara nga një punëtor. Të dhënat për të dy indikatorët deri në qershor 2015 sugjerojnë rritje të shfrytëzimit të kapacitetit nga sektori bankar i Kosovës. Përmirësimi i këtyre dy indikatorëve u ndikua nga rritja më e lartë e


**Figura 56. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar**



\*2015 - e aktualizuar

Burimi: BQK (2015)

**Figura 57. Raporti shpenzime/të hyra në sektorin bankar**



Burimi: BQK (2015)

<sup>10</sup> Margjina neto e interesit paraqet raportin ndërmjet të hyrave neto nga interesi dhe mjeteve mesatare fitimprurëse.

aktivitetit të sektorit bankar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 krahas rritjes së lehtë të numrit të të punësuarve në sektorin bankar, që në qershor 2015 arriti në 3,531 nga 3,488 në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Një tregues tjetër i kapacitet bankar, shprehur si raport i profitit të realizuar për një punëtor, ka shënuar përmirësim të theksuar. Kjo erdhi si rezultat i profitit të lartë të realizuar deri në qershor 2015 krahas rritjes së numrit të të punësuarve. Kurse, raporti ndërmjet gjithsej shpenzimeve të personelit dhe numrit të të punësuarve në qershor 2015 shënoi rënie të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjë që paraqet menaxhim më të mirë të kostos së faktorit punë nga bankat në Kosovë, duke konsideruar rritjen më të ngadalshme të shpenzimeve të personelit krahasuar me rritjen e numrit të punëtorëve në periudhën raportuese.

**Tabela 5. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar**


Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Asetet/nr i punëtorve (në mijëra euro)	714.3	766.1	877.2	926.0
Numri i kredive/nr i punëtorve	113.4	115.3	130.9	138.4
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	2.8	4.2	7.7	12.7
Shpenzime e personelit/nr i punëtorëve	5.6	5.8	6.0	5.9

Burimi: BQK (2015)

## 6.4 Rreziqet e Sektorit Bankar

Rreziqet ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar i Kosovës mbeten në nivel të ulët edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Për më tepër, ekspozimi ndaj rrezikut kreditor dhe solvences ka shënuar rënie si rrjedhojë e rënies së kredive joperformuese dhe rritjes së përshpejtuar të gjithsej kreditimit si dhe nga rritjes së kapitalit bankar si rezultat i rritjes së profitit. Rritja e përshpejtuar e kreditimit ka ndikuar në rënie e treguesve të likuiditetit por që mbetet në nivel të kënaqshëm. Në figurën 58 e cila paraqet indikatorët kryesor të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit, mund të shihet se të gjithë indikatorët e rrezikut kanë shënuar përmirësim. Ky përmirësim i përgjithshëm i zhvillimeve me ndikim është reflektuar në ngritje të theksuar të performancës së sektorit bankar në krahasim me vitin paraprak. Përmirësimi vërehet edhe në ambientin e jashtëm makroekonomik, ku Eurozona u karakterizua me normë më të lartë të rritjes prej 1.5 përqind në vitin 2015 për dallim nga rritje prej 0.9 përqind në vitin 2014. Sa i përket ambientit të brendshëm makroekonomik, edhe ekonomia e Kosovës parashihet që të shënoj rritje më të lartë ekonomike (3.5 përqind) në vitin 2015 krahasuar me rritjen prej 2.7 përqind në vitin 2014.<sup>11</sup>

**Figura 58. Harta e rreziqeve të sektorit bankar, në përqindje)**



Burimi: BQK (2015)

<sup>11</sup> Norma e rritjes vjetore së PBB-së së Kosovës për vitin 2015 është parashikim i BQK-së, ndërsa norma e rritjes vjetore të PBB-së së Eurozonës është marrë nga statistikat e FMN-së.


Kapitali i sektorit bankar shënoi rritje gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 si rrjedhojë e rritjes së fitimit neto, duke rezultuar në ngritje të cilësisë së kapitalit si dhe treguesve të kapitalizimit të sektorit. Pozita e përforcuar e kapitalit sugjeron qëndrueshmëri më të lartë të sektorit bankar dhe aftësi të kënaqshme të përballimit të humbjeve potenciale. Rreziku kreditor ka shënuar rënie gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, duke u pasqyruar me normë më të ulët të kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive si dhe me rënie të trendit të koncentrimit të rrezikut kreditor, karakteristikë e sektorit bankar gjatë tri viteve të fundit. Po ashtu, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme. Pozita e likuiditetit të sistemit bankar mbetet në nivel të kënaqshëm edhe pse e karakterizuar me rritje të përshpejtuar të kredive dhe ngadalësim të rritjes së depozitave krahasuar me vitin paraprak. Ngadalësimi i rritjes së depozitave krahasuar me vitet paraprake dhe orientimi drejt maturitetit më të shkurtër si dhe përshpejtimi i rritjes së kreditimit kanë ndikuar në rënie të lehtë të treguesit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Megjithatë, ky i fundit mbetet mjaft mbi nivelin minimal të përcaktuar me kërkesat rregullore. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj rrezikut të tregut, marrë parasysh faktin se pothuajse të gjitha kreditë dhe depozitat vazhdojnë të bartin norma fikse të interesit si dhe për faktin se bilanci i gjendjes së sektorit bankar pothuajse në tërësi është i denominuar në valutën euro dhe rrjedhimisht ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

#### 6.4.1 Rreziku i likuiditetit

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit mbetet i ulët përkundër rënies së lehtë të treguesit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Depozitat të cilat përbëjnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar kanë shënuar rritje mirëpo me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, depozitat dhe kanë treguar orientim drejt maturitetit më të shkurtër (1-7 ditë), duke reflektuar pjesërisht ndjeshmërinë e rritjes së depozitave ndaj rënies së normës së interesit. Orientimi i depozitave drejt maturimeve më të shkurtra ka ndikuar në rritjen e detyrimeve afatshkurtra. Raporti i kredive ndaj depozitave shënoi rënie të lehtë në 77.9 përqind në qershor 2015 nga 78.1 përqind në qershor 2014 si rezultat i rritjes më të lartë vjetore të depozitave në krahasim me rritjen e kredive (figura 59).


Rritja e aktivitetit kreditor në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 si dhe orientimi drejt investimeve të maturiteteve më afatgjata në tregjet financiare ka ndikuar në ngadalësimin e ritmit të rritjes së aseteve likuide afatshkurtra. Në qershor 2015, asetet afatshkurtra shënuan rritje vjetore prej 4.5 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 25.9 përqind në qershor 2014. Në

Figura 59. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 60. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2015)


anën tjetër, detyrimet afatshkurtra shënuan rritje më të lartë vjetore prej 9.1 përqind si rezultat i orientimit të depozitave drejt afatit më të shkurtër të maturimit. Rrjedhimisht, raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtra u zvogëlua në 41.9 përqind në qershor 2015 krahasuar me 43.7 përqind në qershor 2014, mirëpo vazhdon të mbetet dukshëm mbi nivelin minimal prej 25 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore (figura 60).

Në kuadër të aseteve likuide, rritjen më të theksuar e shënuan obligacionet e tregtueshme qeveritare dhe bonot e tregtueshme të thesarit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa rënien më të lartë e shënuan letrat e huaja me vlerë të maturiteteve të shkurtra, çka tregon për orientim drejt investimeve në letra me vlerë me afat më të gjatë maturimi. Në anën e detyrimeve, zgjerimi i depozitave të transferueshme, detyrimeve ndaj bankës amë si dhe huamarrjeve afatshkurtra kanë ndikuar që detyrimet afatshkurtra të rriten dhe të kenë një ritëm më të shpejtë të rritjes se sa asetet likuide.

Rezervat e detyrueshme të sektorit bankar gjithashtu kanë vazhduar të qëndrojnë në nivel më të lartë se sa kërkesat rregullatore. Në qershor 2015, rezerva e detyrueshme shënoi vlerën 234.1 milionë euro, ndërsa vlera e gjithsej rezervave të mbajtura nga bankat tejkaloi rezervën e detyrueshme për 47.9 përqind (figura 61). Mbajtja e rezervave në nivel të lartë mund të konsiderohet si pozitive për qëndrueshmërinë e sektorit ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve me rrezik potencial për gjendjen e likuiditetit. Megjithatë, kjo paraqet kosto oportune për bankat të cilat nuk arkëtojnë interes për tepricën e rezervës, gjë e cila mund të transmetohet në rritje të kostos së shërbimeve bankare.


Gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, sektori bankar i Kosovës është karakterizuar me rritje të 'rrezikut strukturor të likuiditetit', që pasqyrohet përmes rritjes së mospërputhjes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturitetit (figura 62).<sup>12</sup> Hendeku i likuiditetit është rritur për pothuajse të gjitha kategoritë. Rritja më e theksuar është shënuar në kategorinë '1-7 ditë', ku hendeku është dyfishuar në -1,069 milionë euro nga -573.9 në qershor 2014. Kjo ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative 'deri në 3 muaj' të rritet në -936.8 milionë euro nga -558 milionë euro në qershor 2014. Rritja e konsiderueshme e hendekut negativ për periudhën '1-7 ditë' gjithashtu ndikoi që hendeku negativ për periudhën kumulative 'deri në 1 vit' të rritet, por që efekti negativ i saj është zbutur pak nga kalimi në hendek pozitiv të kategorisë '31-90 ditë' si dhe nga rritja e hendekut pozitiv për kategoritë '91-180 ditë' dhe '181-365 ditë'.

Figura 61. Rezervat e sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 62. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

<sup>12</sup> Hendeku negativ nënkupton që detyrimet për intervalin e caktuar të maturitetit tejkalojnë asetet dhe anasjelltas.

Në qershor 2015, asetet e të gjitha kategorive të maturitetit kanë shënuar rritje përveç aseteve të maturitetit '1-7 ditë' që shënuan rënie prej 66.8 milionë euro. Në kuadër të kësaj kategorie, rënia më e lartë u shënuar në letrat me vlerë dhe asetet e tregtueshme. Ndërsa, kategoria e aseteve me maturim prej 'më shumë se 1 vit' shënoi rritjen më të lartë prej 175,2 milionë euro që është rezultat i zhvendosjes së investimeve në letra me vlerë drejt maturiteteve më të gjata si dhe rritjes së kredive të maturiteteve 'mbi 5 vite'.

Në anën e detyrimeve, rritja më e lartë vjetore u shënuar për kategorinë me afat maturiteti prej '1-7 ditë', të cilat rritën vlerën për 428.8 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme, detyrimeve ndaj bankës amë si dhe huamarrjeve afatshkurtra. Ndërsa, detyrimet me afat maturimi 'më shumë se 1 vit' shënuan rritje prej 40.7 milionë euro, që rezultoi kryesisht nga rritja e ekuitetit.

Rritja e hendekut negativ kryesisht për kategorinë me maturitet më të shkurtër '1-7 ditë' u ndikua nga zhvillimet në zërat kryesorë të bilancit të gjendjes. Rritja e kreditimit është reflektuar në zvogëlimin e aseteve me maturitet të shkurtër si dhe rritjen e atyre me maturitet më të gjatë se një vit. Në anën e detyrimeve, rritja e depozitave të transferueshme, e detyrimeve ndaj bankave amë dhe huamarrjeve afatshkurtra ndikoi në rritjen detyrimeve për kategorinë e maturitetit '1-7 ditë', ndërsa rënia më e theksuar e depozitave me interes për të gjitha kategoritë tjera të maturimit tregon për zhvendosje të depozitave në kategorinë me maturitet të shkurtër. Ky zhvillim përkon me rënien e normave të interesit në depozita, gjë që ka zvogëluar atraktivitetin e afatizimit të depozitave.


Këto zhvillime në strukturën e depozitave theksojnë nevojën e rritjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi, ngase një zhvillim i tillë do të zvogëlonte rrezikun e likuiditetit dhe njëkohësisht do të krijonte mundësi më të mëdha për rritjen e kreditimit afatgjatë, zhvillim ky mjaft i nevojshëm për përmirësimin e kushteve të financimit të investimeve.

Financimi i jashtëm, megjithëse tradicionalisht është shfytëzuar në masë të vogël nga sektori bankar i Kosovës, gjatë periudhës deri në qershor 2015 regjistroi rritje të konsiderueshme si rrjedhojë e rritjes së detyrimeve ndaj bankave amë. Duke pasur parasysh që disa nga bankat amë të bankave në Kosovë janë pjesë të eurozonës, rritja e financimit në tregun e jashtëm mund të jetë ndikuar nga programi i lehtësimit sasior të Bankës Qendrore Evropiane, politike kjo që është reflektuar në rritjen e likuiditetit bankar në tregun e jashtëm dhe lehtësimin e kushteve kredituese në tregun e jashtëm.

#### 6.4.2. Rreziku kreditor

Një ndër rreziqet kryesore ndaj të cilit ekspozohet sektori bankar në Kosovë është rreziku kreditor. Në qershor 2015, raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive zbriti në 7.2 përqind nga 8.2 përqind në qershor 2014 (figura 63). Rënia e normës së NPL-ve krahasuar me një vit më parë i atribuohet përmirësimit të cilësisë së portofolios kreditore (që reflektohet nga rënia vjetore e vlerës së NPL-ve) si dhe rritjes më të shpejtë të stokut të kredive gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 (figura 64). Kreditë jo performuese në qershor 2014 shënuan rënie vjetore për 9.6 milionë euro që është përmirësim i theksuar krahasuar me rritjen vjetore prej 12.9 milionë euro të shënuar në qershor 2014 (26.4 milionë në

Figura 63. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2015)




qershor 2013). Gjithashtu, stoku i gjithsej kredive në dy vitet e fundit shënoi rritje vjetore dukshëm më të lartë prej 115.5 milionë euro në qershor 2015 krahasuar vitet paraprake (64.2 milionë në qershor 2014 dhe 49.5 milionë në qershor 2013). Në përmirësimin e kualitetit kreditor mund të ketë kontribuar edhe aplikimi i standardeve më strikte nga shumica e bankave në të kaluarën në dhënien e kredive. Po ashtu, licencimi i përmbaruesve privat mund të ketë ndikuar në rënien e vlerës së NPL-ve duke marrë parasysh ndikimin e tij në lehtësimin e zbatimit të kontratave kreditore. Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova ka nivelin më të ulët të kredive jo performuese duke qenë se mesatarja e rajonit në qershor 2015 qëndroi në 17.2 përqind.

Trendi rënës i normës së NPL-ve ishte më i theksuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 krahasuar me trendin rritës gjatë pjesës më të madhe të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014. Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, raporti më i lartë i NPL-ve ishte në muajin tetor 2014 (8.7 përqind) dhe në janar 2015 (8.6 përqind), përderisa vlerat më të ulëta u hasën në maj dhe qershor 2015 me vlerë të NPL-ve prej 7.6 përqind përkatësisht 7.2 përqind.

Spektori bankar ka ekspozim më të lartë të rrezikut kreditor në kreditë ndaj ndërmarrjeve, në kuadër të të cilave kreditë për energji dhe prodhimtari bartin normat më të larta të NPL-ve (figura 65). Për më tepër portofoli i kredive për sektorin e energjisë shënoi rritje të normës së NPL-ve gjatë vitit të fundit duke arritur në 19.1 përqind në qershor 2015 (14.8 përqind në qershor 2014). Ndërsa, portofoli i kredive për sektorin e prodhimtarisë u karakterizua me përmirësim të cilësisë, ku norma e NPL-ve zbriti në 10.6 përqind (12.2 përqind në qershor 2014). Spektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e kredive për ndërmarrje, gjithashtu shënoi normë më të ulët të NPL-ve prej 9.9 përqind krahasuar me vitin paraprak (11.5 përqind në qershor 2014). Përmirësim të portofolit kreditor, gjegjësisht rënie të normës së NPL-ve, shënuan edhe kreditë për sektorin i agrikulturës, turizmit dhe shërbimeve hoteliere, dhe i pasurive të patundshme. Norma e NPL-ve për sektorin e agrikulturës zbriti në 7.2 përqind (9.7 përqind në qershor 2014), për sektorin e turizmit dhe shërbimeve hoteliere norma e NPL-ve u zvogëlua në 7.4 përqind (9.3 përqind në qershor 2014), dhe për sektorin e pasurive të patundshme norma e NPL-ve u zvogëlua në 9.7 përqind (11.5 përqind në qershor 2014). Spektori i ekonomive familjare vazhdon të mbetet me ekspozimin më të ulët ndaj rrezikut kreditor, me normë të NPL-ve prej 2.6 përqind (2.8 përqind në qershor 2014).


Figura 64. Gjithsej kreditë dhe NPL-të, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2015)

Krahasuar me vendet e rajonit, jo performuese duke qenë se mesatarja e rajonit në

Figura 65. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2015)

Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor krahasuar me periudhën paraprake është shfaqur edhe përmes migrimit të kredive nga kategoritë me cilësi më të dobët drejt kategorisë së kredive pa vonesa (figura 66). Kreditë 'standard' rritën pjesëmarrjen për 2.8pp, ndërsa në anën tjetër, kreditë 'vrojtuese' dhe 'nën standarde' zvogëluan pjesëmarrjen për 0.6pp përkatësisht 1.2 pp. Ngjashëm, edhe dy kategoritë përbërëse të kredive jo performuese shënuan zvogëlim të pjesëmarrjen për 0.8pp (kategoria 'të dyshimta') përkatësisht 0.1pp (kategoria 'të humbura').

Zvogëlimi i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor mund të vërehet edhe në figurën 67<sup>13</sup> që reflekton ndryshimet në tri kategoritë kryesor të kredive me probleme. Krahasuar me periudhën paraprake, rënia më e theksuar u vërejt tek kreditë me vonesa, ku raporti i tyre ndaj gjithsej kredive ishte 12.4 përqind (15.2 përqind në qershor 2014). Ndërsa, raporti i kredive të klasifikuara (që paraqet kreditë me vonesa mbi 61 ditë ndaj gjithsej kredive) në qershor 2015 u zvogëlua në 10.1 përqind nga 12.3 përqind në vitin paraprak.

Krahas përmirësimit të përgjithshëm të portofolit kreditor, niveli i provizionimit të sektorit ka shënuar rritje. Raporti i mbulimit të kredive joperformuese me provizione është rritur në 119.3 përqind nga 116.4 përqind në qershor 2014 (figura 68). Gjithashtu, rënia më e theksuar të kredive në kategorinë 'nën standard' ka ndikuar që raporti i mbulimit me provizione të kredive të klasifikuara (kreditë 'nën standarde', 'me vonesa' dhe 'të humbura') të shënoj rritje më të theksuar në 85.5 përqind në qershor 2015 nga 77.8 përqind në qershor 2014.

Rimëkëmbja e kreditimit mund të ketë ndikim pozitiv në zgjerimin e aktivitetit të ndërmarrjeve dhe mund të reflektohet në përmirësimin e kapacitetit të tyre për kthim të kredive ekzistuese dhe atyre të reja. Lehtësimi i standardeve kredituese nga bankat në periudhën e fundit si dhe ofrimi i kushteve më të mira për marrje të kredive (normat më të favorshme të interesit) mund të

Figura 66. Struktura e kredive sipas klasifikimit




Figura 67. Ecuria e kredive sipas klasifikimeve kreditore, në përqindje





Figura 68. NPL-të dhe provizionet



<sup>13</sup> Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditore të mësipërme grupohen në tri kategori të ekspozimit të rrezikut kreditor: Kreditë me vonesa, të cilat përfshijnë kategoritë vrojtuese, nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura; Kreditë e klasifikuara që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe Kreditë jo performuese që përfshijnë kreditë e dyshimta dhe të humbura.

tërheqin aplikacione për kredi edhe nga klientët me “gradim” më të ulët financiar. Prandaj, kërkohet që zgjerimi i mëtejshëm i kreditimit të bëhet në përputhje me parimet e kreditimit të shëndoshë, me qëllimi të evitimit të përkeqësimit të mundshëm të cilësisë së kredive.

### Koncentrimi i rrezikut kreditor

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i rrezikut kreditor është shkalla e koncentrimin të ekspozimeve kreditore. Koncentrimi i rrezikut kreditor në sektorin bankar të Kosovës ka shënuar rënie në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ekspozimi i rrezikut kreditor, që matet si raport i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë, u zvogëluar në 81.2 përqind nga 124.0 përqind në qershor 2014 (figura 65). Kjo rënie në masë të madhe i atribuohet rritjes për 30.2 përqind të kapitalit të klasit të parë në qershor 2015, si rrjedhojë e rritjes së lartë të profitit të realizuar gjatë kësaj periudhe. Vlera e ekspozimeve të mëdha në qershor 2015 ishte 277.4 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 14.7 përqind. Në rënien e ekspozimit të rrezikut kreditor gjatë kësaj periudhe, ndikimin më të madh e kishin tri bankat më të mëdha, tek të cilat raporti i ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë u zvogëluar në 69.7 përqind (118.3 në qershor 2014). Në bankat tjera, ky raport në qershor 2015 ishte 106.2 përqind (138.2 përqind në qershor 2014).


Përveç rënies së vlerës, rënie kishte edhe në numrin e ekspozimeve të mëdha kreditore. Në qershor 2015, numri i ekspozimeve të mëdha zbriti në 51 nga 64 sa ishin në qershor 2014. Mirëpo, vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha ishte më e lartë se sa në vitin paraprak, duke qëndruar në 5.4 milion euro në qershor 2015 (5.1 milion në qershor 2014). Kjo sugjeron për një përqendrim më të lartë të rrezikut kreditor në një numër më të vogël të ekspozimeve kreditore.

Tendenca rënëse e ekspozimit kreditor gjatë kësaj periudhe, në krahasim me vitin e kaluar, tregohet edhe nga zvogëlimi i shumës së tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve, e cila shënoi rënie për 2.5 pikë përqindje, duke qëndruar në 58.2 përqind në qershor 2015.

### 6.4.3. Rreziku i solvencës


Sektorin bankar i Kosovës vazhdon të përforcojë edhe më tutje pozitën e kapitalizimit. Në qershor 2015, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR), që

Figura 69. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2015)

Figura 70. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK (2015)

paraqet raportin ndërmjet gjithsej kapitalit rregullator dhe asetëve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 19.0 përqind krahasuar me 17.4 përqind sa ishte një vit më parë (figura 70).<sup>14</sup>

Ngritja e treguesit të kapitalizimit ishte rezultat i normës më të lartë të rritjes vjetore të kapitalit rregullator prej 20.2 përqind, në krahasim me rritjen vjetore prej 10.5 përqind të Aseteve të Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) (figura 71). Gjithashtu, norma e kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Tier I capital to RWA) u përmirësua në 15.9 përqind nga 13.5 përqind sa ishte në qershor 2014.


Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar në vend ishte gjithashtu mbi mesataren e vendeve të rajonit, ku norma mesatare e Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit në vendet e rajonit në qershor 2015 ishte 17.5 përqind. Një indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, i cili në qershor 2015 arriti në 11.7 përqind nga 10.1 përqind sa ishte në qershor të vitit paraprak. Rritja rezultoi kryesisht si rrjedhojë e rritjes më të madhe të gjithsej ekuitetit (rritje vjetore prej 24.1 përqind në qershor 2015) në krahasim me rritjen e gjithsej asetëve (rritje vjetore prej 6.9 përqind). Rritja e ekuitetit ishte kryesisht rezultat i rritjes së profitit të realizuar nga bankat, përderisa rritja më e ulët e gjithsej asetëve të sektorit bankar ishte kryesisht rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave në sektorin bankar. Raporti aktual i levës tejkalon kërkesën rregullatore që kërkon një shkallë minimale prej 7 përqind.<sup>15</sup> Sidoqoftë, niveli aktual është nën nivelin e vendeve të rajonit, të cilat në qershor 2015, në mesatare, kishin raport të levës prej afër 13.9 përqind.<sup>16</sup>

### Kapitali rregullator

Kapitali rregullator i sektorit bankar, në qershor 2015, arriti vlerën 408.9 milionë euro, duke tejkaluar kërkesën minimale për kapital rregullator për 150.2 milionë euro. Cilësia e kapitalit, e shprehur nga pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin, ka shënuar përmirësim në krahasim me vitet paraprake, kur cilësia e kapitalit kishte shënuar rënie si rezultat i rritjes së financimit të kapitalit rregullator nga burime të kapitalit të klasit të dytë (figura 72).


Vlera e kapitalit të klasit të parë arriti në 341.7 milionë euro në qershor 2015, që paraqet një rritje vjetore prej 30.2 përqind. Pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullator arriti në 83.6 përqind në qershor 2015 (77.1 përqind në qershor 2014).

Figura 71. Kapitali rregullator dhe RWA-të



Burimi: BQK (2015)

Figura 72. Struktura e kapitalit rregullator, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

<sup>14</sup> Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

<sup>15</sup> Rregullorja e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit.

<sup>16</sup> Mesatarja e raportit të levës për rajonin (vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia) të kalkuluara nga BQK nga raportet e bilanceve të gjendjes të vendeve përkatëse, të raportuara në Bankat Qendrore përkatëse.

Rritja e konsiderueshme e profitit të sektorit gjatë vitit 2014 dhe që ka vazhduar edhe në gjysmën e parë të vitit 2015 është reflektuar në rritjen e konsiderueshme të kapitalit të klasit të parë. Ndërsa, ndikim negativ në shumën e kapitalit rregullator kishte shpërndarja e dividendës nga bankat, gjë e cila ndikoi përmes zvogëlimit të profitit të pashpërndarë. Performanca e mirë financiare në vitet e fundit është një tregues që sektori bankar ka potencial për rritjen e mëtejme të kualitetit të kapitalit përmes shtimit të nivelit të kapitalit, që do të reflektohej edhe në rritjen e raportit të levës.


Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Kapitali aksionar vazhdon të jetë kategoria dominuese e kapitalit të klasit të parë, por me rënie të lehtë të pjesëmarrjes (78.1 përqind krahasuar me 86.2 përqind sa ishte në qershor 2014) si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së kategorisë së dytë për nga madhësia e cila përbëhet nga profiti (i mbajtur nga viti paraprak dhe ai i akumuluar deri në qershor 2015) (figura 73).

Kapitali i klasit të dytë, në anën tjetër, shënoi rënie vjetore prej 13.8 përqind duke arritur vlerën në 67.2 milionë euro në qershor 2015. Kjo rënie ishte si rezultat i zvogëlimit të borxhit të ndërvarur për 20.6 përqind. Në qershor 2015, vlera e borxhit të ndërvarur ishte 45.5 milionë euro dhe përbënte 67.3 përqind të kapitalit të klasit të dytë (figura 74). Pjesa e mbetur prej 32.2 përqind e kapitalit të klasit të dytë përbëhej nga provizionet e përgjithshme për kreditë.<sup>17</sup> Për dallim nga vitet e mëhershme kur, megjithëse në përqindje shumë të vogël, bankat shfrytëzonin instrumentet e borxhit detyrimisht të konvertueshëm në aksione për plotësim të kapitalit, në katër vitet e fundit këto instrumente nuk kanë gjetur aplikim.

### Asetet e peshuara ndaj rrezikut


Vlera e aseteve të peshuara ndaj rrezikut (angl. Risk-Weighted Assets: RWA) në qershor 2015 arriti në 2.16 miliardë euro nga 1.95 miliardë euro sa ishte një vit më parë. Rritja e RWA-ve ishte kryesisht

Figura 73. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Figura 74. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Figura 75. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2015)

<sup>17</sup> Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25% të aseteve të peshuara ndaj rrezikut.

rezultat i rritjes së aseteve me peshë rreziku 100 përqind, të cilat përfshijnë kreditë dhe zërat jashtë-bilancor. Vlera e këtyre aseteve në qershor 2015 arriti në 1.70 miliardë euro (1.41 miliardë në qershor 2014) duke rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej RWA-të në 78.9 përqind (72.5 përqind në qershor 2014) (figura 75). Rritja e kësaj kategorie të RWA-ve u ndikua nga përshpejtimi i rritjes së aktivitetit kredites, kategori që pjesën më të madhe të aseteve i ka në kuadër të peshës së rrezikut prej 100 përqind.

Në anën tjetër, asetet me peshë të rrezikut prej 75 përqind kanë shënuar rënie të konsiderueshme, duke zvogëluar efektin e rritjes së gjithsej RWA-ve nga rritja e theksuar e aseteve me peshë rreziku prej 100 përqind. Këto asete të cilat përbëhen nga kreditë e mbuluara me kolateral të rendit të parë<sup>18</sup> kanë zbritur në 208.2 milionë euro nga 295.3 milionë në qershor 2014, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej RWA-të zbriti në 9.7 përqind nga 15.1 përqind sa ishte në vitin paraprak.


Kategoria e aseteve me peshën më të lartë të rrezikut (150 përqind), të cilat përfshijnë kërkesat direkte me maturitet prej '1 viti apo më pak' dhe të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga BQK-ja, por që kanë klasifikim kreditor me rrezik të lartë mos pagese (nën B- sipas vlerësimeve të Fitch), shënuan rritje, por që pjesëmarrja e tyre në gjithsej RWA është e ulët (0.1 përqind). Vlera e tyre në qershor 2015 arriti në 1.9 milionë euro nga 1.2 milionë euro në vitin paraprak.

Kategoritë tjera të RWA-ve nuk pësuan ndonjë ndryshim të theksuar. Ndërsa, nga gjithsej asetet e sektorit<sup>19</sup>, vlera e aseteve të cilat nuk bartin rrezik, apo që peshohen me rrezik 0%, shënoi rënie në 58.1 përqind të vlerës së RWA-ve nga 59.7 përqind në qershor 2014. Kjo mund të mund të kuptohet edhe prirje për rritje të shkallës së rrezik-marrjes nga sektori bankar i Kosovës. Kjo mund të mbështet edhe nga fakti se raporti i RWA-ve ndaj gjithsej aseteve ka shënuar ngritje gjatë dy viteve të fundit (figura 76). Në qershor 2015, pjesëmarrja e aseteve që bartin rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar ka arritur në 62.2 përqind nga 60.6 përqind në qershor 2014.

#### 6.4.4 Rreziku i tregut


Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet nga lëvizjet në normat e interesit, vazhdon të mbetet në nivel të ulët. Pozicioni i agreguar neto i hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ka shënuar rënie të konsiderueshme, duke zbritur edhe më tej ndjeshmërinë edhe ashtu të ulët të

Figura 76. Raporti i RWA-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK (2015)

Figura 77. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë



Burimi: BQK (2015)

<sup>18</sup> Specifikisht asetet e peshuara me 75 përqind shkallë rreziku përfshijnë kreditë apo pjesë të tyre të mbuluara me kolateral të rendit të parë në formë të hipotekave të banimit si dhe kreditë për ndërtuesit për të financuar ndërtimin e pasurive të patundshme ku prona e financiar ka qenë shitur apo e lëshuar me qira.

<sup>19</sup> Në këtë kalkulim janë përfshirë edhe asetet jashtë-bilancore për shkak të përfshirjes së tyre në llogaritjen e gjithsej RWA-ve.

sektorit ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit. Kreditë në valutë të huaj kanë shënuar rritje vjetore prej 5.5 përqind mirëpo, duke pasur pjesëmarrje mjaft të ulët në gjithsej portofolin kreditor (0.3 përqind në qershor 2015), nuk paraqesin rrezik për sektorin bankar.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit vazhdon të mbetet i ulët. Zërat kryesorë të bilancit të gjendjes së sektorit bankar, gjegjësisht kreditë dhe depozitat, bartin kryesisht norma fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Megjithatë, ekziston rreziku i normës së interesit në kuptimin e rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve, ku ndryshimet e mundshme në norma të interesit reflektohen më shpejtë në anën e detyrimeve të sektorit për shkak të maturitetit më të shkurtër të detyrimeve që bartin interes në raport me asetet. Me qenë se hendeku i aseteve dhe detyrimeve me ndjeshmëri ndaj normave të interesit nuk ka pjesëmarrje shumë të lartë në gjithsej asetet, atëherë ndryshimet në norma të interesit mund të kenë ndikim të vogël në qëndrueshmërinë e sektorit.


### Rreziku nga normat e këmbimit valutor

Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj është zvogëluar gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Kjo si rezultat i rënies së aseteve në valutë të huaj në 127.7 milionë euro (vlerë ekuivalente) nga 145.8 milionë në qershor 2014. Një ecuri e ngjashme rezultoi edhe në anën e detyrimeve në valutë të huaj të cilat shënuan rënie në 128.7 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2015, nga 146.9 milionë në qershor 2014 duke bërë që pozicioni i hapur neto lehtësisht të ngushtohet në -1 milionë euro vlerë ekuivalente (-1.1 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2014). Në anën tjetër, pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat<sup>20</sup> shënoi rënie në 2.8 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2015 nga 6.9 milionë euro vlerë ekuivalente në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie, së bashku me rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe, bëri që raporti i pozicionit të agreguar neto të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë të zbrësë në 0.8 përqind krahasuar me 2.6 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 77).

Në aspektin e disagreguar valutor, pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë e arriti frangu zviceran, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur pozicionin më të lartë e kishte dollari amerikan. Në qershor 2015, ky raport për frangun zviceran ndërroi kahje në -0.23% (nga 0.38% në qershor 2014), ndërsa për dollarin amerikan raporti zbriti në -0.02% (nga -0.65% në qershor 2014). Raporti i pozicioneve neto të hapura për valuta individuale ndaj kapitali të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën maksimumin prej 15 përqind të lejuar nga BQK-ja. Bazuar në këto të dhëna, mund të sugjerohet që sektori bankar vazhdon të mbetet mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.

Kreditimi në valutë të huaj nga sektori bankar i Kosovës vazhdon të jetë mjaft i ulët, megjithatë në qershor 2015, u rrit në 6.3 milionë nga 5.9 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2014. Mirëpo, raporti i tyre ndaj gjithsej

Figura 78. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK (2015)

<sup>20</sup> Pozicioni i agreguar neto i hapur nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në të gjitha valutat. Për shembull, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezulton në neto pozicion të agreguar prej 2 milionë euro, përderisa pozicioni neto i hapur do të ishte 0.

portofolit kreditor mbeti në 0.31 përqind që është pothuajse i njëjtë me qershorin e vitit paraprak ngase, krahas rritjes së kredive në valutë të huaj, shënoi rritje edhe gjithsej stoku i kredive.

Në anën tjetër, depozitat në valutë të huaj kanë pjesëmarrje më të lartë në gjithsej depozitat megjithatë në qershor 2015 vërehet në ngushtim i pjesëmarrjes së tyre në 4.6 përqind nga 5.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithsej vlera e depozitave në valutë të huaj shënoi rënie në 117.9 milionë nga 138.3 milionë euro vlerë ekuivalente në qershor 2014. Rënia më e lartë e depozitave krahas rritjes së kredive në valutë ndikoi që raporti i kredive ndaj depozitave në valutë të huaj të ngritët në 5.3 përqind nga 4.3 përqind në qershor 2014 (figura 78).


### Rreziku nga ndryshimet në normat e interesit

Spektori bankar i Kosovës është i mbrojtur relativisht mirë ndaj ndryshimeve në normat e interesit, për faktin që kreditë dhe depozitat kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këta zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Afër 91.2 përqind e gjithsej kredive kishin normë fikse të interesit në qershor 2015, ndërsa depozitat që bartin normë fikse të interesit përbënin 100 përqind të gjithsej depozitave me interes (figura 79).

Megjithatë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të aseteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve që bartin interes (figura 80), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi mes aseteve dhe detyrimeve që bartin interes është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit deri në 30 ditë, ku detyrimet që bartin interes tejkalojnë asetet për 393 milionë euro. Gjatë qershor 2015, ky hendek ka shënuar rritje në -393.1 milionë euro nga -362.9 milionë euro në qershor 2014. Marrë parasysh që hendeku është negativ për këtë kategori maturiteti (vëllimi i detyrimeve që bartin interes është më i lartë se i aseteve), ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen më shumë në shpenzime krahasuar me të hyrat e sektorit. Rrjedhimisht sektori bankar është i ekspozuar ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në afat të shkurtër pasi që që kosto e rifinancimit të depozitave do të rritej më shpejtë se që mund të rriten të hyrat nga interesi marrë parasysh maturitetin më të gjatë të aseteve.


Sidoqoftë, gjatë periudhës gjashtëmujore, hendeku kumulativ është zgjeruar dhe mbeti pozitiv kryesisht për shkak të rënies së detyrimeve që bartin interes. Në qershor 2015, hendeku i aseteve dhe detyrimeve që bartin interes për periudhën e maturitetit deri në 1 vit arriti në 250.1 milionë euro për dallim nga hendeku prej 20.1 milionë euro në qershor 2014. Në këtë situatë të

Figura 79. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2015)

Figura 80. Hendeku i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)



hendekut pozitiv, ndryshimi i normave të interesit në periudhën një vjeçare ndikon më shumë në të hyrat se në shpenzimet e sektorit, andaj ekspozimi i përgjithshëm i sektorit ndaj rritjes së normave të interesit pothuajse neutralizohet.

#### Kutia 4. Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së rëndësisë sistemike të bankave komerciale në vend. Në përgjithësi, një bankë konsiderohet të ketë rëndësi sistemike nëse pritet që dështimi i mundshëm i saj të manifestohej me pasoja të rëndësishme negative për funksionimin dhe stabilitetin e tërë sektorit dhe për ekonominë në tërësi. Andaj, monitorimi i vazhdueshëm i shkallës së rëndësisë sistemike konsiderohet të jetë i rëndësishëm së veçantë për stabilitetin financiar për shkak se mundëson identifikimin e bankave dështimi i mundshëm i të cilave do të mund të kishte ndikim më të madh për sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi.

Ky artikull paraqet vlerësimin e shkallës së rëndësisë sistemike për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në tregun bankar të Kosovës duke u bazuar në të dhënat e muajit qershor 2015. Për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave, modeli bazohet në katër kriteret bazë: kriterin e madhësisë, kriterin e zëvendësueshmërisë, kriterin e ndërlikohjes dhe kriterin e kompleksitetit. Dy kriteret e para të sugjeruara nga modeli bazë (madhësia dhe zëvendësueshmëria) janë konsideruar si kriteret themelore për përcaktimin e rëndësisë sistemike në rastin e Kosovës, andaj dhe pesha e tyre në model është dominuese me nga 40 përqind secila. Ndërsa, dy kriteret tjera (ndërlikohja dhe kompleksiteti) janë peshuar me nga 10 përqind duke u bazuar në faktin që sektori bankar i Kosovës ka shkallë të ulët të ndërlikohshmërisë së institucioneve në kuptimin e kreditimit dhe huazimit të ndërsjellë, si dhe është i bazuar në aktivitetet tradicionale të bankingut ku shkalla e kompleksitetit është e ulët.

**Tabela 6. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë**

Kriteri	Indikatorët
<b>Madhësia (pesha 40%)</b>	<p>Pjesëmarrja e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e asetëve të sektorit</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e depozitave të sektorit</p> <p>Kapitali vetanak i bankës në raport me gjithsej kapitalin e sektorit</p> <p>Pjesëmarrja e letrave me vlerë të sektorit</p> <p>Numri i depozitorëve të bankës në raport me gjithsej depozitorët</p> <p>Pjesëmarrja e mjeteve likuide të sektorit</p>
<b>Zëvendësueshmëria (pesha 40%)</b>	<p>Pjesëmarrja në kreditë për bujqësi të gjithsej sektorit</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë për konsum të ekonomive familjare</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë e industrisë, prodhimit, energjisë dhe ndërtimitarisë</p> <p>Pjesëmarrja në kreditë e tregtisë</p> <p>Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave</p> <p>Pjesëmarrja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës</p> <p>Pjesëmarrja në tregun e gjithsej kredive</p>
<b>Ndërlikohshmëria (pesha 10%)</b>	<p>Pjesëmarrja e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe bankat tjera</p> <p>Pjesëmarrja e kredive për korporatat tjera financiare</p> <p>Pjesëmarrja e plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë)</p>
<b>Kompleksiteti (pesha 10%)</b>	<p>Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor</p>

Burimi: BQK (2015)

Për secilin nga kriteret janë përcaktuar indikatorët përmes të cilëve synohet matja e shkallës së rëndësisë sistemike të bankave individuale. Indikatorët e përdorur janë paraqitur në tabelën 6, dhe secilit prej indikatorëve brenda kriterit të caktuar i është dhënë peshë e barabartë. Përzgjedhja e indikatorëve është bërë konform sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model.<sup>21</sup>

<sup>21</sup> Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike është zhvilluar bazuar në principet bazë të modelit për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike të hartuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare në qershor 2012, si dhe në modelin paraprak të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për Identifikimin e Bankave

Supozimi i përgjithshëm në raport me kriterin e madhësisë, i konsideruar si kriteri kryesor për matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, është që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe është rëndësia e saj sistemike me që palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve është synuar të matet si në aspektin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së aseteve në gjithsej asetet e sektorit, ashtu edhe në aspekte të veçanta të bilancit të gjendjes siç janë pjesëmarrja e depozitave të bankës përkatëse në gjithsej depozitat e sektorit, numri i depozitorëve, pjesëmarrja e parave të gatshme dhe rezervave, etj. për të reflektuar kështu rëndësinë e tyre në aspekte/segmente të veçanta të sektorit bankar, si p.sh. numri i depozitorëve që mund të ndikohet në rast të paraqitjes së problemeve apo falimentimit të mundshëm të një banke të caktuar.

Kriteri i zëvendësueshmërisë synon që të masë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Supozimi kryesor për kriterin e zëvendësueshmërisë është që sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. vlerësimin e rrezikut të kredive për sektorin e bujqësisë), gjë që e bën më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në atë fushë nga bankat ekzistuese apo edhe nga bankat e reja që mund të hyjnë në treg. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë së institucioneve bankare ndërmjet vete si dhe me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës të krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistematik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndërbankar është pothuajse joekzistent dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar kanë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare në këtë model matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor për korporatat tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare.

Sa i përket kriterit të kompleksitetit, synimi i tij është që të masë shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Në rastin e Kosovës, si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancorë në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

Për të identifikuar rëndësinë sistemike të një bankë është krahasuar vlera e secilit indikator me vlerën mesatare të indikatorit përkatës për tërë sektorin. Në rastet kur vlera e indikatorit të një institucioni ka tejkaluar vlerën mesatare të sektorit, atëherë ai institucion është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për indikatorin përkatës. Kur indikator ka rezultuar mbi mesataren e sektorit (i rëndësisë sistemike), atij i është dhënë vlera 1, ndërsa në të kundërtën i është përcaktuar vlera 0. Në vazhdimësi, këto vlera janë shumëzuar me peshën e indikatorit përkatës, dhe kur një bankë ka rezultuar të ketë rëndësi sistemike në gjysmën apo më shumë se gjysmën e indikatorëve të një kriteri, atëherë ajo është konsideruar të ketë rëndësi sistemike për kriterin përkatës. Në fund, bankat të cilat kanë rezultuar të kenë shumën e mesatares së peshuar të kriterëve të barabartë ose më të lartë se 50 përqind, atëherë ato banka janë konsideruar të kenë rëndësi sistemike. Sa më e lartë mesatarja e peshuar, aq më e lartë vlerësohet të jetë rëndësia sistemike e atij institucioni.

## Rezultatet

Rezultatet e përgjithshme të modelit me të dhëna të muajit qershor 2015 janë paraqitur në tabelën 7. Rezultatet mbesin të ngjashme me ato të periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Katër bankat më të mëdha që operojnë në Kosovë vazhdojnë të konsiderohen me rëndësi të përgjithshme sistemike. Sidoqoftë, intervali

me Rëndësi Sistemike në Kosovë (Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 3, 2012). Vlerësimi dhe modifikimi i specifikave të modelit bëhet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të avancimit të tij.

i shkallës së rëndësisë sistemike ka shënuar rënie dhe shtrihet nga 65 përqind, për bankën sistemike me shkallën më të ulët të rëndësisë sistemike, deri në 91 përqind për bankën me shkallën më të lartë të rëndësisë sistemike, për dallim nga muaji qershor i vitit 2013 kur intervali ishte 65 përqind – 94 përqind. Ndër tjerash, kontribut në këtë rënie kishte një bankë me rëndësi të përgjithshme josistemike intervali i të cilës u rrit në 40 përqind në qershor 2015 nga 9 përqind në qershor 2014. Rritja e peshës së kësaj banke me rëndësi të përgjithshme josistemike ishte si rezultat i zgjerimit të aktivitetit kreditues dhe investimeve në letrat në vlera krahasuar me periudhën paraprake. Dy nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike, ngjashëm me periudhat paraprake, rezultuan me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Ndërsa dy të tjerat, përkundër rëndësisë sistemike të përgjithshme, nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhshmërisë.

### Tabela 7. Rezultatet e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë, sipas kriterëve

(Radhitja e bankave është bërë në mënyrë të rastësishme)

Bankat/Kriteri	Madhësia	Zëvendësueshmëria	Ndërlidhshmëria	Kompleksiteti	TOTAL
Banka 1					
Banka 2					
Banka 3			√	√	
Banka 4					
Banka 5	√	√	√	√	√
Banka 6	√	√		√	√
Banka 7	√	√	√	√	√
Banka 8	√	√		√	√
Banka 9					

Burimi: BQK (2015)

Rezultatet gjithashtu sugjerojnë që njëra nga bankat më të vogla, e cilat nuk rezultoi me rëndësi të përgjithshme sistemike për shkak të pjesëmarrjes më të ulët në treg, megjithatë doli të ketë rëndësi sistemike në dy nga kriteret – atë të ndërlidhshmërisë dhe kompleksitetit (në qershor 2014 kjo bankë nuk kishte rëndësi sistemike në asnjërin nga kriteret e cekur më lartë). Gjithashtu, vlen të theksohet se disa nga bankat, megjithëse nuk rezultuan të kenë rëndësi sistemike për kriterin e zëvendësueshmërisë dhe ndërlidhshmërisë, dolën të kenë pjesëmarrje të rëndësishme në disa indikatorë si numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave, pjesëmarrja në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, pjesëmarrja në gjithsej kreditë e lëshuara për sektorin e industrisë (miniera, prodhim, energjetikë), si dhe pjesëmarrja e depozitave dhe huazimeve nga korporatat tjera financiare dhe plasmanët në banka tjera duke mos përfshirë bankat amë. Një rezultat i tillë, ku bankat kanë rëndësi sistemike në disa indikatorë dhe kriteret të caktuara, por jo edhe rëndësi sistemike të përgjithshme, sugjeron që efekti i dështimeve të mundshme të këtyre bankave megjithatë mund të jetë i rëndësishëm për sektorë dhe aspekte të caktuara të sektorit financiar dhe atij real.

### 6.5. Analiza Stres-Test

Analiza stres-test paraqet një vegël të rëndësishme të vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj tronditjeve të mundshme në portofolin kreditor si dhe në pozitën e likuiditetit, të cilat mund të pasojnë nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike dhe ndryshimet në kushtet e tregut. Përmes kësaj analize vlerësohet ndikimi i këtyre tronditjeve në kualitetin e portofolit kreditor, në pozitën e likuiditetit, si dhe në nivelin e kapitalizimit.

Analiza e prezantuar më poshtë ka për bazë të dhënat e sektorit bankar të Kosovës për muajin qershor 2015, të cilat janë shfrytëzuar për vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit valutor

(rreziku i tregut). Në analizë është testuar gjithashtu aftësia e sektorit që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike për tërheqje të konsiderueshme të depozitave (rreziku i likuiditetit).

Rezultatet e analizës stres-test në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar “situatat ekstreme” të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

### 6.5.1 Rreziku kreditor

#### Metodologjia

**Skenari bazë:** Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, rritja ekonomike në vend supozohet të zvogëlohet, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.4 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.6 përqind për vitin 2015. Në këtë situatë, hendeku i prodhimit do të ishte 6.0 përqind, ndërsa ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8,<sup>22</sup> që nënkupton rritje prej 4.8pp të pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues.

Në një skenar shtesë ndaj skenarit bazë, krahas rrezikut kreditor, janë konsideruar edhe efektet e rrezikut të tregut në të hyrat e sektorit. Pra, rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit. Normat e interesit për pjesën e aseteve janë supozuar të bien për 2.0pp, ndërsa për pjesën e detyrimeve të ngriten për 1.5pp kryesisht si rezultat i konkurrencës ndërbankare. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave të tjera është supozuar të jetë 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh afatin e maturimit të aseteve dhe detyrimeve dhe riinvestimin/rifinancimin e tyre.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të hyrave nga interesi si rezultat i mos rritjes së kreditimit si dhe dështimit të kredive (rritjes së NPL-ve). Andaj, profiti i pritshëm i bankave është marrë aktual për gjashtëmujorin e parë ndërsa profiti për gjashtëmujorin e dytë është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të vitit 2014, ndaj të cilit fillimisht është aplikuar tronditje prej 40 përqind për të reflektuar efektin e mos rritjes së kreditimit, dhe pastaj janë zbritur edhe të hyrat që do të realizoheshin po qe se NPL nuk do të rritej.<sup>23</sup>

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive jo performuese (të dyshimta dhe të humbura). Kjo rritje është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë

<sup>22</sup> Notë e papublikuar e FMN-së “CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise”, Korrik 2009.

<sup>23</sup> Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së NPL-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të NPL-ve.

së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin shtesë është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë minor për shkak të vlerës së ulët të pozicioneve të hapura neto në valutë të huaj.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp për asetet dhe rritjen për 1.5pp për detyrimet në bilancin e gjendjes. Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në margjinën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Efekti negativ në të hyra nga rënia e normës së interesit në anën e aseteve theksohet edhe më tutje nga efekti negativ që ka rritja e normës së interesit për detyrimet.

**Skenarë tjerë shtesë:** Krahas skenarëve bazë të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i NPL-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullator të sektorit bankar, mjeteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

## Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave në qershor 2015 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) në 18.5 përqind (tabela 8). Sektori bankar vazhdoi të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë, të cilat qëndruan në 7.2 përqind, si dhe mbulueshmërisë së tyre me provizione të cilat në qershor 2014 ishin në nivelin prej 119.3 përqind. Andaj, si rezultat i pozicionit të mirë fillestar si dhe profitabilitetit më të lartë që nga fillimi i funksionimit të tij, sektori bankar i Kosovës ka treguar nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e supozimit të skenarëve hipotetik të përshkruar më lartë.

Nën supozimet e skenarit bazë për vlerësimin e rrezikut kreditor (bilancor dhe jashtë bilancor), në të cilin pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.8pp, ndërsa profiti i pritur për tërë vitin do të shfrytëzohej për absorbimin e humbjeve – treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) i sektorit bankar do të zbriste në normën prej 18.2 përqind,<sup>24</sup> që është mbi minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga BQK-ja. Sidoqoftë, në nivel të bankave individuale, CAR për një nga bankat do të zbriste në nivelin 12 përqind. Mjetet e nevojshme për të rikthyer kapitalizimin në nivelin e kërkuar do të arrinin në 0.15 milionë euro (ekuivalent me 0.003

<sup>24</sup> Vlen të theksohet se në këtë edicion, ashtu si në Raportin e Stabilitetit nr.6, ka ndryshim metodik në vlerësimin e rrezikut kreditor, ku humbjet e vlerësuar vjetore tash e tutje nuk zbriten nga mjetet e peshuara me rrezik për qëllim të kalkulimit të normës së kapitalizimit (CAR) pas tronditjeve. Ky ndryshim është konform praktikës që kreditë e klasifikuara si të humbura nuk ndodhë të shlyhen nga bilanci i gjendjes para se të kalojë një vit, dhe me që horizonti kohor i analizës stres-test është një vit, sugjerohet që humbjet e tilla të mbeten në kuadër të mjeteve të peshuara me rrezik me faktor (peshë) të njëjta të rrezikut. Ky ndryshim metodik paraqet qasje më konservative të vlerësimit të rrezikut kreditor në krahasim me edicionet paraprake.

përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2015). Në këto rrethana, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 12.0 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale niveli më i lartë i normës së NPL-ve do të ishte 14.6 përqind.

Duke u bazuar në supozimet e lartpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 75.6 milionë euro (1.3 përqind të PBB-së). Megjithatë, kjo vlerë nuk mund të konsiderohet në tërësi si humbje eventuale e sektorit me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar. Gjithashtu, një pjesë e humbjeve supozohet se mund të kompensohet nga realizimi i kolateralit apo nga riprogramimi, por që ky aspekt nuk është konsideruar për qëllim të kësaj analize.

Rezultatet e skenarit shtesë, në të cilin rreziku kreditor kombinohet me rrezikun e tregut, ku krahas rritjes së normës së NPL-ve për 4.8pp, përfshihet edhe zhvlerësimi i euros dhe rënia e normave të interesit në nivelet e supozuara më lartë, CAR e sektorit bankar do të zbriste në 17.5 përqind. Dy banka do të zbrisnin nën minimumin rregullator të CAR prej 12 përqind, dhe nevojat për rikapitalizim do ishin 1.84 milionë euro (0.03 përqind të PBB-së). Në këtë skenar, efekti i zhvlerësimit të euros paraqitet në nivel të ulët si rezultat i vlerës së ulët të pozicionit të hapur neto në krahasim me efektin nga rënia e normave të interesit i cili ishte më i theksuar.

Një skenar tjetër shtesë supozon dështimin e ekspozimeve të mëdha. Rezultatet e skenarit në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat sugjeron që CAR i sektorit do të zbriste në 17.1 përqind. Në këto rrethana, në një bankë CAR do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 8.48 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.15 përqind të PBB-së së vlerësuar për vitin 2015). Në supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i sektorit do të zbriste në 15.6 përqind, ndërsa numri i bankave të nënkapitalizuara do të arrinte në dy. Vlera e nevojshme për rikapitalizimin e sektorit bankar do të arrinte në 13.1 milionë euro (vlerë ekuivalente me 0.23 përqind të PBB-së së vlerësuar për vitin 2015).

Nivelet përbaluese të NPL-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të zbres nën nivelin 12 përqind) duken të jenë mjaft të larta për shumicën e bankave. Në një prej bankave, NPL do të mund të rritej deri në 39.2 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përbaluese të normës së NPL-ve paraqiten më të ulëta, ku niveli më i ulët në njërin nga bankat është 13.0 përqind (vetëm 4.8pp më shumë se niveli i NPL-ve para tronditjes). Sektori bankar në tërësi është në gjendje të përballojë një raport të NPL-ve deri në 19.1 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim kapitali shtesë për mbajtjen e CAR të sektorit në nivelin e kërkuar rregullator prej 12 përqind.

**Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: rreziku kreditor**

Përshkrimi	Numri i bankave 1/			CAR			NPL			Rikapitalizimi 2/	
	CAR <0	CAR 0-8%	CAR 8-12%	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Niveli më i ulët	Niveli më i lartë	Niveli i sektorit	Në milionë	Si % e PBB-së
Nivelet aktuale (para goditjeve)	0	0	0	13.2%	23.2%	18.5%	4.7%	9.8%	7.2%		
Rezultatet e makroskenarëve											
Skenari bazë	0	0	1	11.9%	23.3%	18.2%	4.8%	14.6%	12.0%	€ 0.15	0.00%
Kombinimi me rrezik të tregut	0	0	2	11.3%	22.5%	17.5%	4.8%	14.6%	12.0%	€ 1.84	0.03%
Dështimi i tre kredimarrësve	0	1	0	5.5%	20.3%	17.1%	4.6%	27.3%	15.4%	€ 8.48	0.15%
Dështimi i pesë kredimarrësve	0	1	1	2.2%	17.6%	15.6%	4.6%	33.3%	18.5%	€ 13.05	0.23%

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive.

Shënim: 2/ Në raportin të vlerave minimale dhe maksimale të indikatorëve në nivel të bankave, në disa raste janë përjashtuar vlerat e larta të CAR si dhe vlera e NPL prej 0 përqind, të cilat karakterizojnë bankat në fillim të veprimtarisë.

Burimi: BQQ (2015)

## 6.5.2. Rreziku i likuiditetit

### Metodologjia<sup>25</sup>

**Skenari bazë:** Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8 përqind të depozitave në baza ditore, përgjatë pesë ditëve të njëpasnjëshme, duke ndarë 5 përqind të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Ndarja e 5 përqind të depozitave për qëllime operationale nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu, është supozuar se bankat nuk kanë mundësi të financimit përmes burimeve të jashtme të financimit.

**Skenarë shtesë:** Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të paraqitet nevoja për likuiditet shtesë.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft të mëdha të depozitave si dhe mjaftueshmërinë e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

### Rezultatet

Sektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë në qershor të vitit 2015, ku indikator i kyç i likuiditetit (raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra) qëndroi në 41.5 përqind. Andaj, si rezultat i pozitës së mirë të likuiditetit, sektori bankar në tërësi tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar mjaft konservativ të tërheqjes së depozitave.

Rezultatet e skenarit bazë të tërheqjes së 8 përqind të depozitave në ditë, për pesë ditë në vazhdimësi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës do të fillonte të ketë nevojë për likuiditet shtesë vetëm në ditën e tretë, ku dy nga bankat do të kishin mungesë të mjeteve likuide prej 3.5 milionë euro (tabela 9). Në fund të ditës së katërt, probleme me likuiditet do të kishin katër banka, nevojat për likuiditet të së cilave do të arrinin në 28.3 milionë euro. Në fund të ditës së pestë, problemet do të shfaqeshin edhe në një bankë tjetër, duke rritur numrin e bankave që do të kishin mungesë të mjeteve likuide për përballim të tërheqjeve të supozuara të depozitave në pesë. Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në ditën e pestë do të arrinte në 34 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve të likuiditetit do të arrinte në 63.5 milionë euro (1.15 përqind e PBB-së së supozuar për vitin 2015).

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat rezulton të mos jetë shqetësues për gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve); prandaj, tërheqja e menjëhershme e

<sup>25</sup> Metodologjia e llogaritjes së mjeteve likuide ka ndryshuar për të qenë konform rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Paraprakisht mjetet likuide për qëllim të analizës stres-test janë llogaritur sipas metodologjisë së Tregueseve të Shëndetit Financiar të FMN-së.

depozitave nga individë apo kompani me vlerën e depozitave më të mëdha nuk paraqet rrezik serioz për sektorin.

Nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë të larta në përgjithësi. Banka me pragun më të ulët qëndron në 14.5 përqind, ndërsa ajo me pragun më të lartë në 38.8 përqind. Në nivel të sektorit, pragu i tërheqjes së gjithsej depozitave ishte afër 28.3 përqind, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e rreth një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrijë në 108.1 përqind.

**Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit**

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)
Pas ditës së parë	0	0
Pas ditës së dytë	0	0
Pas ditës së tretë	2	3,518
Pas ditës së katërt	4	28,312
Pas ditës së pestë	5	63,533

Shënim:1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullator, i ndarë sipas kategorive

Burimi: BQK (2015)

## 6.6. Infrastruktura Financiare në Kosovë

### 6.6.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar është sistem hibrid i pagesave, përmes të cilit procesohen pagesat me vlera të vogla, me vlera të mëdha si dhe pagesa urgjente.

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN deri në qershor 2015, arriti në 4.7 milionë (4.3 milionë deri në qershor 2014), duke shënuar rritje vjetore prej 9.0 përqind. Kurse, vlera e gjithsej transaksioneve deri në qershor 2015, arriti në 3.34 miliardë euro (3.18 miliardë deri në qershor 2014), që paraqet një rritje vjetore prej 5.0 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 39.0 mijë të tilla, ndërsa vlera e tyre në 27.8 milionë euro.

Në raport me numrin e transaksioneve, pagesat e rregullta masive vazhdojnë ta kenë pjesëmarrjen më të lartë prej 39.1 përqind në kuadër të instrumenteve të pagesave (tabela 10). Këto pagesa janë kryesisht të realizuara për institucionet qeveritare. Më pas vijnë pagesat prioritare masive me një pjesëmarrje prej 36.2 përqind, që janë kryesisht të realizuara nga institucionet qeveritare (siç janë pagesat e pagave dhe pensione), dhe pagesat xhiro të cilat kanë një pjesëmarrje prej 13.7 përqind, dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike. Pagesat xhiro janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (641,423 deri në qershor 2015 nga 452,014 deri në qershor 2014).



**Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së, në përqindje**

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Qershor 2014	Qershor 2015	Qershor 2014	Qershor 2015
Të rregullta	10.7%	10.5%	48.2%	46.6%
Prioritare	0.3%	0.3%	9.4%	10.0%
Të rregullta - masive	41.7%	39.1%	8.3%	8.5%
Prioritare - masive	36.6%	36.2%	9.6%	10.3%
Pagesat xhiro	10.5%	13.7%	13.3%	13.5%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	11.2%	10.9%
Debitim Direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2015)

Në raport me vlerën e transaksioneve, pagesat e rregullta vazhdojnë të kryesojnë strukturën e pagesave (46.6 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve). Pagesat xhiro vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e dytë me pjesëmarrje prej 13.5 përqind deri në qershor 2015. Pagesat prioritare dhe ato prioritare-masive u karakterizuan me rritjet me të theksuara në vlerë gjatë kësaj periudhe, gjë që u reflektua edhe në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në strukturë të pagesave. Pagesat prioritare të procesuara përmes SEKN rritën pjesëmarrjen në 10.0 përqind në qershor 2015 nga 9.4 përqind sa ishin në qershor 2014, kryesisht si rezultat i rritjes së tyre në vlerë (333.9 milionë deri në qershor 2015 nga 299.9 milionë deri në qershor 2014). Pagesat proritare masive rritën pjesëmarrjen në 10.3 përqind nga 9.6 përqind në qershor 2014 dhe arritën vlerën në 345.6 milionë euro (305.5 deri në qershor 2014). Pagesat e letrave me vlerë përmes SEKN gjatë kësaj periudhe shënuan rritje më të ngadalësuar (363.4 milionë euro deri në qershor 2015 nga 355.3 milionë euro deri në qershor 2014) që rezultoi me rënie të pjesëmarrjes së tyre në strukturë për 0.3 pikë përqindje. Ko rënie e pjesëmarrjes në gjithsej vlerën e transaksioneve përmes SEKN mund të jetë ndikuar nga ngadalësimi i rritjes së letrave me vlerë në sektorin bankar krahasuar me rritjen e theksuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.87 milionë llogari në qershor 2015, që nënkupton që mesatarisht gati çdo qytetar në Kosovë është i pajisur me llogari bankare.<sup>26</sup> Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend me qershor 2014 kemi një rënie të gjithsej llogarive bankare për 0.3 përqind.<sup>27</sup>

Llogaritë bankare E-banking përmes të cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti kanë vazhduar të rriten. Deri në qershor 2015 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 164,583 që paraqet rritje vjetore prej 11.4 përqind. Rrjedhimisht, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 1,029,752 deri në qershor 2015 (680,315 deri në qershor 2014). Vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking deri në qershor 2015 arriti në 2.44 miliardë euro (1.67 miliardë deri në qershor 2014).

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.5 përqind në qershor 2015. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 78.8 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve dhe pjesa e mbetur nga 21.2 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (90.9 përqind në qershor 2015), përderisa llogaria afariste ka një pjesëmarrje prej 9.1 përqind.

<sup>26</sup> Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në dhjetor 2014 popullsia e përgjithshme rezidente ishte 1,804,944.

<sup>27</sup> Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje vjetore prej 8.9 përqind në qershor 2015. Numri i kartelave me funksion debiti në qershor 2015 arriti në 690,914, kurse me funksion krediti në 126,812. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 9.0 përqind, kurse kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 8.2 përqind në qershor 2015. Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e debitit dhe kreditit deri në qershor 2015 e kishin kartelat Visa (71.9 përqind përkatësisht 89.2 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (27.9 përqind përkatësisht 9.3 përqind).

Infrastruktura bankare në vend sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) ka shënuar rritje. Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rritje vjetore prej 3.7 përqind përkatësisht rritje prej 2.8 përqind në qershor 2015. Numri i ATM-ve të instaluar nga bankat komerciale në qershor 2015 ishte 505 përderisa numri i POS arriti në 9,449 (tabela 11). Deri në qershor 2015, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 5.0 milionë (4.7 milionë deri në qershor 2014), me një qarkullim prej 533.6 milionë euro (450.1 milionë deri në qershor 2014). Numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS deri në qershor 2015 arrit në 2.5 milionë me vlerë prej 143.7 milionë euro.

**Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar**

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Numri i ATM-ve	472	493	487	505
Numri i POS-ve	7,713	9,039	9,191	9,449
Numri i llogarive 'e-banking'	100,519	113,171	147,739	164,583

Burimi: BQK (2015)

Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 74.6 përqind deri në qershor 2015, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Ndërsa, vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arrit në 20.1 përqind deri në qershor 2015 (tabela 12).

**Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje**

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
ATM tërheqje në para të gatshme	81.4%	81.1%	79.7%	74.6%
ATM depozitime	0.0%	0.1%	0.6%	4.4%
Kredit Transfere nëpërmjet ATM	0.1%	0.1%	0.1%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	1.8%	1.7%	1.3%	0.9%
Pagesa me kartela në terminale POS	16.6%	17.1%	18.3%	20.1%

Burimi: BQK (2015)

Përkundër pjesëmarrjes së lartë të tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela, nga tabela 12 vërehet se krahasuar me vitet e mëparshme është shënuar rënie e pjesëmarrjes së tërheqjeve cash në vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela. Përderisa tërheqjet cash në terminale ATM në qershor 2012 përbënin 81.4 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, në qershor 2015 tërheqjet cash përbëjnë 74.6 përqind të vlerës së përgjithshme, duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre me 6.8 pp. Rritja e numrit të ATM-

ve të cilët mundësojnë depozitimin e parave në llogaritë e klientëve ka ndikuar që kjo kategori të rris pjesëmarrjen në 4.4 përqind deri në qershor 2015 nga 0.6 përqind sa ishte deri në qershor të vitit të kaluar.

## 7. Sektori Pensional

### 7.1 Struktura e Sektorit Pensional

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori me normën më të lartë të rritjes së aseteve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës. Vlera e aseteve të sektorit pensional, deri në qershor 2015, arriti në 1.18 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind. Pjesa më e madhe e kursimeve pensionale në Kosovë vazhdon të administrohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që menaxhon me 99.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të pensioneve. Ndërsa, pjesa e mbetur e aseteve administrohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) (tabela 13).

**Tabela 13. Struktura e fondeve pensionale sipas pronësisë**


Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Kosovë	99.3%	99.4%	99.4%	99.5%
Slloveni-Kosovë	0.7%	0.6%	0.6%	0.5%

Burimi: BQK (2015)

Sa i përket FKPK-së, struktura e aseteve deri në qershor 2015, u dominua nga investimet në tregun e jashtëm me një pjesëmarrje prej 89.5 përqind të gjithsej investimeve (figura 81). Pjesa e mbetur e aseteve përbëhet nga investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (6.8 përqind) dhe nga depozitat në BQK (3.7 përqind). Krahasuar me periudhën deri në qershor 2014, FKPK-ja ka tërhequr pjesën më të madhe të depozitave të mbajtura në BQK dhe i ka investuar në fonde investuese në sektorin e jashtëm kryesisht si rezultat i normës së kthimit më të lartë. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve jashtë vendit janë në formë të aksioneve dhe bonove të thesarit të qeverive të huaja.

Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e aseteve të FSKP-së. Në qershor 2015, 85.3 përqind e gjithsej aseteve të FSKP-së ishte e investuar jashtë vendit, ndërsa pjesa e mbetur prej 14.7 përqind paraqet investimet në Kosovë. Në figurën 81 mund të vërehet një tendencë e vazhdueshme e rritjes së investimeve në sektorin e jashtëm nga FSKP-ja.

**Figura 81. Struktura e investimeve të sektorit pensionale, në përqindje**




Burimi: BQK (2015)

## 7.2. Performanca e Sektorit Pensional

Sektori pensional gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 u karakterizua me performancë pozitive financiare. Të dy fondet shënuan kthim pozitiv në investime dhe ngritje të çmimit të aksionit (figura 82 dhe 83). Deri në qershor 2015, FKPK-ja ka realizuar 37.5 milionë euro kthim bruto nga investimet krahasuar me vlerën prej 31.9 milionë euro në gjashtëmujorin e parë 2014. Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në qershor 2015 arriti në 57.7 milionë euro, përdërisa numri i kontribuuesve u rrit për 29 mijë. Vlera e çmimit të aksionit<sup>28</sup> të FKPK-së, në ditën e fundit të muajit qershor 2015, arriti në 1.33 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.4 përqind. Njëherit, çmimi i aksionit të FKPK-së në qershor 2015 ka arritur vlerën më të lartë ndonjëherë të regjistruar, duke u rikuperuar nga rënia e konsiderueshme në vitin 2008 si pasojë e krizës globale financiare.


Me rritje të aktivitetit dhe performancës pozitive në gjashtëmujorin e parë 2015 u karakterizua edhe FSKP-ja. Deri në qershor 2015, kthimi bruto në investime i FSKP-së arriti në 164.8 mijë euro (241.3 mijë euro deri në qershor 2014). Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në qershor 2015 arriti në 196.4 mijë euro me 3,973 kontribues. Në ditën e fundit të qershorit 2015, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 147.89 euro (143.84 euro në qershor 2014).

Figura 82. Asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2015)

Figura 83. Asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2015)

<sup>28</sup> Vlera bazë e çmimit të aksionit për FKPK-në është =1, ndërsa për FSKP-në është =100.

## 8. Sektori i Sigurimeve

### 8.1 Struktura e Sektorit të Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 90.2 përqind të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesën e mbetur prej 9.8 përqind e përfshijnë shërbimet e sigurimit 'jetë'. Gjatë vitit të fundit në tregun vendor janë licencuar dy kompani të reja me kapital vendor, duke rritur numrin e tyre në 15. Prej tyre, 12 kompani ofrojnë produkte të sigurimit 'jo-jetë', ndërsa tri kompani vazhdojnë të ofrojnë produkte të sigurimit 'jetë'. Sektori i sigurimeve në Kosovë dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, të cilat në qershor 2015 menaxhuan 72.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve.


Numri i kompanive të sigurimeve me origjinë nga Shqipëria është rritur për një. Si rrjedhojë numri i kompanive me origjinë nga Austria dhe Shqipëria është rritur në gjashtë kompani, si rezultat i ndërrimit të pronësisë së një kompanie vendore. Në qershor 2015, kompanitë e sigurimit me origjinë nga Austria dhe Shqipëria zotëruan 45.0 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve. Në treg operojnë pesë kompani vendore, të cilat përfaqësojnë së bashku 27.5 përqind të aseteve të sektorit. Pavarësisht që gjatë kësaj periudhe janë shtuar dy kompani vendore, shitja e një kompanie vendore relativisht të madhe, ndikoi që pjesëmarrja në tregun e sigurimeve të zvogëlohet për 6.1 pikë përqindje krahasuar me qershor 2014. Sllovenia përfaqësohet nga dy kompani të cilat menaxhojnë 14.0 përqind të aseteve të sektorit. Ndërsa, Turqia dhe Kroacia përfaqësohen me nga një kompani të cilat menaxhojnë 7.7 përqind përkatësisht 5.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve (figura 84).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 817.2 pikë në qershor 2015 (901.0 pikë në qershor 2014). Megjithatë, shkalla e koncentrimit në raport me primet ishte më e lartë se në raport me asetet, ku në qershor 2015 Indeksi Herfindahl-Hirschman për primet ishte 1122.6 pikë (1088.8 pikë në qershor 2014). Diferencë e ngjashme vërehet edhe nëse krahasohet pjesëmarrja e tri kompanive më të mëdha në gjithsej asetet dhe primet e sektorit, ku në qershor 2015 pjesëmarrja në gjithsej asetet ishte 33.3 përqind, ndërsa në gjithsej primet ishte 42.9 përqind. Në zvogëlimin e shkallës së koncentrimit në asete ndikoi edhe zgjerimi i tregut të sigurimeve për dy kompani si dhe rritja vjetore më e shpejtë e aseteve të kompanive më të vogla (14.7 përqind) krahasuar me ato tri më të mëdhatë (5.7 përqind). Ndërsa, në rritjen e shkallës së koncentrimit në tregun e primeve, në qershor 2015, me rritje vjetore prej 3.5 përqind u karakterizuan tri kompanitë më të mëdha krahasuar me rënien prej 2.4 përqind të kompanive tjera.

### 8.2 Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve

Në qershor 2015, vlera e aseteve të kompanive të sigurimit arriti në 151.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.5 përqind, që paraqet përsheptim të rritjes krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 4.2 përqind në qershor 2014. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit

Figura 84. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë



vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 58.9 përqind të gjithsej aseteve. Pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet fikse, asetet teknike, paraja e gatshme, etj. (figura 85).

Në kuadër të gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve, kategoritë që shënuan rritje më të theksuar ishin asetet teknike (33.5 përqind), pasuar nga debitorët e primeve (10.4 përqind), dhe depozitat (14.1 përqind). Kurse, asetet e paprekshme dhe paraja e gatshme shënuan rënie vjetore prej 12.5 përqind përkatësisht 8.3 përqind.

Në kuadër të detyrimeve, rezervat teknike kryesojnë me 56.7 përqind të gjithsej detyrimeve, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë kapitali vetanak, detyrimet tjera dhe kreditë (figura 86). Vlera e kapitalit vetanak në qershor 2015 shënoi rritje vjetore prej 8.4 përqind. Në rritjen e kapitalit vetanak, kontributin më të lartë e kishte shtimi i kapitalit aksionar prej dy kompanive të reja të cilat kanë filluar të operojnë në tregun e sigurimeve.

Deri në qershor 2015, vlera e bruto primeve të shkruara arriti në 40.3 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 0.1 përqind (tabela 14). Në kuadër të tyre, vlera e bruto primeve të shkruara të sigurimit 'jo-jetë' arriti në 38.9 milionë euro dhe shënoi rënie vjetore prej 0.1 përqind. Në kuadër të sigurimit 'jo-jetë', primet e pranuar nga sigurimi i përgjegjësishë ndaj palës së tretë (TPL) arritën vlerën prej 21.4 milionë euro deri në qershor 2015, që paraqet një rënie vjetore prej 2.9 përqind. Kurse, primet e pranuar nga 'polisat kufitare' dhe 'polisat vullnetare' shënuan rritje vjetore prej 3.5 përqind përkatësisht 4.9 përqind deri në qershor 2015. Vlera e primeve të shkruara në kuadër të sigurimit 'jetë' shënoi një rritje vjetore prej 5.0 përqind, duke arritur vlerën prej 1.4 milionë euro deri në qershor 2015.


**Tabela 14. Bruto primet e arkëtuara, në milionë euro**

Përshkrimi	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Gjithsej bruto primet e shkruara	40.5	40.3	40.3
Prime bruto 'jo jetë'	39.6	39.0	38.9
Prime bruto 'jetë'	0.9	1.3	1.4

Burimi: BQK (2015)


Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në qershor 2015 arriti në 19.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.3 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së dëmeve të paguara ndaj sigurimit 'jo-jetë' (tabela 15). Në kuadër

**Figura 85. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, në përqindje**



Burimi: BQK (2015)


**Figura 86. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve, në përqindje**



Burimi: BQK (2015)

të sigurimit 'jo-jetë', gjatë kësaj periudhe është regjistruar rritje e shpenzimeve të dëmeve të paguara për kategorinë e "përgjegjësisë ndaj palës së tretë" që shënoi vlerën 12.3 milionë euro deri në qershor 2015 (9.7 milionë deri në qershor 2014). Dëmet e paguara nga sigurimi 'jetë' deri në qershor 2015 arritën në 0.1 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara nga BKS-ja shënuan vlerën 2.2 milionë euro (1.9 milionë euro deri në qershor 2014). Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në qershor 2015 arriti në 48.4 përqind krahasuar me 42.4 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 87).

Figura 87. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Tabela 15. Dëmet e paguara, në milionë euro

Përshkrimi	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Dëmet 'jo jete'	18.6	15.1	17.2
Dëmet 'jete'	0.1	0.1	0.1
Dëmet BKS	2.5	1.9	2.2

Burimi: BQK (2015)

### 8.3. Performanca e Sektorit të Sigurimeve

Indikatorët kyç të performancës dhe stabilitetit të sektorit të sigurimeve në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 kanë shënuar rënie krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2014. Profitabiliteti vazhdon të paraqes shqetësimin kryesor për sa i përket performancës së këtij sektori. Deri në qershor 2015, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 2.5 milionë euro, krahasuar me humbjen prej 113.2 mijë euro të vitit paraprak.

Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahas performancës pozitive financiare të sigurimit jetë. Deri në qershor 2015, sigurimi jo-jetë kishte humbje prej 2.8 milionë euro krahasuar me humbjet prej 316.0 mijë euro gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Kurse, sigurimi jetë regjistroi profit në vlerë prej 236.3 mijë euro krahasuar me 429.2 mijë euro deri në qershor 2014.

Operimi me humbje i sektorit të sigurimeve ndikoi në rënien e mëtutjeshme të indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u zvogëlua në -3.6 përqind (-0.2 përqind në vitin 2014), kurse ROAE në -10.2 përqind (-0.7 përqind në vitin 2014).<sup>29</sup>

Gjendja e sektorit të sigurimeve është më e mirë për sa i përket kapitalizimit. Sektori mbetet mirë i kapitalizuar, me normë kapitalizimi prej 34.4 përqind, që do të thotë se tregu do të ishte në gjendje të mirë për t'u ballafaquar me tronditjet e mundshme. Po ashtu, kompanitë e sigurimeve gjatë kësaj periudhe kishin një nivel të kënaqshëm të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike qëndroi në 116.8 përqind në qershor 2015 (119.1 përqind në qershor 2014), kurse raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe

<sup>29</sup> ROAA dhe ROAE janë të anualizuara bazuar në të dhënat e sektorit deri në qershor 2015.



ekuivalentëve të saj dhe gjithsej detyrimeve qëndroi në 100.9 përqind (102.8 përqind në qershor 2014).

## 9. Sektori Mikrofinanciar dhe Ndhmësit Financiar


### 9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me zgjerim të aktivitetit të tij gjatë gjysmës së parë të vitit 2015. Vlera e aseteve të sektorit në qershor 2015 arriti në 116.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.8 përqind (0.2 përqind në qershor 2014) (figura 88).

Kreditë mbeten kategoria kryesore e aseteve të sektorit duke marrë parasysh që përfaqësojnë 67.0 përqind të gjithsej aseteve. Në qershor 2015, kreditë u karakterizuan me rritje vjetore prej 2.8 përqind, duke arritur vlerën prej 77.9 milionë euro. Pjesa dërmuese e kredive (prej 65.2 përqind e gjithsej kredive) janë të destinuara për ekonomitë familjare, pasuar nga 34.8 përqind të kredive të destinuara për ndërmarrjet (figura 89). Përkundër peshës më të vogël, ishin kreditë e destinuara për ndërmarrje ato që dhanë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit kreditor të sektorit duke marrë parasysh që shënuan rritje vjetore prej 9.4 përqind. Ndërsa, kreditë ndaj ekonomive familjare u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.4 përqind, kryesisht si rezultat i konkurrencës prej sektorit bankar duke pasur parasysh se kreditimi i ekonomive familjare nga ky sektor gjatë të njëjtës periudhë u karakterizua me rritje të dyfishuar.


Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjashme me vitin paraprak ku kreditimi i sektorit të shërbimeve vazhdon të kryesojë strukturën me pjesëmarrje prej 45.2 përqind. Në qershor 2015, njëri ndër sektorët më të kredituar nga bankat komerciale, që është sektori i bujqësisë, tek IMF paraqet njërin ndër sektorët më pak të kredituar. Si rezultat i rënies së kredive të lëshuara për bujqësi, pjesëmarrja në gjithsej kreditimin ndaj sektorëve ekonomik nga IMF-të u ngushtua në 25.2 (27.8 në qershor 2014, megjithatë bujqësia mbetet njëri ndër sektorët më të kredituar në sektorin mikrofinanciar për dallim nga kreditimi bankar ku ka qasjen më të kufizuar në financim. Kurse, kreditimi i sektorit të industrisë zgjeroi pjesëmarrjen në 29.6

Figura 88. Asetet e sektorit mikrofinanciarë, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Figura 89. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciarë



Burimi: BQK (2015)

Figura 90. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciarë, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK (2015)


përqind si rrjedhojë e rritjes së konsiderueshme të kredive të destinuar për ndërtimtarinë. Kreditë për ndërtimtarin përfaqësojnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë prej 70.6 përqind, në gjithësej strukturën e kreditimit ndaj sektorit të industrisë (figura 90).

Sipas afatit të maturimit, struktura e kredive të sektorit mbetet e ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke u dominuar nga kreditë afatmesme ‘mbi 1 vit deri në 5 vite’ të cilat përfaqësojnë 84.1 përqind të gjithësej kredive. Kreditë afatshkurta ‘deri në 1 vit’ përbëjnë 15.6 përqind të kredive, dhe pjesa e mbetur përfaqësohet nga kreditë afatgjata (figura 91). Krahasuar me periudhën paraprake, kemi rritje të kredive afatmesme të destinuar për ndërmarrje, kurse ato të destinuar për ekonomi familjare zvogëluar pjesëmarrjen e tyre.

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me cilësi të mirë të portofolit kreditor. Në qershor 2015, raporti i kredive joperformuese (angl. non-performing loans: NPL) ndaj gjithësej kredive u zvogëluar në 5.4 përqind (5.9 përqind në qershor 2014) kryesisht si rezultat i rënies së vlerës së kredive joperformuese, përderisa stoku i gjithësej kredive shënoi rritje. Në rënie e nivelit të kredive jo-joperformuese mund të ketë ndikuar roli i përmbaruesve privat si dhe rritja e pagave në sektorin publik duke qenë se pjesa më e madhe e kredive të lëshuara nga IMF-të janë të destinuar për ekonomitë familjare. Gjithashtu, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm, duke u përmirësuar në 109.5 përqind në qershor 2015, krahasuar me nivelin prej 106.9 përqind në qershor 2014.


Normat mesatare të interesit për kreditë e IMF-ve vazhdojnë të jenë dukshëm më të larta krahasuar me normat e aplikuara nga sektori bankar. Norma mesatare e interesit në kreditë e IMF-ve, në qershor 2015, ishte 24.2 përqind (25.2 përqind në qershor 2014) (figura 92). Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare shënoi rënie në 24.6 përqind nga 25.3 përqind sa ishte në qershor 2014. Po ashtu, norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 23.5 përqind nga 24.6 përqind sa ishte në qershor 2014 (figura 93).

Figura 91. Struktura e kredive të sektorit mikrofinanciar, sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK (2015)

Figura 92. Norma mesatare e interesit në kredi



Burimi: BQK (2015)

Figura 93. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve




Burimi: BQK (2015)

Norma mesatare e interesit për sektorin e bujqësisë në qershor 2015 u zvogëlua në 25.2 përqind (25.6 në qershor 2014), për sektorin e shërbimeve norma e interesit poashtu shënoi rënie në 23.7 përqind (26.1 përqind në qershor 2014). Në anën tjetër, norma e interesit për sektorin e industrisë u rrit në 23.4 përqind nga 22.4 përqind sa ishte në qershor 2014.

Lizingu përfaqëson kategorinë e dytë më të rëndësishme të aseteve të sektorit me pjesëmarrje prej 19.8 përqind. Deri në qershor 2015, lizingu arriti vlerën 23.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.0 përqind. Lizingu i destinuar për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore prej 64.8 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së lizingut për kredi hipotekare, ndërsa lizingu për ndërmarrje shënoi rënie vjetore prej 27.6 përqind si rezultat i rënies së ndjeshme të lizingut financiar në formë të kredive hipotekare dhe lizingut për pajisje të destinuar për biznese. Ky rezultat ndikoi në ndryshimin e strukturës së lizingut. Për dallim nga periudhat e kaluara, në qershor 2015 pjesëmarrja e lizingut të destinuar për ekonomitë familjare arriti në 51.9 përqind të gjithëj vlerës së lizingut, duke tejkaluar lizingun e destinuar për ndërmarrje në këtë periudhë (figura 94).

Meqenëse IMF-të nuk kanë të drejtë ligjore të financohen nga depozitat e klientëve, pjesa kryesore e detyrimeve të këtyre institucioneve përbëhet nga linjat kreditore të jashtme. Prandaj, ekspozimi i sektorit mikrofinanciar në kuadër të detyrimeve është i lartë. Në qershor 2015, raporti i detyrimeve të jashtme ndaj gjithëj aseteve të IMF-ve ishte 54.5 përqind (54.9 përqind në qershor 2014).

Figura 94. Struktura e lizingut, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

## 9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar

Sektorin mikrofinanciar deri në qershor 2015 shënoi rritje të konsiderueshme të profitit duke arritur vlerën prej 1.2 milionë euro krahasuar me profitin prej 13.6 mijë euro në vitin paraprak. Operimi me fitim ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave, përderisa shpenzimet shënuan rënie.

Të hyrat e sektorit arritën vlerën prej 10.0 milionë euro në qershor 2015, që paraqet rritje vjetore prej 7.1 përqind. Struktura e të hyrave vazhdon të dominohet nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 83.4 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rënie prej 5.6 përqind, në kuadër të cilave kontribues kryesor ishin shpenzimet për provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë (rënie prej 53.1 përqind). Treguesi i përgjithshëm i efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, është përmirësuar në 88.0 përqind nga 99.9 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Përmirësimi i performancës financiare u pasqyrua edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Assets: ROAA) u përmirësua në 2.1 përqind nga 0.6 përqind sa ishte në dhjetor 2014. Gjithashtu, kthimi mesatar në kapital (ang. Return on Average Equity: ROAE) arriti në 7.7 përqind<sup>30</sup> në qershor 2015 nga 2.4 përqind sa ishte në dhjetor 2014.

<sup>30</sup> Llogaritja e ROAA dhe ROAE është bazuar në profitin e aktualizuar për Qershor 2015.

Numri i të punësuarve në sektorin mikrofinanciar u zvogëluar në 785 në qershor 2015 krahasuar me 799 në qershor të vitit paraprak. Numri i kredive të aprovuara u zvogëluar në 34,188 në qershor 2015 krahasuar me 36,371 në qershor të vitit paraprak. Si rezultat i rënies së numrit të kredive të aprovuara, raporti ndërmjet numrit mesatar të kredive për një punëtor u zvogëluar krahasuar me vitin e kaluar (tabela 16). Gjithashtu, reduktimi i numrit të punëtorëve krahas rritjes së lehtë të shpenzimeve të personelit me 0.7 përqind ndikuan që raporti i shpenzimeve të personelit ndaj numrit të punëtorëve të shënojë rritje në qershor 2015, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kurse, indikator i që matë mesataren e aseteve të menaxhuara nga një punëtor shënoi rritje krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i zgjerimit të aktivitetit të sektorit. Përmirësim të dukshëm ka shënuar edhe indikator i që matë profitin e realizuar mesatarisht për një punëtor, përmirësim ky që erdhi si rrjedhojë e rritjes së konsiderueshme të profitit nga sektori mikrofinanciar gjatë gjashtëmuajorit të parë 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**Tabela 16. Tregues shtesë të efikasitetit të sektorit**

Përshkrimi	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
Asetet/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	131.0	140.7	141.6	148.2
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	-2.9	-0.7	0.02	1.53
Numri i kredive/nr. i punëtorve	44.3	48.8	45.5	43.6
Shpenzimet e personelit/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	6.4	7.0	6.6	6.8

Burimi: BQK (2015)

### 9.3 Ndhmësit Financiar

Struktura e ndihmësve financiar përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Ky sektor përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në qershor 2015). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në qershor 2015 arriti në 10.1 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 12.6 përqind.

Deri në qershor 2015, të hyrat e ndihmësve financiar arritën vlerën 3.5 milionë euro, duke paraqitur rritje prej 11.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 72.8 përqind, që u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.0 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 1.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 12.8 përqind. Neto fitimet për sektorin e ndihmësve financiarë arritën vlerën prej 1.7 milionë euro deri në qershor 2015, që paraqet rritje vjetore prej 10.2 përqind.



## 10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Qershor 2012	Qershor 2013	Qershor 2014	Qershor 2015
<b>Mjaftueshmëria e kapitalit</b>	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.2	15.0	17.4	19.0
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.4	12.2	13.5	15.9
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	5.2	7.3	5.9	3.1
<b>Cilësia e asetëve</b>	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	6.5	7.8	8.2	7.2
<b>Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive</b>	Korporatat tjera financiare	1.0	1.0	1.1	0.4
	Korporatat publike jofinanciare	0.08	0.02	0.01	0.03
	Korporatat tjera jofinanciare	68.1	67.0	66.4	66.4
	Ekonomitë familjare	30.7	30.8	31.5	33.1
	QJSHF	0.05	0.04	0.04	0.01
	Jo-rezidente	0.0	1.1	1.0	0.0
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
<b>Profitability</b>	Kthimi në asete (ROA)*	0.8	1.0	2.0	3.1
	Kthimi në kapital (ROE)*	8.6	10.6	21.1	29.1
	Margjina e interesit ndaj te hyrave bruto	75.4	74.0	74.5	76.4
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj te hyrave bruto	86.6	82.0	68.8	52.7
<b>Likuiditeti</b>	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	22.6	21.9	23.0	22.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	28.9	29.3	32.4	28.8
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	28.3	27.9	29.2	29.0
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	36.2	37.3	41.2	36.5
<b>Senzitiviteti ndaj riskut të tregut</b>	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	-2.4	0.3	2.4	0.8
<b>Grupi i zgjeruar i indikatorëve</b>					
	Kapitali ndaj asetëve	10.3	10.5	10.1	11.7
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	80.9	79.0	89.6	77.1
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointeresi	38.4	39.2	38.5	38.1
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	9.9	8.5	10.0	6.8
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	112.2	116.3	124.4	126.0
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	4.6	4.6	4.7	3.7

\*Anualizuar për Qershor 2015, janë konsideruar të hyrat neto para taksës.  
Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)



Tabela 2. Bilancet e gjendjes së bankave komerciale, qershor 2015, në milionë euro

## Raiffeisen Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	89.5	Bilanci nga bankat tjera	6.3
Bilanci me bankat komerciale	65.7	Depozitat	630.6
Letrat me vlerë	185.4	Huamarrjet tjera	0.3
Kreditë	474.9	Detyrimet tjera	63.1
Asetet fikse	6.8	Borxhi i ndërruarur	19.0
Asetet tjera	5.0	Mjetet vetanake	107.8
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>827.1</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>827.1</b>

Burimi: BQK (2015)

## Procredit Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	129.1	Bilanci nga bankat tjera	0.3
Bilanci me bankat komerciale	98.72	Depozitat	662.5
Letrat me vlerë	96.0	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	457.9	Detyrimet tjera	40.6
Asetet fikse	14.6	Borxhi i ndërruarur	14.5
Asetet tjera	8.6	Mjetet vetanake	86.9
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>804.9</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>804.9</b>

Burimi: BQK (2015)

## NLB Prishtina

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	44.2	Bilanci nga bankat tjera	2.4
Bilanci me bankat komerciale	54.0	Depozitat	389.6
Letrat me vlerë	62.8	Huamarrjet tjera	1
Kreditë	311.1	Detyrimet tjera	38.8
Asetet fikse	12.4	Borxhi i ndërruarur	-
Asetet tjera	2.6	Mjetet vetanake	55.0
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>487.1</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>487.1</b>

Burimi: BQK (2015)

## TEB Bank

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	56.0	Bilanci nga bankat tjera	23.3
Bilanci me bankat komerciale	9.7	Depozitat	320.6
Letrat me vlerë	14.4	Huamarrjet tjera	-
Kreditë	342.5	Detyrimet tjera	33.2
Asetet fikse	5.7	Borxhi i ndërvarur	11
Asetet tjera	3.2	Mjetet vetanake	43.3
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>431.4</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>431.4</b>

Burimi: BQK (2015)

## Banka Kombëtare Tregtare

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	27.7	Bilanci nga bankat tjera	0.5
Bilanci me bankat komerciale	52.5	Depozitat	224.2
Letrat me vlerë	40.1	Huamarrjet tjera	10.0
Kreditë	143.7	Detyrimet tjera	18.8
Asetet fikse	3.2	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	2.4	Mjetet vetanake	16.1
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>269.5</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>269.5</b>

Burimi: BQK (2015)

## Banka Ekonomike

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	21.2	Bilanci nga bankat tjera	0.5
Bilanci me bankat komerciale	6.8	Depozitat	159.8
Letrat me vlerë	26.3	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	128.6	Detyrimet tjera	14.7
Asetet fikse	6.3	Borxhi i ndërvarur	1.0
Asetet tjera	1.4	Mjetet vetanake	14.6
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>190.5</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>190.5</b>

Burimi: BQK (2015)

## Banka për Biznes

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	18.1	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	5.0	Depozitat	103.3
Letrat me vlerë	8.7	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	87.5	Detyrimet tjera	7.5
Asetet fikse	1.0	Borxhi i ndërvarur	1.8
Asetet tjera	2.0	Mjetet vetanake	9.9
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>122.4</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>122.4</b>

Burimi: BQK (2015)

## Komerçijalna Banka

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	6.4	Bilanci nga bankat tjera	0.0
Bilanci me bankat komerciale	48.8	Depozitat	49.7
Letrat me vlerë	0.0	Huamarrjet tjera	1
Kreditë	3.7	Detyrimet tjera	1.1
Asetet fikse	0.0	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	0.4	Mjetet vetanake	7.1
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>59.3</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>59.3</b>

Burimi: BQK (2015)

## Türkiye İş Bankası

(Në milionë euro)

Asetet		Detyrimet	
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	5.0	Bilanci nga bankat tjera	21.5
Bilanci me bankat komerciale	0.8	Depozitat	20.1
Letrat me vlerë	10.0	Huamarrjet tjera	0.0
Kreditë	34.1	Detyrimet tjera	0.6
Asetet fikse	0.8	Borxhi i ndërvarur	0.0
Asetet tjera	0.3	Mjetet vetanake	9.0
<b>GJITHSEJ ASETET</b>	<b>51.1</b>	<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>51.1</b>

Burimi: BQK (2015)

